FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 176

Tiranë – E martë, 30 shtator 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 25.9.2025	Për përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë kibernetike dhe kategorizimin e afateve të masave korrigjuese në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit.....	21955
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 25.9.2025	Për miratimin e marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës së Tiranës sh.a., për kontratën e kredisë, ndërmjet Bankës së Tiranës sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a.....	21970
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave nr. 3, datë 15.7.2025	Për përcaktimin e masës së tarifës fikse të veprimit përmbarimor, llojet e veprimeve përmbarimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara.....	21981
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave nr. 4, datë 15.7.2025	Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror……..	21983
Urdhër i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave nr. 444, datë 15.7.2025	Për përcaktimin e ndarjes së të ardhurave, kritereve e procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së të ardhurave.....	21984
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 483, datë 19.9.2025	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial", i ndryshuar.....	21985

Urdhër i ministrit të Arsimit nr. 490, datë 25.9.2025	Për delegimin e kompetencave.....	21986
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 13471, datë 24.9.2025	Për pezullimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.....	21987
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 42, datë 1.7.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve datë 28.4.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 206, datë 1.6.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 128, datë 15.9.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-741 (26), datë 8.2.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	21987
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 425 (2405), datë 10.7.2025	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Vera Brahimataj.....	22017
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Bert Resuli.....	22017

VENDIM
Nr. 531, datë 25.9.2025

PËR PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E DOKUMENTIMIT TË MASAVE ORGANIZATIVE, TEKNIKE DHE OPERACIONALE TË SIGURISË KIBERNETIKE DHE KATEGORIZIMIN E AFATEVE TË MASAVE KORRIGJUESE NË INFRASTRUKTURAT KRITIKE E TË RËNDËSISHME TË INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pika 5, e 43, pika 5, të ligjit nr. 25/2024, "Për sigurinë kibernetike", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e përmbajtjes dhe mënyrës së dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë kibernetike në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit dhe të kategorizimit të afateve të masave korrigjuese, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PËRMBAJTJA DHE MËNYRA E DOKUMENTIMIT TË MASAVE ORGANIZATIVE, TEKNIKE DHE OPERACIONALE TË SIGURISË KIBERNETIKE DHE KATEGORIZIMI I AFATEVE TË MASAVE KORRIGJUESE NË INFRASTRUKTURAT KRITIKE E TË RËNDËSISHME TË INFORMACIONIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së dokumentimit dhe verifikimit të implementimit të masave organizative, teknike dhe operacionale nga operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit (OIKI) dhe operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit (OIRI) dhe të kategorizimit të afateve të masave korrigjuese.

2. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen nga të gjithë operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit.

3. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen pa cenuar zbatimin e kërkesave të sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike të përcaktuara në kreun VII "Siguria", të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

4. Përkufizimet në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike.

KREU II
KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I MASAVE TË SIGURISË KIBERNETIKE

1. Masat e sigurisë kibernetike që zbatohen nga operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit ndahen në tri kategori kryesore: masa organizative, masa teknike dhe masa operacionale të sigurisë kibernetike.

2. Masat organizative të sigurisë kibernetike janë veprime administrative dhe procedurale, të ndërmarra nga operatorët e infrastrukturave kritike e të rëndësishme të informacionit, duke përfshirë, ndër të tjera, ndarjen e roleve dhe përgjegjësive për sigurinë, hartimin dhe miratimin e politikave dhe procedurave të sigurisë, menaxhimin e rrezikut kibernetik, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore, si dhe ndërtimin e një strukture organizative të dedikuar për sigurinë kibernetike.

3. Masat teknike të sigurisë kibernetike janë zgjidhje dhe mekanizma teknologjikë, që garantojnë mbrojtjen dhe integritetin e rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve të informacionit të operatorëve të infrastrukturave të informacionit, duke përfshirë zbatimin e kontrollit të aksesit, autentifikimin dhe autorizimin, enkriptimin e të dhënave, monitorimin dhe regjistrimin e ngjarjeve të sigurisë, mbrojtjen nga sulmet kibernetike, si dhe zbatimin e teknologjive për zbulimin dhe parandalimin e incidenteve të sigurisë kibernetike.

4. Masat operacionale të sigurisë kibernetike janë proceset, praktikat dhe aktivitetet e përditshme të operatorëve të infrastrukturave të informacionit për garantimin e sigurisë së informacionit dhe funksionimin e qëndrueshëm të sistemeve kritike e të rëndësishme, duke përfshirë menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike, sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve dhe rikuperimin nga katastrofat, menaxhimin e ndryshimeve në infrastrukturë, si dhe aplikimin e procedurave për raportim dhe komunikim të ngjarjeve të sigurisë me autoritetet përgjegjëse.

5. Masat e sigurisë kibernetike të kategorizuara në masa organizative, masa teknike dhe masa operacionale klasifikohen në dy nivele:

a) niveli i parë (1): I detyrueshëm për t'u zbatuar nga operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit (OIRI) dhe operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit (OIKI);

b) niveli i dytë (2): I detyrueshëm për t'u zbatuar nga operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit (OIKI).

6. Për çdo masë të sigurisë kibernetike (MS1, MS2 etj.), operatorët e infrastrukturave të informacionit duhet të dokumentojnë dhe duhet të mbajnë evidenca për zbatimin dhe implementimin e tyre, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

7. Masat e sigurisë kibernetike dhe mënyra e dokumentimit të tyre përbëjnë listën e kërkesave minimale për implementim nga OIKI-ja dhe OIRI-ja.

KREU III
MASAT ORGANIZATIVE

1. Masat organizative përfshijnë:

1.1 MS1: Politika e sigurisë

Politika e sigurisë përfshin objektivat e sigurisë që lidhen me qeverisjen dhe menaxhimin e rreziqeve të sigurisë së rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve të informacionit.

Niveli	Masa e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a. Vendosja e një politike sigurie të nivelit të lartë, e miratuar nga stafi i lartë menaxherial i infrastrukturës, që adreson sigurinë e rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve kritike e të rëndësishme të informacionit dhe rishikimi në mënyrë periodike i saj. (Minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së.)	i.Politika e sigurisë së informacionit - Dokument i miratuar nga stafi i lartë menaxherial, që përmban objektivat, fushën e zbatimit dhe parimet e sigurisë për rrjetet dhe sistemet e informacionit etj. - Versioni, data e miratimit etj. ii.Raportet e rishikimit periodik - Evidencat që tregojnë datat e rishikimit dhe detajet e ndryshimeve të bëra në politikën e sigurisë.

1.2 MS2: Menaxhimi i rrezikut kibernetik

Të krijohet e të zbatohet një kuadër i përshtatshëm i menaxhimit të rrezikut për të identifikuar dhe për të trajtuar rreziqet kibernetike për rrjetet e komunikimit dhe sistemet e informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Krijimi i një metodologjie për menaxhimin e rrezikut kibernetik. (Rishikimi minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së).	i.Dokument i metodologjisë së menaxhimit të rrezikut kibernetik, duke përfshirë versionin, datat dhe miratimin nga stafi menaxherial. ii.Raportet e rishikimit periodik - Evidencat që tregojnë datat e rishikimit dhe detajet e ndryshimeve të bëra në metodologjinë për menaxhimin e rrezikut.
1	b.Hartimi i një liste të rreziqeve për sigurinë e rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve të informacionit, duke marrë në konsideratë kërcënimet kryesore për asetet kritike. (Rishikimi minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas	i.Lista e vlerësimit të rreziqeve të ardhura nga burime të ndryshme, duke përfshirë dhe rreziqet, të cilat vijnë nga palët e treta. ii.Njoftimi i stafit menaxherial për listën e rreziqeve, si dhe vendimi i marrë për trajtimin e tyre. iii. Rishikim i listës së rreziqeve.

	çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së.)	
1	c.Hartimi i një plani për trajtimin e rreziqeve të identifikuara.	i.Dokument i planit për trajtimin e rreziqeve. ii.Pasqyrimi i ndryshimeve të nivelit të rrezikut mbas zbatimit të planit të trajtimit të rreziqeve.

1.3 MS3: Siguria organizative

Të krijohet e të zbatohet një strukturë e përshtatshme e roleve të sigurisë dhe përgjegjësive për menaxhimin e sigurisë së informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Caktimi i roleve dhe përgjegjësive për menaxhimin e sigurisë së informacionit.	i.Lista e roleve të sigurisë dhe përshkrimi i detajuar i përgjegjësive e i detyrave për secilin rol p.sh. (*CISO, ISO, DPO, DBA, SYSADM, NETADM* etj.). ii.Organigrama që tregon hierarkinë dhe lidhjet midis roleve të sigurisë. iii. Lista e kontakteve për personat përgjegjës për sigurinë e informacionit (emër, pozicion, mënyra e kontaktit).

1.4 MS4: Kërkesat e sigurisë kibernetike për palët e treta

Të krijohet e të zbatohet një politikë me kërkesa sigurie për kontratat me palët e treta për të siguruar që marrëdhëniet me palët e treta të mos ndikojnë negativisht në sigurinë e rrjeteve të komunikimit e të sistemeve të informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Vendosja e një politike sigurie për furnizimet/ kontratat me palët e treta dhe rishikimi në mënyrë periodike i saj. (Minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së.)	i.Politika e sigurisë për furnizimet/ kontratat me palët e treta (versioni, data e publikimit, miratimi). ii.Raporte të rishikimit periodik të politikës së sigurisë dhe ndryshimet e realizuara.
1	b)Përfshirja e kërkesave të sigurisë në kontratat me palët e treta, duke përfshirë konfidencialitetin dhe transferimin e sigurt të informacionit.	i.Kërkesa të qarta sigurie në kontratat me palët e treta. ii.Marrëveshje konfidencialiteti për ruajtjen e informacionit me palët e treta.
2	c)Mbajtja e gjurmëve/rekordeve të incidenteve të sigurisë kibernetike, që lidhen ose janë të shkaktuara nga palët e treta.	i. Regjistri i incidenteve kibernetike të lidhura me palët e treta (data, shkaku, ndikimi, veprimet).

1.5 MS5: Siguria e burimeve njerëzore dhe aksesit të personave

Të vendoset e të zbatohet një politikë për sigurinë dhe ndërgjegjësimin e burimeve njerëzore, si dhe të aksesit të personave, në bazë të objektivave të sigurisë në lidhje me personelin.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Vendosja e një politike sigurie për burimet njerëzore.	i. Politika e sigurisë për burimet njerëzore (përfshirë të gjitha fazat: para rekrutimit, gjatë punësimit, proceset disiplinore, në përfundim të marrëdhënies së punësimit). ii.Dokumenti i verifikimit të integritetit të personelit kryesor (vërtetim të verifikimit të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), referenca të punëve të mëparshme, certifikime, CV etj.). iii. Procedura për mbrojtjen e të dhënave personale.
1	b)Implementimi i një programi trajnimi për sigurinë kibernetike. (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit.)	i. Programi i detajuar i trajnimit, i përshtatur sipas roleve dhe përgjegjësive të punonjësve. ii.Lista e pjesëmarrësve dhe datat e trajnimeve. iii. Dokument i realizimit të fushatave të ndërgjegjësimit/trajnimeve të punonjësve në lidhje me

		sigurinë kibernetike dhe sulmet e sigurisë kibernetike më të shpeshta si "*Phishing*", "*Malware*" etj.
1	c)Informimi dhe trajnimi i punonjësve të rinj për politikat e procedurat në fuqi për sigurinë kibernetike.	i.Evidenca për trajnimin për punonjësit e rinj. ii.Formularë të nënshkruar nga punonjësit për njohjen e politikave dhe procedurave. iii. Formularë të nënshkruar nga punonjësit për marrëveshjen e konfidencialitetit ("NDA" - *Non Disclosure Agreement)*.
2	ç) Testimi i njohurive të punonjësve për sigurinë kibernetike. (Minimumi 1 (një) herë në vit për punonjësit, të cilët përdorin sistemet kritike të informacionit në infrastrukturë dhe/ose më shpesh në varësi të incidenteve kibernetike.)	i.Pyetësorë dhe rezultate testimi për ndërgjegjësimin e punonjësve në lidhje me sigurinë kibernetike.

1.6 MS6: Menaxhimi i aseteve

Të krijohen e të zbatohen procedurat e menaxhimit të aseteve dhe kontrollet e konfigurimit për të siguruar disponueshmërinë e aseteve kritike dhe konfigurimet e rrjeteve të komunikimit e të sistemeve të informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Marrja e masave për identifikimin dhe menaxhimin efektiv të aseteve. (Minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së).	i. Inventari i plotë i aseteve të teknologjisë së informacionit ("IT"- *Information Technology*) /teknologjisë operacionale ("OT"- *Operational Technology)*, duke përfshirë p.sh. modelin, kategorinë e aseteve, nr. serie, protokolli i internetit ("*IP*"- *Internet Protocol*), vendndodhjen, vjetërsinë, statusin e tyre etj. ii.Vendosja në inventar i ndikimit, sipas konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë *(*"C/I/A"- *Confidentiality/ Integrity/ Availability)* së asetit.
1	b.Vendosja dhe zbatimi i politikave/ procedurave për menaxhimin e aseteve.	i. Politika/procedura të detajuara për menaxhimin e aseteve, duke përfshirë rolet dhe përgjegjësitë, asetet që janë objekt i kësaj politike/procedure, objektivat e menaxhimit të aseteve, si dhe shkatërrimin e aseteve. (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së.) ii. Topologji e detajuar e rrjetit dhe sistemeve të informacionit.
1	c.Marrja e masave për zëvendësimin ose izolimin e sistemeve që iu ka përfunduar cikli i jetës ("EOL"- *End of Life*).	i. Dokument ose evidencë të identifikimit të sistemeve që iu ka përfunduar cikli i jetës (EOL) dhe planifikimi për zëvendësimin/izolimin e tyre. ii.Evidenca të zëvendësimit/izolimit të asetit, i cili ka arritur kohën e ciklit të jetës (EOL). iii. Verifikimi i sistemeve dhe evidencat.
1	ç. Kryerja e azhurnimeve ("*patch-imeve"*) automatike/manuale në sistemet fundore dhe në të gjithë infrastrukturën e teknologjisë së informacionit (IT) dhe teknologjisë operacionale (OT).	i. Procedurë për menaxhimin e zbatimit të azhurnimeve (*patch*-eve) për pajisjet dhe sistemet e teknologjisë së informacionit (IT) dhe teknologjisë operacionale (OT), përfshirë frekuencën, përgjegjësit, rekorde. ii.Verifikimi i sistemeve/ mjeteve ("*tools"*) dhe evidencat.
1	d.Përcaktimi dhe zbatimi i politikave e i kontrolleve të sigurisë për pajisjet personale të përdorura për akses në sistemet dhe të dhënat e infrastrukturës ("BYOD" – *Bring Your Own Device"*), duke siguruar mbrojtjen e informacionit dhe pajtueshmërinë me standardet e sigurisë.	i. Politikë/procedurë për përdorimin e pajisjeve personale (telefona, laptop, tableta etj.), si dhe një inventar të pajisjeve personale të autorizuara për t'u përdorur në rrjetet dhe sistemet e brendshme të infrastrukturës. ii.Evidenca të konfigurimeve minimale të sigurisë së pajisjeve personale sipas politikës.

1.7 MS7: Menaxhimi i incidenteve të sigurisë kibernetike

Të hartohen e të zbatohen plane e procedura për menaxhimin e incidenteve kibernetike, duke përfshirë zbulimin, reagimin, raportimin dhe komunikimin e tyre.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Hartimi i planeve dhe procedurave të detajuara për menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike. (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së).	i. Dokumenti i planit për menaxhimin e incidenteve kibernetike (versioni, data, miratimi). ii. Procedura për identifikimin, klasifikimin dhe trajtimin e incidenteve (manual veprimi - "*Playbooks*"), lista e personave të ekipit për reagimin ndaj incidenteve kibernetike).
1	b)Mbajtja e rekordeve për të gjitha incidentet e sigurisë kibernetike.	i.Regjistri i incidenteve që përfshin: datën, shkakun, ndikimin dhe veprimet korrigjuese. ii.Raporte individuale të trajtimit të incidenteve dhe analizat e mësimeve të nxjerra.
1	c)Përcaktimi dhe zbatimi i komunikimeve dhe raportimeve të incidenteve kibernetike me autoritetet dhe njoftimi i palëve të treta dhe klientëve.	i.Formularë raportimi të incidenteve për autoritetet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike nga ana e infrastrukturës. ii.Inventari i komunikimeve dhe raportimeve.

1.8 MS8: Menaxhimi i ndryshimeve

Të përcaktohen e të zbatohen politikat dhe proceset për menaxhimin e ndryshimeve përmes planifikimit, vlerësimit, miratimit, komunikimit, implementimit dhe monitorimit të ndryshimeve në infrastrukturë.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Sigurimi se çdo ndryshim në sistemet dhe proceset e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit (IT) brenda infrastrukturës kritike/të rëndësishme, menaxhohet në mënyrë të kontrolluar dhe të dokumentuar.	i. Politika e menaxhimit të ndryshimeve (përfshirë përshkrimin, datën, përgjegjësitë dhe impaktin e parashikuar, planin e zbatimit etj.). (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit.) ii.Procedura e menaxhimit të ndryshimeve (hapat nga propozimi deri tek miratimi dhe implementimi). iii. Formulari i kërkesës për ndryshim ("RFC" – *Request for Change*).

1.9 MS9: Menaxhimi i vazhdimësisë së punës

Të krijohen e të zbatohen plane emergjence dhe një strategji e qartë për të siguruar vazhdimësinë e rrjeteve të komunikimit e të sistemeve të informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Krijimi dhe zbatimi i një plani të vazhdimësisë së biznesit ("BCP"- *Business Continuity Plan*) për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të proceseve kritike të infrastrukturës në rast të incidenteve kibernetike, fatkeqësive natyrore ose ndërprerjeve operacionale. (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së).	i. Politika e strategjisë për vazhdimësinë e shërbimeve, duke përfshirë kushtet për aktivizimin e planit, kohën e rikuperimit, komunikimin në kohë krize, skenarët e incidenteve, planin e veprimit, rregullat e testimit etj. ii.Analiza e ndikimit në biznes ("BIA" - *Business Impact Analysis*), identifikimi i proceseve kritike dhe përcaktimi i objektivit të kohës/pikës së rikuperimit ("RTO" – *Recovery Time Objective* / "RPO" –*Recovery Time Objective*). iii. Lista e kontakteve emergjente – informacion për pikat e kontaktit në rast krize.
1	b.Shfrytëzimi i teknikave të pasqyrimit të të dhënave nëpërmjet konfigurimit redundant të disqeve të pavarur ("RAID" – *Redundant Array of Independent Disks*).	i.Verifikimi teknik i konfigurimit redundant të disqeve të pavarur ("RAID") (1/5/6/10) dhe evidencat përkatëse.
1	c.Realizimi i një politike/procedure për kryerjen e kopjeve rezervë (*backup*). (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë	i. Dokumenti i politikës/procedurës për kryerjen e kopjeve rezervë (*backup*-it) , duke përfshirë frekuencat, llojet, të dhënat dhe shërbimet.

	kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së).	ii.Lista e kopjeve rezervë (*backup*-eve) të kryera dhe raportet e testimit të rikuperimit dhe integritetit të të dhënave.
2	ç. Realizimi i kopjeve rezervë (*backup*-it), duke përdorur teknika, si "*Backup Lock Retention*" ose "*Tape Worm*".	i. Evidenca të përdorimit të teknikave "*Backup Lock Retention*" ose "*Tape Worm*".
2	d.Shmangia e pikave të vetme të dështimit (*Single Point of Failure*) në shërbimet kritike dhe të rëndësishme të infrastrukturës.	i. Verifikimi teknik i pikave të vetme të dështimit. ii.Evidenca për redundancën e shërbimeve.
2	dh. Implementimi i infrastrukturës sipas skemave të shërbimit me disponueshmëri të lartë ("HA" – *High Availability*).	i. Dokument i skemave të infrastrukturës, sipas shërbimit me disponueshmëri të lartë (HA) në nivelet e mbështetjes teknike: L1, L2, L3 dhe perimetrit me mur mbrojtës digjital (*firewall*). ii.Verifikim dhe evidenca.
2	e.Implementimi i një ambienti të dytë për rikuperimin dhe vazhdueshmërinë e funksionimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit (IT) pas një incidenti kibernetik ("DRS" – Vendi i rikuperimit nga katastrofa/*Disaster Recovery Site*).	i. Strategjia për DRS-në dhe konfigurimet e detajuara. (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së). ii.Plani i rikuperimit nga fatkeqësitë (*DRS*), procedurat për rikuperimin e teknologjisë së informacionit (IT) dhe infrastrukturës (detyrat dhe përgjegjësitë, lista e sistemeve dhe aseteve kyçe), (rishikim minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së). iii. Raporte të testimit të ambientit të dytë për rikuperimin dhe vazhdueshmërinë e funksionimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit për rikuperim pas incidenteve/katastrofave (DRS). (Minimumi 1 herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së). iv. Verifikim dhe evidenca.
2	Opsionale: ë) Zbatimi i teknologjisë së rrjetit të përcaktuar nga *Software* ("SDN" – *Software Defined Networking*) që shërbimet dhe aplikacionet kritike të kenë mundësi rikuperimi sa më të shpejtë dhe me një ndërprerje minimale (ose pa ndërprerje) të shërbimeve në rast katastrofash ose incidentesh. f) Zbatimi i teknologjisë "*Blockchain*" për decentralizimin e menaxhimit të të dhënave duke siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe paprekshmërinë e tyre gjatë rikuperimit.	i.Strategji për të siguruar që shërbimet dhe aplikacionet kritike (përfshirë ato që mbështeten në teknologjitë e rrjetit të përcaktuar nga *softwar*-i (SDN) dhe "*Blockchain*") të kenë mundësi rikuperimi sa më të shpejtë dhe me një ndërprerje minimale, në rast katastrofash apo incidentesh. ii.Testime periodike të konfigurimeve të teknologjisë së rrjetit të përcaktuar nga *softwar* (SDN) . iii. Verifikimi i zbatimit të teknikës "*Hashing*". iv. Politika e kopjeve rezervë (*backup*) për teknologjinë "*Blockchain*". v.Monitorimi i aktivitetit në "*Blockchain*".

1.10 MS10: Menaxhimi i pajtueshmërisë ligjore

Të krijohet e të zbatohet një politikë për monitorimin e pajtueshmërisë së standardeve me kërkesat ligjore.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Monitorimi i pajtueshmërisë së standardeve me kërkesat ligjore.	i.Politikë/procedurë për monitorimin e pajtueshmërisë me standardet dhe kërkesat ligjore. ii.Lista e standardeve dhe kërkesave ligjore të aplikueshme për infrastrukturën.

		iii. Rishikimi i politikave dhe procedurave për sistemin e menaxhimit të informacionit ("ISMS" – *Information Security Management System*), minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së.

1.11 MS11: Kontrolli dhe auditimi

Të krijohen e të zbatohen politika e procedura për kryerjen e kontrolleve dhe auditimeve të brendshme e të jashtme, me qëllim monitorimin e pajtueshmërisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së informacionit në infrastrukturë.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Politikë/procedurë për kontrollin dhe auditimin e brendshëm për sigurinë e informacionit dhe rishikimi në mënyrë periodike. (Minimumi 1 herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së.)	i. Dokument i politikës/procedurës për kontrolle dhe auditime (versioni, data, miratimi i politikës/procedurës nga stafi menaxherial).
1	b.Kryerja e kontrolleve/auditeve të brendshme ose nga palët e treta për sigurinë e informacionit dhe sistemeve kritike të infrastrukturës. (Minimumi 1(një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së.)	i.Raporte të auditimeve të brendshme dhe plani i trajtimit të mangësive (data, metodologjia, rezultatet). ii.Raporte të auditimeve të realizuara nga palët e treta për sigurinë e informacionit. iii. Lista e veprimeve korrigjuese të ndërmarra pas auditimeve dhe evidenca e implementimit të tyre.

KREU IV
MASAT TEKNIKE DHE OPERACIONALE

2. Masat teknike dhe operacionale përfshijnë:

2.1 MS1: Siguria fizike

Të krijohet e të zbatohet siguria e duhur fizike dhe mjedisore e rrjeteve/sistemeve të informacionit e pajisjeve.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Implementimi i masave të sigurisë fizike dhe kontrolleve mjedisore.	i.Evidenca të implementimit të masave të sigurisë fizike (brava, kabinete, kontroll elektronik i hyrjes). ii.Gjurmë të aktiviteteve (*logs*) të auditimit për aksesin në hapësira të autorizuara dhe alarme për hyrjet e paautorizuara. iii. Raporte të funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të alarmit dhe fikësve të zjarrit. iv. Të sigurohet ndarja e hapësirave fizike në zona të segmentuara bazuar në nivelet e autorizimit, duke përfshirë hartimin e një topologjie të detajuar dhe një plani të qartë evakuimi për të garantuar sigurinë fizike dhe menaxhimin e aksesit.
1	b)Implementimi i një politike për masat e sigurisë fizike dhe kontrollet mjedisore.	i.Dokumenti i politikës për sigurinë fizike dhe kontrollet mjedisore (versioni, data, miratimi, rishikimi).

2.2 MS2: Menaxhimi për autorizimin e aksesit

Të krijohen e të mirëmbahen kontrollet e autorizimet e duhura të aksesit në rrjetet e komunikimit dhe sistemet e informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Implementimi i politikave për kontrollin dhe mbrojtjen e aksesit në rrjetet dhe	i.Dokument i politikës për aksesin (role, grupe, të drejta, procedurat e dhënies dhe revokimit të aksesit).

	sistemet e informacionit. (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së.)	ii. Formular për dhënie të drejtash aksesi. iii. Formular për revokim të drejtash aksesi dhe dorëzimi asetesh. iv. Evidenca për fshirjen e llogarive gjenerike dhe raportet e kontrolleve periodike të aksesit.
1	b)Aplikimi i filtrave për trafikun në rastin e aksesimit në distancë të sistemeve, si dhe enkriptimi i trafikut me protokolle të sigurta.	i.Verifikimi teknik dhe evidencat për vendosjen e filtrave dhe enkriptimin e trafikut.
1	c)Kontrolli nëse në murin mbrojtës digjital (*firewall*) ka të konfiguruar lista të autorizuara/lista të bllokuara ("*Whitelist/Blacklist*") të adresave të protokollit të internetit (*IP*) të lejuara ose bllokuara.	i.Verifikim dhe evidenca për konfigurimet në murin mbrojtës digjital (*firewall*).
1	ç. Përdorimi i politikave për menaxhimin e fjalëkalimeve rastësore për përdoruesit dhe administratorët lokalë.	i.Dokumenti i politikës për menaxhimin e fjalëkalimeve dhe verifikim i implementimit të zgjidhjeve për menaxhimin e fjalëkalimeve rastësore për përdoruesit dhe administratorët lokalë ("LAPS"- *Local Administrator Password Solution*) ose teknologji të ngjashme.
2	d.Krijimi dhe implementimi i një zgjidhje teknologjike për menaxhimin e identiteteve dhe aksesit të përdoruesve ("IAM" – *Identity and Access Management)* për të garantuar sigurinë, autorizimin dhe auditimin e aktiviteteve të përdoruesve në sistemet kritike.	i.Verifikim teknik dhe evidenca.
2	dh. Implementimi i një zgjidhjeje teknologjike për menaxhimin e akseseve të privilegjuara ("PAM") – *Privileged Access Management*)	i.Verifikim teknik dhe evidenca.
2	e.Implementimi i shërbimit të sigurisë me akses në rrjet, sipas parimit me zero besim ("ZTNA" - *Zero Trust Network Access*")	i.Verifikim teknik dhe evidenca.

2.3 MS3: Pajisjet kriptografike

Të sigurohet përdorimi i mjaftueshëm i enkriptimit për të parandaluar dhe/ose për të minimizuar ndikimin e incidenteve të sigurisë kibernetike te përdoruesit në rrjetet e komunikimit dhe në sistemet e informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Implementimi i politikave të enkriptimit, duke përfshirë detaje rreth algoritmeve dhe çelësave kriptografikë.	i.Dokumenti i politikës së enkriptimit si p.sh. algoritmet: "*AES*", "*RSA*", "*ECC*", "*TLS*", "*IPSec*", "*SSH*" etj. ii.Lista e çelësave kriptografikë (p.sh., lloji, afati i vlefshmërisë, metoda e gjenerimit dhe ruajtjes).
2	b)Kriptimi i të dhënave (në transit dhe në gjendje të qëndrueshme).	i.Lista e konfigurimeve të kriptimit për të dhënat dhe aplikacionet ("*on-prem*", "*hybrid*", "*cloud*"). ii.Verifikimi teknik dhe evidenca.

2.4 MS4: Zbulimi i incidenteve të sigurisë kibernetike

Të krijohen e të mirëmbahen kapacitete për zbulimin e incidenteve të sigurisë kibernetike.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Implementimi i sistemit të automatizuar për zbulimin dhe menaxhimin e informacionit e të incidenteve/ngjarjeve të	i.Verifikim teknik dhe evidenca të konfigurimit të sistemit të automatizuar për zbulimin dhe menaxhimin e informacionit e të incidenteve/ngjarjeve të sigurisë

	sigurisë ("*SIEM*" - *Security Information and Event Management*).	(SIEM), përfshirë rregullat e alarmimit e të filtrimit të gjurmëve dhe aktiviteteve (*log*-eve) për zbulimin e incidenteve.

2.5 MS5: Mbledhja dhe përpunimi i informacionit për kërcënimet kibernetike

Të krijohet e të mirëmbahet një mekanizëm për monitorimin, mbledhjen dhe analizën e informacionit në lidhje me kërcënimet e sigurisë në rrjetet e komunikimit dhe në sistemet e informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Monitorimi i vazhdueshëm i burimeve të jashtme të inteligjencës për kërcënimet kibernetike "*threat intelligence*".	i.Raporte periodike nga mjetet e monitorimit të inteligjencës për kërcënimet kibernetike "*threat intelligence*". ii.Lista e burimeve të përdorura për mbledhjen e informacionit për kërcënimet.
2	b)Zbatimi i programit të inteligjencës për kërcënimet kibernetike "*threat intelligence*", në të cilin të përfshihen rolet, përgjegjësitë dhe procedurat.	i.Dokument i programit të inteligjencës për kërcënimet kibernetike "*threat intelligence*" (përfshirë strukturën e roleve dhe përgjegjësive). ii.Procedura për mbledhjen, përpunimin, analizën dhe shpërndarjen e informacionit për kërcënimet kibernetike.

2.6 MS6: Monitorimi dhe regjistrimi i ngjarjeve të sigurisë kibernetike

Të krijohen e të mirëmbahen sisteme dhe funksione për monitorimin dhe regjistrimin e ngjarjeve të sigurisë në rrjetet kritike e në sistemet e informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Implementimi i politikave për monitorimin dhe regjistrimin e ngjarjeve të sigurisë kibernetike.	i.Dokument i politikave për monitorimin dhe regjistrimin e gjurmëve e të aktiviteteve (*log*-eve), ku përfshihen kërkesat minimale, periudha e mbajtjes, objektivat, miratimi, përditësimi.
1	b)Vendosja e mjeteve për mbledhjen e gjurmëve dhe aktiviteteve (*log*-eve) të sistemeve kritike.	i.Lista e mjeteve të implementuara për mbledhjen e gjurmëve dhe aktiviteteve/ logeve të *log servers* etj. ii.Verifikim teknik dhe evidenca.

2.7 MS7: Mbrojtja e integritetit të rrjeteve të komunikimit

Të krijohet e të ruhet integriteti i rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, si dhe të mbrohen nga viruset, injeksionet e kodeve dhe *malware*-ve të tjerë, që mund të ndryshojnë funksionalitetin e sistemeve.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Instalimi i pajisjeve për të monitoruar për të kontrolluar dhe për të kufizuar trafikun hyrës e dalës të rrjeteve kompjuterike me murin mbrojtës digjital të gjeneratës së re ("*Next Generation Firewall*").	i.Verifikim teknik për konfigurimin të murit mbrojtës digjital i gjeneratës së re. ii.Verifikimi teknik dhe evidencat.
1	b.Monitorimi, zbulimi dhe analiza e sjelljeve të dyshimta sjellje (*behaviour*) në pajisjet fundore (*endpoints*), si kompjuterët, laptopët dhe serverët. Ky sistem mbledh dhe analizon të dhëna nga pajisjet fundore për të zbuluar kërcënime të sofistikuara.	i.Verifikim teknik dhe evidenca të analizave të trafikut.
1	c.Ndarja e rrjetit në nënrrjete në nivel mikrosegmentimi.	i.Verifikimi teknik dhe evidenca e topologjisë së rrjetit me ndarjen e dokumentuar në nënrrjete.
1	ç. Vendosja në zona/ nënndarje të rrjetit/ rrjet lokal virtual (*zone/subnet/VLAN - Virtual Local Area Network*) të ndryshme e kompjuterëve dhe serverëve me lista të aksesit të kontrollit (*Access Control List*) sipas parimit të të drejtave minimale ("*least privilege*").	i.Lista e rrjet lokal virtual (VLAN*)* dhe nënndarje të rrjetit të implementuara, përfshirë listat e kontrollit të aksesit. ii.Verifikimi teknik dhe evidencat.

1	d.Izolimi i rrjetit pa tela ("*wireless*") nga pjesa tjetër e rrjetit.	i.Verifikim teknik dhe evidencat e konfigurimit të izolimit të rrjetit pa tela (*wireless*).
1	dh. Përdorimi i teknikave të sigurisë së portave të *switch*-it ("*switch port security*") "për të kufizuar numrin e adresave unike të identifikimit të pajisjes së lidhur në rrjet (MAC *Address*) në "1" për përdoruesit e thjeshtë dhe në një numër të kufizuar për ekspertët e teknologjisë të informacionit ose sigurisë kibernetike.	i.Verifikimi teknik i konfigurimit të *switch*-eve, duke zbatuar teknikën e sigurisë së portave "*Port Security*" për numrin unik të identifikimit të pajisjes së lidhur në rrjet (MAC *Address*) të lejuara.
1	e.Zbatimi i teknikave dhe standardeve për fortifikimin ("*hardening*") e të gjitha pajisjeve në rrjet.	i.Manual për fortifikimin e pajisjeve (*PC,* "*server*", "*router*", "*firewall*" etj.). ii.Verifikimi teknik dhe evidencat.
1	ë. Izolimi logjikisht i bazës së të dhënave dhe shërbimet WEB (p.sh. në rrjet lokal virtual/*VLAN)* të ndryshëm).	i.Lista e rrjetit lokal virtual (VLAN) dhe verifikimi teknik i konfigurimit për izolimin logjik të bazës së të dhënave dhe shërbimeve WEB. ii.Verifikimi teknik dhe evidencat.
1	f.Implementimi i "*DNS_SEC*" për të shmangur "*DNS Amplification*" dhe "*DNS Poisoning*".	i. Verifikimi teknik dhe evidencat.
2	g.Zbatimi i mbrojtjes ndaj sulmeve DoS/DDoS.	i.Verifikim teknik i konfigurimit të mekanizmave të mbrojtjes nga DoS/DDoS (p.sh. "*rate limiting*", "WAF" - *Web Application Firewall*, mjete (*tools*) për "*anti-DDoS*").
2	gj. Implementimi i një zgjidhjeje/sistemi për kontrollin e parametrave të sigurisë së pajisjeve fundore ("NAC" - *Network Access Control).*	i.Procedurë për përcaktimin e parametrave të sigurisë minimale (*baseline*). ii.Verifikimi teknik dhe evidencat.

2.8 MS8: Menaxhimi i aksesit të përdoruesve

Të implementohen politikat për menaxhimin e fjalëkalimeve dhe dhënien e aksesit sipas modeleve kontroll diskrecional i aksesit ("DAC"- *Discretionary Access Control*"), kontroll i detyrueshëm i aksesit ("MAC" -*Mandatory Access Control*") dhe kontroll i aksesit bazuar në role ("RBAC*" – Role Based Access Control*). Të përdoret shërbimi *Active Directory* (*AD*) për menaxhimin e privilegjeve dhe kufizimin e aksesit të paautorizuar në pajisje.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Implementimi i politikave për menaxhimin e fjalëkalimeve të përdoruesve.	i.Dokument i politikës për menaxhimin e fjalëkalimeve (kompleksiteti, afati i skadimit, ndryshimet periodike).
1	b.Modelet për dhënien e aksesit të përdoruesve (kontroll diskrecional i aksesit (DAC), kontroll i detyrueshëm i aksesit (MAC) dhe kontroll i aksesit bazuar në role (RBAC).	i.Evidenca teknike të konfigurimeve e të rregullave të zbatuara në sistem dhe verifikim.
1	c.Menaxhimi i aksesit dhe privilegjeve të përdoruesve përmes shërbimit "AD".	i.Verifikim teknik dhe evidenca të implementimit të "AD" – në (strukturat e grupeve, privilegjet, kufizimet).
1	ç. Sigurimi dhe mbrojtja e të dhënave dhe kufizimi i aksesit të paautorizuar në informacion.	i.Verifikim i zbatimit të politikës / procedurës "*Clean Desk*" dhe politikës / procedurës së kyçjes automatike të ekranit pas një kohe pasive ("*idle*").
2	d.Implementimi i sistemeve me 2 (dy) faktorë autentifikimi ("2FA" -*Two-Factor Authentication*) në nivel aplikacioni /*web/ mail*/ pajisje për të gjithë përdoruesit e sistemit kritik.	i.Verifikimi dhe evidenca

2.9 MS9: Veprimtaria dhe autentifikimi i administratorëve

Të sigurohet aksesi i administratorëve, duke zbatuar autentifikimin me shumë faktorë ("MFA"- *Multi-Factor Authentication*) në aplikacione, *web, email* dhe pajisje. Të përdoren platforma për parandalimin e humbjes së të dhënave ("DLP" - *Data Loss Prevention*) për parandalimin e rrjedhjes së paautorizuar të informacionit.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Implementimi i metodës së autentifikimit me shumë faktorë (MFA), në nivel aplikacion/*web*/ *mail*/ pajisje për administratorët.	i.Verifikimi dhe evidencat e implementimit të metodës së autentifikimit me shumë faktorë (MFA).
2	b.Përdorimi i metodës për parandalimin e humbjes së të dhënave (DLP) për identifikimin dhe parandalimin e rrjedhjes së paautorizuar të të dhënave të ndjeshme jashtë infrastrukturës.	i.Verifikimi i implementimit të metodës për parandalimin e humbjes së të dhënave (DLP) për rrjedhjen e të dhënave të ndjeshme.

2.10 MS10: Siguria e aplikacioneve

Të sigurohet mbrojtja e aplikacioneve, duke kryer testime të sigurisë për vlerësimin e dobësive ("VA"- *Vulnerability Assessment*) dhe testimi i penetrimit ("*Penetration Test*") e duke trajtuar problematikat e evidentuara.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Kryerja e testimeve për vlerësimin e sigurisë së aplikacioneve e rrjeteve të teknologjisë së informacionit për vlerësimin e dobësive (VA) dhe hartimi i planit për trajtimin e problematikave të evidentuara. (Minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së).	i.Raporti i vlerësimit të dobësive dhe plani i trajtimit.
1	b.Kontrolli nëse shërbimet *web* ("*web services*") operojnë duke zbatuar protokollin e sigurt "*https*".	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca vizuale të konfigurimeve përmes "*screenshot*", *log*-eve dhe dokumentimit të detajuar të parametrave teknikë).
1	c.Konfigurimi i "*anti-spoofing*": DMARC /SPF/DKIM në sistemin e *e-mail*-it.	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca e implementimit të *anti-spoofing* në sistemin e *e-mail*-it).
1	ç. Realizimi i testimeve të zhvillimit të *software*-ve ("*staging/testing*") në ambient të dedikuar dhe të ndarë nga ambienti i prodhimit ("*production*"), nëse infrastruktura ka një departament zhvillimi.	i.Verifikimi i evidencave të ambientit të dedikuar për testime të *software*-ve, të ndarë nga ambienti i prodhimit.
2	d.Implementimi i një zgjidhjeje për filtrimin, monitorimin dhe bllokimin e trafikut keqdashës në internet, me mur mbrojtës digjital për sigurinë e aplikacioneve *Web* ("WAF"- *Web Application Firewall*).	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca vizuale të konfigurimeve përmes *screenshot*, *log*-eve dhe dokumentimit të detajuar të parametrave teknikë).
2	dh. Implementimi i "*Reverse Proxy*" në një server që qëndron midis klientëve dhe serverëve të brendshëm "*backend servers*" dhe vepron si ndërmjetës për të përpunuar kërkesat nga klientët dhe për t'i përcjellë ato te serverët e brendshëm.	i.Verifikimi i implementimit të "*Reverse Proxy*" në serverat *web* (p.sh. evidenca vizuale të konfigurimeve përmes *screenshot*, *log*-eve dhe dokumentimit të detajuar të parametrave teknikë).
2	e.Kryerja e testimeve për vlerësimin e sigurisë së aplikacioneve dhe rrjeteve (*Penetration Test – Black, Gray, White*) dhe hartimi i një plani për trajtimin e problematikave të evidentuara. (Minimumi 1 (një) herë në vit dhe/ose mbas çdo incidenti	i.Raporti i testimeve të llojeve: "*black*", "*grey*", "*white*" për vlerësimin e sigurisë së aplikacioneve dhe rrjeteve (*penetration test*) dhe plani i trajtimit.

	të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI-së/OIRI-së).	

2.11 MS11: Siguria e prodhimit të *software*-ve

Siguria e prodhimit të *software*-ve për infrastrukturat kritike apo të rëndësishme përfshin praktikat dhe masat që mundësojnë projektimin, zhvillimin, testimin, dhe implementimin e *software*-ve me siguri të lartë për të mbrojtur infrastrukturat nga sulmet kibernetike.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Implementimi i një procedure sigurie për projektimin dhe zhvillimin e *oftware*-ve. (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit).	i.Dokumentim i procedurës së sigurisë për projektimin dhe/ose zhvillimin e *software*-ve. ii.Procedura duhet të miratohet nga stafi i lartë menaxherial dhe të rishikohet në mënyrë periodike.
1	b.Kontrolli dhe monitorimi i aksesit të zhvilluesve dhe përdoruesve të *software*-ve.	i.Të përfshihen në procedurë specifika, si mënyra e autentifikimit, autorizimit, enkriptimit për zhvilluesit e *software*-ve. ii.Të përcaktohen qartë të drejtat dhe akseset për përdoruesit e *software*-ve.
1	c.Ruajtja e historikut të ndryshimeve/ konfigurimeve/ aprovimit të zhvillimit të kodit burim (*source code*) të *software*-it.	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca vizuale të konfigurimeve përmes "*screenshot*", *log*-eve dhe dokumentimit të detajuar të parametrave teknikë).
1	ç. Analiza e rrezikut dhe sigurisë të *software*-it para se të dalë në prodhim (*production*).	i.Raporte të analizës së rrezikut dhe sigurisë së *software*-it para se të dalë në prodhim, duke përfshirë dhe varësinë nga libraritë e palëve të treta (*third party libraries*).
1	d.Trajtimi dhe dokumentimi i incidenteve të sigurisë kibernetike për zhvillimin e *software*-ve.	i.Raportet e auditit dhe *log*-et e incidenteve të zhvillimit te *software*-ve.
1	dh. Monitorimi i vendit të ruajtjes (*repository*) së kodit burim të *software*-it.	i.Raporte monitorimi të vendit të ruajtjes (*repository*) së kodit burim të *software*-it.
1	e.Enkriptimit të kodit burim ("*source code*") në ruajtje dhe në transmetim.	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca e kodit të enkriptuar në ruajtje dhe transmetim).
1	ë. Realizimi i lidhjes së enkriptuar të aplikacionit me bazën e të dhënave (*"connection string").*	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca e enkriptimit të lidhjes së aplikacionit me bazën e të dhënave).
1	f.Realizimi i *backup*-it të kodit burim dhe testimi i integritetit të *backup*-it.	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca e pranisë së kopjes së kodit burim dhe testeve për rikuperimin e kodit përmes kopjes së ruajtur).
2	g.Automatizimi nëpërmjet "*pipeline*" ("CI/CD" – *Continuous Integration / Continuous Delivery /Deployment*) integrimit të vazhdueshëm / zhvillim/ implementimit i vazhdueshëm të procesit të zhvillimit, testimit dhe publikimit të *software*-ve.	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca vizuale të konfigurimeve dhe funksionimit të CI/CD përmes "*screenshot*", *log*-eve dhe dokumentimit të detajuar të parametrave teknikë).
2	gj. Implementimi i masave të sigurisë për mikroshërbimet ("*microservices*"), duke përfshirë izolimin e burimeve, monitorimin e vazhdueshëm dhe aplikimin e kontrolleve të aksesit.	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca vizuale të konfigurimeve përmes "*screenshot*", *log*-eve dhe dokumentimit të detajuar të parametrave teknikë).

2.12 MS12: Siguria e sistemeve të teknologjisë operacionale (OT)

Të sigurohet mbrojtja e sistemeve të teknologjisë operacionale, duke zbatuar parimin e aksesit minimal, segmentimin e rrjeteve dhe enkriptimin e protokolleve kritike. Të implementohen masa për kontrollin e aksesit, monitorimin në kohë reale dhe mbrojtjen e pajisjeve nga sulmet kibernetike dhe "*malware*".

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a.Zbatimi i parimit të privilegjeve të aksesit minimal "*Least privileges*", duke vendosur kontroll të aksesit të bazuar në role (RBAC) për përdoruesit, Lista e Kontrollit të aksesit ("ACL" - *Access Control List*") për filtrimin e trafikut, si dhe mbylljen e shërbimeve të panevojshme në sistemet kritike të teknologjisë operacionale (OT)	i.Verifikimi teknik dhe evidencat.
1	b.Implementimi i TLS/SSL, VPN për protokollet (MODBUS, IEC 104/105, DNP3, OPC UA, MQTT).	i.Verifikimi teknik dhe evidenca.
1	c.Implementimi i teknikave "Hot" dhe "*Cold*" *backups*, për ruajtjen e të dhënave.	i.Verifikimi teknik dhe evidenca.
1	ç. Implementimi i një zgjidhjeje për menaxhimin e aksesit në distancë, sipas parimit me zero besim (ZTNA).	i.Verifikimi teknik dhe evidenca.
1	d.Menaxhimi i kontrolluar i *patch*-eve dhe konfigurimeve, duke e testuar më parë në ambiente testi.	i.Verifikimi teknik dhe evidenca.
1	dh. Implementimi i një zgjidhjeje për kontrollin e *software*-it në zonën e "*production*", duke përdorur teknika si "*Application Whitelisting*", në mënyrë manuale apo automatike për të lejuar vetëm aplikacionet e autorizuara të ekzekutohen.	i.Verifikimi teknik dhe evidenca.
1	e.Implementimi i mbrojtjes së pikave fundore, duke përfshirë mekanizmat e detektimit, reagimit apo izolimit të sulmit në nivel "*signature*" dhe sjelljeje "*behaviour*".	i.Verifikimi teknik dhe evidenca.
1	ë. Zbatimi i teknikës "*Hardening*" i pajisjeve të teknologjisë operacionale, si (PLC, RTU, HMI, SCADA, BMS etj).	i.Verifikimi teknik dhe evidenca.
1	f.Ndarja e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit nga teknologjia operacionale (duke siguruar shërbime të veçanta për çdo infrastrukturë, si "*Active Directory*", "Antivirus", mur mbrojtës i gjeneratës së re ("*NextGen Firewall*") dhe SIEM, që janë të dedikuara për teknologjinë operacionale.	i.Verifikimi teknik dhe evidenca.
2	g.Implementimi i monitorimit në kohë reale i veprimeve operacionale në sistemet e teknologjisë operacionale, si dhe regjistrimi, analiza dhe njoftimi i ngjarjeve bazuar në funksionet e rëndësinë e tyre për operacionet kritike.	i.Verifikimi teknik dhe evidenca.

2.13 MS13: Siguria e sistemeve "*IoT – Internet of Things*"

Të hartohen e të zbatohen procedura për sigurinë e pajisjeve "*IoT*", duke përfshirë përdorimin e mekanizmave që garantojnë integritetin dhe konfidencialitetin e sistemeve. Të implementohen azhurnime të sigurta dhe të sigurohet mbrojtja e çelësave të autentifikimit në pajisjet "*IoT*".

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Hartimi, miratimi, zbatimi dhe rishikimi në mënyrë periodike i procedurave për sigurinë e pajisjeve dhe sistemeve "*IoT*".	i.Procedura për sigurinë e pajisjeve dhe sistemeve "*IoT*".
1	b)Siguria e pajisjeve "*IoT*" – - Përcaktimi i kërkesave minimale për pajisjet "*hardware*". - Përdorimi i mekanizmave që garantojnë integritet ("*tamper proof*") dhe konfidencialitet (*Trusted Platform Module*). - Aplikimi i azhurnimeve/përditësimeve të sigurta të sistemeve të operimit dhe "*firmware*". - Garantimi i sigurisë së çelësave të autentifikimit. - Kryerja e analizave të trafikut në nivel sjellje (kur aplikohet).	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca vizuale të konfigurimeve përmes "*screenshot*", *log*-eve dhe dokumentimit të detajuar të parametrave teknikë).
2	c)Garantimi i integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave të transmetuara ndërmjet pajisjeve "*IoT*". - Përdorimi i certifikatave autentifikimi që ofrojnë siguri (pajisjet me Hub ose *Central* "*IoT*"). - Garantimi i komunikimit të sigurt (TLS 1.2 e lart). - Sigurimi i të dhënave të "*IoT*" kur transmetohen dhe ruhen. - Përcaktimi i qartë i kontrolleve të aksesit ("*IoT hub*" dhe aplikimit "*IoT Central*"). - Realizimi i monitorimit të sigurisë së zgjidhjeve "*IoT*".	i.Verifikimi teknik dhe evidencat (p.sh. evidenca vizuale të konfigurimeve përmes "*screenshot*", *log*-eve dhe dokumentimit të detajuar të parametrave teknikë).

2.14 MS14: Siguria në shërbimet *Cloud*

Siguria në shërbimet "*Cloud*" përfshin masat dhe politikat që sigurojnë mbrojtjen e të dhënave e të shërbimeve të infrastrukturës, duke përfshirë autentifikimin e fuqishëm, enkriptimin e të dhënave dhe monitorimin e aktiviteteve. Këto masa synojnë të garantojnë integritetin, disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e sistemeve të përdorura në "*Cloud*", si dhe përputhshmërinë me kërkesat teknike dhe marrëveshje për nivelin e shërbimit ("SLA"- *Service Level Agreement*) e dakorduara me ofruesit e shërbimeve.

Niveli	Masat e sigurisë	Dokumentimi/verifikimi i implementimit
1	a)Vendosja e një politike/procedure të qeverisjes për shërbimet në "*Cloud*".	i.Politika/procedura për sigurinë në "*Cloud*".
1	b)Përfshirja e kërkesave teknike, organizative dhe të sigurisë në marrëveshjet e nivelit të shërbimit (SLA) me ofruesit e shërbimeve "*Cloud*".	i.Dokumenti i marrëveshjes për nivelin e shërbimit (SLA), që përfshin indikatorët kryesorë të performancës, metrikat e monitorimit, sigurisë dhe rikuperimit.
1	c)Implementimi i autentifikimit të fuqishëm, si autentifikimi me shumë faktorë (MFA) për aksesin e platformës së administrimit dhe shërbimeve në "*Cloud*".	i.Verifikimi dhe evidencat për implementimin e autentifikimit në "*Cloud*".
1	ç) Implementimi i një mekanizmi enkriptimi për të dhënat në ruajtje dhe në transit.	i.Verifikim teknik dhe evidenca.
1	d)Realizimi i kopjes rezervë (*backup*) të rregullt të shërbimeve kritike dhe të rëndësishme në "*Cloud*".	i. Verifikim teknik dhe evidenca.
1	dh) Realizimi i aktivizimit të *log*-eve dhe monitorimi i aktiviteteve të infrastrukturës në "*Cloud*".	i.Verifikim teknik dhe evidenca.

2	e)Implementimi i një arkitekture të sigurisë së rrjetit që kombinon funksionet e rrjetit dhe sigurisë së teknologjisë së informacionit në një platformë të unifikuar, të bazuar në "*Cloud*". Përdorimi i shërbimit të sigurt për aksesin në skaj të rrjetit ("SASE" – *Secure Access Service Edge*).	i.Verifikim teknik i zgjidhjes të shërbimit të sigurt për aksesin në skaj të rrjetit (SASE). ii.Verifikimi dhe evidenca e përdorimit të shërbimit të sigurt për aksesin në skaj të rrjetit (SASE) nga përdoruesit.

KREU V
KATEGORIZIMI I AFATEVE TË MASAVE KORRIGJUESE

1. Bazuar në nenin 43, të ligjit nr. 25/2024, "Për sigurinë kibernetike", në rastet kur AKSK-ja konstaton mangësi në zbatimin e masave të sigurisë, përcakton një afat të arsyeshëm, brenda të cilit operatorët e infrastrukturës kritike e të rëndësishme të informacionit marrin masat korrigjuese përkatëse.

2. Afatet për përmbushjen e mangësive të konstatuara në lidhje me masat e sigurisë përcaktohen, bazuar në nivelin e rrezikut për çdo mangësi apo gjetje.

3. Nivelet e vlerësimit të rrezikut dhe afatet për implementimin e masave korrigjuese janë, si më poshtë vijon:

Vlera e rrezikut	**Niveli i rrezikut**	**Koha e trajtimit**
[1-3]	Shumë i ulët	Nuk ka nevojë për trajtim
[4-6]	I ulët	Nuk ka nevojë për trajtim
[7-11]	Mesatar	Ka nevojë për trajtim brenda afatit kohor prej 12-muajsh
[12-19]	I lartë	Ka nevojë për trajtim brenda afatit kohor prej 6-muajsh
[20-25]	Shumë i lartë	Ka nevojë për trajtim brenda afatit kohor prej 3-muajsh

4. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) mund të vendosë shtyrjen e afateve për përmbushjen e masave korrigjuese nga operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit (OIKI) dhe operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit (OIRI). Ky vendim merret vetëm në raste të veçanta, bazuar në një vlerësim të dokumentuar të rrethanave specifike, me kërkesë të argumentuar nga infrastruktura përkatëse ose me nismë të vetë AKSK-së.

5. Operatorët janë të detyruar të njoftojnë AKSK-në për marrjen e masave korrigjuese, brenda afatit të përcaktuar, si dhe të paraqesin dokumentacionin mbështetës për këto masa.

VENDIM
Nr. 536, datë 25.9.2025

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE BANKËS SË TIRANËS SHA, PËR KONTRATËN E KREDISË, NDËRMJET BANKËS SË TIRANËS SHA DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SHA, DHE OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE) GROUP SHA DHE OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA, DHE FURNIZUESIT TË TREGUT TË LIRË (FTL) SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës së Tiranës sh.a., për kontratën e kredisë, ndërmjet Bankës së Tiranës sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL) sh.a., në shumën 20 000 000 (njëzet milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Group sh.a., Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. dhe Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KËSHILLI I MINISTRAVE
PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. _____ prot.
Tiranë, më ____.____.2025

BANKA E TIRANËS
SHA

Nr. _____ prot.
Tiranë, më ____.____.2025

MARRËVESHJE GARANCIE
PËR KONTRATËN E KREDISË, NDËRMJET BANKËS SË TIRANËS SHA DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SHA, DHE OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE (OSHEE) GROUP SHA DHE OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH) SHA, DHE FURNIZUESIT TË TREGUT TË LIRË (FTL) SHA
Deri në vlerën 20 000 000 euro
datë

_____

Duke qenë se, sipas kontratës për kredi afatgjatë nr. XXX rep., nr. XXX kol., datë XXX (më poshtë referuar si "Kontrata e kredisë"), lidhur ndërmjet "Bankës së Tiranës" sh.a. (kredidhënësi) dhe "Furnizuesit të Shërbimit Universal" (FSHU) sh.a. (këtu e më poshtë referuar si kredimarrësi), dhe "Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" sh.a., këtu (bashkëkredimarrës), dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.) (bashkëkredimarrës), dhe "Furnizuesit të Tregut të Lirë" sh.a. (FTL sh.a.) (bashkëkredimarrës); "Banka e Tiranës" sh.a. ka rënë dakord të vendosë në dispozicion të kredimarrësit shumën totale të principalit prej 20 000 000 (njëzet milionë) euro në formën e kredisë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në "Kontratën e kredisë";

duke qenë se, sipas kushteve të përcaktuara në "Kontratën e kredisë", për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të kredimarrësit, rrjedhur nga "Kontrata e kredisë", kërkohet lëshimi i një garancie shtetërore nga ana e Këshillit të Ministrave;

duke qenë se, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. xxx, datë xxx, "Për miratimin e garancisë

shtetërore, në favor të 'Bankës së Tiranës' sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet 'Bankës së Tiranës' sh.a. dhe 'Furnizuesit të Shërbimit Universal' sh.a., dhe 'Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group' sh.a. dhe 'Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes' sh.a., dhe 'Furnizuesit të Tregut të Lirë' sh.a." ka vendosur miratimin e lëshimit të kësaj garancie shtetërore;

tashmë, si rrjedhojë, Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e përfaqësueses së Këshillit të Ministrave (këtu e më poshtë referuar si "Garantuesi"), lidh këtë marrëveshje garancie me kredidhënësin, me kushtet e mëposhtme:

Garantuesi njeh dhe bie dakord që me "Kontratën e kredisë" do të kuptohet kontrata për kredi afatgjatë nr. xxx rep., nr. xxx kol., datë xxx, si edhe çdo shtojcë e saj dhe/ose amendament i saj, që mund të nënshkruhet për zgjatjen e afatit të kontratës bazë, të lidhur midis kredidhënësit dhe kredimarrësit.

Garantuesi merr përsipër në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar, të garantojë detyrimin e kredimarrësit për shlyerjen e principalit dhe interesave sipas skedulit fillestar të shlyerjes apo çdo skeduli të ndryshuar të shlyerjes së dakordësuar ndërmjet palëve të principalit dhe interesave, të përcaktuar në kontratën për kredi afatgjatë nr. xxx rep., nr. xxx kol., datë xxx, deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve financiare që kredimarrësi i detyrohet kredidhënësit sipas afateve të kësaj kontrate kredie dhe çdo zgjatje të afatit që nuk sjell rritje të detyrimit të principalit të kredisë akorduar kredimarrësit, që mund t'i bëhet kësaj kontrate.

Në rast se kredimarrësi nuk shlyen detyrimet e përcaktuara sipas kushteve të kontratës së kredisë, garantuesi merr përsipër të paguajë menjëherë, brenda afatit maksimal prej 10 (dhjetë) ditësh pune, bazuar në kërkesën e parë me shkrim të kredidhënësit, detyrimet e pashlyera të kredimarrësit, që përfshijnë principalin, plus interesat e maturuara, konform skedulit të shlyerjes sipas kontratës së kredisë, dhe amendamentet përkatëse, duke përjashtuar këtu interesvonesa apo penalitete mbi mosshlyerjen në kohë të detyrimeve nga kredimarrësi apo kosto administrative për dhënien e kredisë, kosto të cilat duhet të paguhen nga kredimarrësi.

Kërkesa për pagesë që kredidhënësi do t'i drejtojë garantuesit duhet të përmbajë vlerën e pagesës së kërkueshme të përllogaritur, si edhe një përshkrim të detajuar të detyrimeve, duke përcaktuar në mënyrë analitike principalin, interesat e akumuluara dhe çdo detyrim tjetër në zbatim të kontratës së kredisë. Kërkesa për pagesë duhet të përmbajë, gjithashtu, detajet e llogarisë bankare në të cilin do të kryhet pagesa nga garantuesi. Nëse garantuesi e vlerëson të arsyeshme, përpara kryerjes së pagesës mund të kërkojë informacion shtesë ose qartësime nga kredidhënësi, përmbushja e të cilave nuk cenon vlefshmërinë e kësaj garancie shtetërore.

Pas pagesës së detyrimit nga garantuesi, garantuesi merr në dorëzim automatikisht të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore që zotëronte kredidhënësi ndaj kredimarrësit, sipas përcaktimeve të kontratës së kredisë dhe në masën e çdo pagese të kryer nga garantuesi, në kuadër të kësaj marrëveshjeje garancie.

Kredidhënësi duhet t'i dërgojë garantuesit, në mënyrë periodike, në përfundim të çdo muaji, informacion mbi stokun/gjendjen e detyrimit të kredimarrësit, duke evidentuar në mënyrë të veçuar principalin dhe interesat.

Garantuesi është njohur me termat dhe kushtet e kontratës së kredisë dhe për çdo ndryshim, rinovim, zgjatje, përtëritje apo ristrukturim të kontratës së kredisë, përfshirë edhe dhënien e ndonjë lehtësimi nga ana e kredidhënësit/ përfituesit kundrejt kredimarrësit, që mund të bëhet me marrëveshje ndërmjet kredidhënësit/ përfituesit dhe kredimarrësit, përveç rritjes së shumës së principalit të kredisë apo ndryshimin e termave financiarë të interesit kontraktor të kredisë, të cilat do të sillnin një rritje të detyrimeve të mundshme të garantuesit sipas kësaj marrëveshjeje garancie, nuk do të kërkojë miratimin e garantuesit.

Komunikimet në lidhje me këtë marrëveshje garancie, duhet të bëhen në formë të shkruar dhe të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për Ministrinë e Financave:	
Adresa:	Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë
Në vëmendje të:	Ministrit të Financave

Komunikimet, në lidhje me pagesat sipas kësaj marrëveshjeje, përveçse do të adresohen me shkresë zyrtare në adresën e sipërpërmendur, mund të dërgohen edhe në adresën e *email*-it: debt.department@financa.gov.al.

Për "Banka e Tiranës" sh.a.	
Adresa:	Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë
Në vëmendje të:	Divizionit të Korporatave
info@tiranabank.al	znj. Glenda KURTI
	Tel: 069 60 92 289

Kjo marrëveshje garancie do të hyjë në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj dhe do të jetë e vlefshme deri në shlyerjen e plotë të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e kredisë dhe amendamentet/ndryshimet/shtojcat përkatëse.

Kjo marrëveshje garancie do të rregullohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë marrëveshje, apo shkelja, zgjidhja ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim nga palët. Nëse palët nuk arrijnë t'i zgjidhin ato me mirëkuptim, ato do të zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar.

Palët nënshkruajnë këtë marrëveshje garancie në 2 (dy) kopje origjinale, të barasvlershme, në gjuhën shqipe (një kopje për garantuesin dhe një kopje për kredidhënësin), në Tiranë, Shqipëri, në datën e përcaktuar në krye të kësaj marrëveshjeje, që konsiston në datën më të fundit të nënshkruar nga secila prej palëve.

KËSHILLI I MINISTRAVE	BANKA E TIRANËS SHA
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE	DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
MINISTRI **Petrit Malaj**	**Dritan Mustafa**
REPUBLIKA E SHQIPËRISË DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË DEGA VENDORE _____	NR. _____ REP. NR. _____ KOL.

KONTRATË PËR KREDI AFATGJATË
Nr. 1465/01.11.2024

Ne _____, sot me ___.___ 2025 (dy mijë e njëzetë e pesë), në Zyrën e Noterisë _____ para meje Noteres _____, me seli në _____, u paraqitën palët që kërkuan redaktimin e kësaj kontrate kredie bankare, me afat si më poshtë:

Kredidhënësi:

Shoqëria bankare **"Banka e Tiranës" sh.a.,** regjistruar si person juridik shqiptar me vendimin nr. 12718, datë 3.11.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që vepron si **Bankë** me licencën nr. 7, datë 12.9.1996, të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, NUIS: J61924008V, me seli në adresën: rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë, përfaqësuar nga **drejtore e Divizionit të Korporatave, znj. Glenda Kurti**, e bija e Agronit, lindur më 6.3.1978, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, në adresën: rr. "Kongresi i Manastirit", pall. ½, shkalla 3, identifikuar me pasaportë nr. H85306150N dhe nga **drejtore e Departamentit të Administrimit të Kredive, Aida Cengu**, e bija e Azemit, lindur më 16.2.1970, në Kukës dhe banuese në Tiranë, me letërnjoftim nr. **035236532**, të dyja madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar (dhe në vazhdim do të quhet "**Kredidhënësi**" ose **"Banka"**), nga njëra anë; dhe

Kredimarrësi:

Shoqëria **"Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a.,** me seli në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", ndërtesa nr. 88, h. 1, kati II, Njësia Administrative nr. 7, 1023, Tiranë, e krijuar dhe që vepron në bazë të ligjeve shqiptare, regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me NUIS nr. L81530016L, përfaqësuar këtu e më poshtë (në bazë të vendimit të Këshillit të Administrimit të FSHU-së nr. 27, datë 12.12.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 2, datë 31.1.2025 dhe vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 30, datë 16.12.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 2, datë 5.2.2025) nga administratori i shoqërisë, **z. Algert Luzi,** i biri i Xhevdetit, lindur më 7.5.1987, në Burrel dhe banues në adresën: rr. "Don Bosko", pll. Aurora Konstruksion, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034197499 dhe me numër personal: I70507065J, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar (dhe në vazhdim do të quhet **"Kredimarrësi"**);

Bashkëkredimarrës:

a) Shoqëria **"Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" sh.a.,** me seli në Njësinë Administrative nr. 7, Bulevardi "Gjergj Fishta", ndërtesa nr. 88, hyrja 1, 1023, Tiranë, e krijuar dhe që vepron në bazë të ligjeve shqiptare, regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me NUIS nr. K72410014H, përfaqësuar këtu e më

poshtë (në bazë të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 46, datë 19.11.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 2, datë 14.2.2025 dhe vendimit të Asamblesë Përgjithshme të Aksionarit nr. 9460/4, datë 6.12.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 2047/2, datë 21.3.2025) nga administratori i shoqërisë, **z. Enea Karakaçi**, i biri i Ridvanit, lindur më 17.3.1987, në Shkodër dhe banues në adresën: rr. "Zenel Baboçi", P. Ferrari, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037281367 dhe me numër personal: I70317091T, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar (dhe në vazhdim do të quhet "**Bashkë-kredimarrës"**);

b) Shoqëria **"Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (OSSH sh.a.),** me seli në Bulevardin "Gjergj Fishta", ndërtesa nr. 88, h. 1, kati V, Njësia Administrative nr. 7, 1023, Tiranë, e krijuar dhe që vepron në bazë të ligjeve shqiptare, regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me NUIS nr. L81530018E, përfaqësuar këtu e më poshtë (në bazë të vendimit të Këshillit Administrimit nr. 21, datë 27.11.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 2, datë 31.1.2025 dhe vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 24, datë 3.12.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 2, datë 5.2.2025) nga administratori i shoqërisë, **z. Blendian Dalipi,** i biri i Bajramit, lindur më 27.7.1975, në Poliçan, Alb. dhe banues në adresën: rr. "Frederik Shiroka", kati 3, ap. 29, Njësia Admin. 7, kutia postare 1001, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034411855 dhe me numër personal: H50727048H, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar (dhe në vazhdim do të quhet "**Bashkëkredimarrës"**);

c) Shoqëria **"Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. (FTL sh.a.),** me seli në Bulevardin "Gjergj Fishta", ndërtesa nr. 88, h. 1, kati IV, Njësia Administrative nr. 7, 1023, Tiranë, e krijuar dhe që vepron në bazë të ligjeve shqiptare, regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me NUIS nr. L81530029T, përfaqësuar këtu e më poshtë (në bazë të vendimit të Këshillit Administrimit nr. 26, datë 10.12.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 2, datë 28.1.2025 dhe vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 28, datë 12.12.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 2, datë 30.1.2025) nga administratori i shoqërisë, **z. Albi Gjenerali,** i biri i Minellës, lindur më 1.11.1984, në Tiranë dhe banues në rr. "Gjin Bue Shpata", pll. Aviacionit nr. 7/36, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034983779 dhe me numër personal: I41101047O, madhor e më zotësi të plotë juridike për të vepruar (dhe në vazhdim do të quhet "**Bashkë-kredimarrës"**),

Palët bien dakord për të lidhur këtë "Kontratë për kredi afatgjatë" (dhe në vazhdim do të quhet "Kontrata"), sa më poshtë vijon:

A. KUSHTET E KREDISË

1.1 Banka, me anën e kësaj kontrate i jep kredimarrësit një kredi me afat në shumën prej EUR 20,000,000 (njëzet milionë euro), në vazhdim do të quhet "Kredia".

1.2 Kjo kontratë ka për objekt dhënien e kredisë afatgjatë në favor të kredimarrësit, kredi e cila garantohet me garanci shtetërore, si pjesë e Projektit të Qëndrueshmërisë së OSHEE-së, kredi e cila do të përdoret nga kredimarrësi për shlyerjen e plotë të kredisë (overdraft) që kredimarrësi ka pranë "OTP Bank" sh.a., sipas kontratës për dhënie kredie bankare në një llogari rrjedhëse (overdraft) nr. rep. 3969/nr. kol. 1162, datë 18.11.2021 dhe ndryshimeve përkatëse, sipas marrëveshjes për blerje kredie ndërmjet bankave të nivelit të dytë.

1.3 Kredia do të disbursohet në një shumë të vetme në llogari të kredimarrësit pranë "Bankës së Tiranës" dhe në vijim do të transferohet te llogaria e kredimarrësit pranë "OTP Bank" sh.a., me IBAN: AL469021179745512302171906 79, në të cilën është mbajtur kredia overdraft, brenda pesë ditëve të punës pas nënshkrimit të kësaj kontrate, vetëm pas plotësimit nga kredimarrësi të kushteve të mëposhtme:

1.3.1 Nënshkrimi i marrëveshjes së garancisë shtetërore të huas midis Këshillit të Ministrave, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës së Tiranës, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për miratimin e garancisë në favor të "Bankës së Tiranës" sh.a., për të garantuar kredinë objekt i kësaj kontrate.

1.4 Kredimarrësi do të paguajë një komision administrimi **1%** (një përqind) të shumës së kredisë në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

2. Kredia do të ketë një kohëzgjatje prej **12 (dymbëdhjetë)** vjetësh (dhe në vazhdim do të quhet "**Kohëzgjatja e kredisë"**), që fillon nga data e disbursimit të kredisë (dhe në vazhdim do të quhet "**Data e dibursimit**") deri në përvjetorin e dymbëdhjetë të kredisë (që do të quhet "Data e maturimit") dhe në rast se data e parë e disbursimit ose data e maturimit do të bjerë në një ditë jopune

bankare, atëherë do të shtyhet ditën pasardhëse të punës bankare).

Në kohëzgjatje përfshihet periudha e mospagimit në shlyerjen e principalit **prej 36 (tridhjetë e gjashtë)** muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Gjatë periudhës së mospagimit të principalit do të paguhen vetëm interesat e akumuluara të kredisë.

3.1 Shuma e kredisë do t'i shlyhet Bankës nga kredimarrësi me 18 këste të barabarta principali me bazë gjashtëmujore, përkatësisht në datat 30 prill dhe 30 tetor të çdo viti (dhe në vazhdim do të quhet "Datë pagese e kredisë").

Kësti i parë do të jetë i pagueshëm në datën e pagesës **pas përfundimit të periudhës së mospagimit të principalit**, e kështu me radhë çdo datë pagese të kredisë deri në datën e maturimit të kredisë.

Plani i shlyerjes së kredisë i dorëzohet kredimarrësit në datën ose datat e disbursimit të kredisë dhe ndryshon në përputhje me shumën e disbursuar dhe të pashlyer të kredisë, si dhe ndryshimin e normës së interesit siç parashikohet në pikën 4 më poshtë.

Banka do t'i japë kredimarrësit, me shkrim ose me mjete elektronike të komunikimit (*email*, faks etj.), në përputhje me parashikimet e legjislacionit bankar, Planin e Shlyerjes së Kredisë çdo 6 muaj.

3.2 Në qoftë se data e pagimit të kështit të principalit do të bjerë në një ditë e cila nuk është ditë pune bankare, atëherë kjo periudhë do të mbyllet në ditën pasardhëse të punës.

3.3 Në rast shlyerjeje të plotë ose pjesore të ndonjë shume të kredisë para afatit, banka do të aplikojë komision parapagimi në masën prej **0.125%** (zero pikë njëqind e njëzet e pesë përqind) mbi shumën e kredisë e cila do të shlyhet para afatit.

3.4 Të gjitha detyrimet në vlerë monetare të kredimarrësit ndaj Bankës, në përmbushje të kësaj kontrate, qofshin principal, interesa ose ndonjë shumë tjetër, do të shlyhen plotësisht pa të drejtë kompensimi ose shuarjeje të detyrimeve. Pagesat e bëra nga kredimarrësi për shlyerjen e kredisë janë të lira nga çdo detyrim dhe nuk i nënshtrohen asnjë zbritjeje për llogari të taksave, tatimeve, detyrimeve doganore ose çfarëdo detyrimi tjetër.

Në rast se ndonjë ligj, rregullore ose akt tjetër ligjor do të parashikojë se shumat që kredimarrësi do t'i paguajë Bankës duhet t'i nënshtrohen ndonjë zbritjeje ose mbajtjeje në burim, kredimarrësi do të kompensojë shumën e zbritur, në mënyrë që totali i detyrimit që do t'i shlyhet bankës të jetë i barabartë me totalin e shumës që rezulton para ndonjë zbritjeje apo mbajtjeje në burim.

3.5 Çdo pagesë e bërë prej kredimarrësit ndaj bankës në ekzekutim të kësaj kontrate do të përdoret për shlyerjen e detyrimeve në rendin, si më poshtë vijon:

- së pari për shlyerjen e komisioneve dhe shpenzimeve;
- së dyti për shlyerjen e interesave të maturuar e të papaguar sipas radhës: interes vonesë dhe interes kontraktor;
- së treti për shlyerjen e shumës së maturuar e të papaguar të principalit të kredisë.

4.1.1 Kredimarrësi do të paguajë interes kontraktor çdo 6 muaj mbi shumën e disbursuar dhe të pashlyer të kredisë dhe përkatësisht në datat 30 prill dhe 30 tetor të çdo viti, sipas planit të shlyerjes dorëzuar kredimarrësit. Norma e interesit kontraktor është e ndryshueshme dhe do të llogaritet interes bazë (indeks orientues) EURIBOR 6-mujor shtuar me marzhin 1% (një përqind) në vit, por jo më pak se 1% (një përqind) në vit, ku norma bazë e interesit (indeksi orientues) është objekt rishikimi dhe ndryshimi nga banka çdo 6-mujor. Interesi i ri kontraktor do të aplikohet mbi pjesën e pashlyer të kredisë në datën e ndryshimit.

Interesi do të llogaritet mbi bazën e një viti me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë kalendarike dhe mbi bazën e numrit respektiv të ditëve të kaluara. Vlera e interesit për datën e pagesës do të llogaritet për numrin respektiv të ditëve nga data e disbursimit ose data e pagesës së interesit të mëparshëm, mbi bazën e një viti me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë.

4.1.2 Pavarësisht nga kushtet e tjera të kësaj kontrate, në rast ndërprerjeje të kuotimit të indeksit orientues (të dakordësuar për llogaritjen e normës së interesit kontraktor të ndryshueshëm të kësaj kredie) nga autoritetet rregullatore apo autoritetet e autorizuara për administrimin e këtij indeksi, banka ka të drejtë që në datën e ndërprerjes së kuotimit të ndryshojë/zëvendësojë këtë indeks me një indeks orientues alternativ të publikuar nga këto autoritete, pa qenë i nevojshëm pëlqimi paraprak me shkrim i kredimarrësit. Kjo e drejtë do të ushtrohet nga banka me kusht që autoritetet rregullatore apo autoritetet e autorizuara për administrimin e indeksit të kenë përcaktuar qartë datën e ndërprerjes së

kuotimit të indeksit orientues dhe zëvendësimin e tij nga një indeks orientues alternativ.

Banka e Shqipërisë publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, në çdo rast, burimin e informacionit (faqen zyrtare të internetit) të autoritetit rregullator apo të autoritetit të autorizuar për administrimin e indeksit, që publikon indeksin orientues alternativ përkatës. Interesi i ri kontraktor do të aplikohet mbi pjesën e pashlyer të kredisë në datën e ndryshimit.

4.2 Norma Efektive e Interesit (NEI) është **_____% (_____** pikë përqind) në vit, kjo e llogaritur duke u bazuar në normën e interesit kontraktor në ditën e lidhjes së kësaj kontrate, shumën, monedhën dhe shpenzime e komisione të tjera të detyrueshme të kredisë, si dhe afatin e rënë dakord nga palët në këtë kontratë.

Ndryshimi i ndonjë prej elementeve bazë në llogaritjen e Normës Efektive të Interesit (NEI) do t'i njoftohet Kredimarrësit përpara aplikimit nëpërmjet njoftimit me shkrim të publikuar në të dhënat e kontaktit të Kredimarrësit, të përcaktuara në seksionin "C" të kësaj kontrate.

4.3 Në rast se Kredimarrësi nuk paguan në afat ndonjë shumë të përcaktuar në këtë kontratë, ai do të paguajë interes vonesë (kusht penal) mbi shumën e principalit të vonuar nga data kur duhej të kryhej pagesa deri në datën e kryerjes së pagesës në masën **dy përqind (2%)** në vit mbi normën e interesit kontraktor. Ky interes, në rast se nuk paguhet, do të konsiderohet shumë e pashlyer.

Shembull mbi përllogaritjen e penalitetit duke supozuar që:

Shuma në vonesë 10,000 LEK

Ditë në vonesë 100

Norma e interesit të kredisë e supozuar 4.5%

Interesi në vonesë IR + 2%= 6.5%

$$\frac{\text{(shuma në vonesë) x (interesi në vonesë) x nr. i ditëve në vonesë}}{360}$$

$$\text{Penaliteti} = \frac{(10{,}000) \times 6.5\% \times 100}{360} = 178 \text{ LEK}$$

5. Kredimarrësi deklaron dhe garanton Bankën, e cila duke marrë të mirëqenë vërtetësinë e këtyre deklarimeve, ka marrë vendimin për dhënien e kredisë dhe për ekzekutimin e çdo disbursimi, sa më poshtë vijon:

1. Të gjitha të dhënat e deklaruara për identifikimin e tij dhe marrjen e kredisë janë korrekte dhe të sakta.

2. Është regjistruar si shoqëri tregtare, ekziston dhe kryen aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar.

3. Ka të drejtë të marrë kredi sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontrate, si dhe ka ndërmarrë çdo hap ose veprim të nevojshëm të kërkuar për nënshkrimin e kësaj kontrate dhe marrjen përsipër të detyrimeve që lindin prej saj.

4. Kjo kontratë dhe dokumentet e tjera të kredisë janë ligjërisht të detyrueshme për të.

5. Nënshkrimi i dokumenteve të kredisë ose përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet e kredisë ose ushtrimi i të drejtave sipas kushteve të dokumenteve të kredisë prej tij, nuk është në kundërshtim me ndonjë ligj, rregullore, status, vendim gjyqësor, akt, autorizim, marrëveshje ose detyrim tjetër të zbatueshëm ndaj Kredimarrësit.

6. Pranon se Banka do të disbursojë kredinë vetëm pasi Kredimarrësi të paraqesë të gjitha dokumentet e kërkuara prej saj dhe veçanërisht ato që kanë të bëjnë me kompletimin/regjistrimin e sigurive të dhëna për shlyerjen e detyrimit, në përputhje me kushtet e kontratave/marrëveshjeve përkatëse, si dhe të mos jetë në vonesë në shlyerjen e asnjë prej detyrimeve të tij ndaj bankës, përfshirë këtu të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore të ndryshme nga kjo kontratë.

7. Ka deklaruar në Bankë të gjitha detyrimet materiale, ekzistuese dhe të mundshme të tij.

8. Mbi pasuritë apo të ardhurat e tij nuk rendon asnjë barrë që mund të ketë ndonjë pasojë negative mbi marrjen e kredisë, përdorimin dhe/ose shlyerjen e saj.

9. Në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate dhe në datat e disbursimit të kredisë, nuk ka asnjë çështje gjyqësore në gjykim ose të pezulluar, ose ndonjë mosmarrëveshje potenciale pasurore kundër tij që mund të sjellë ndonjë pasojë negative ndaj biznesit, gjendjes financiare dhe ndaj marrjes së kredisë, përdorimit dhe/ose shlyerjes së saj.

10. Në momentin e hyrjes në fuqi të nënshkrimit të kësaj kontrate dhe në datat e disbursimit të kredisë, pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe standardet e kontabilitetit. Këto pasqyra financiare pasqyrojnë në mënyrë të plotë dhe të vërtetë gjendjen financiare aktuale, si dhe nuk ka pasur ndryshime që ndikojnë negativisht në aktivitetin ose gjendjen financiare të Kredimarrësit në fund të çdo viti financiar.

11. Shuma e kredisë do të përdoret vetëm sipas qëllimit të përcaktuar në këtë kontratë.

12. Nuk ka ndodhur dhe nuk është prezente asnjë nga ngjarjet e parashikuara si Rast Mospërmbushjeje.

13. Detyrimet e tij në këtë kontratë renditen dhe do të renditen për sa i takon radhës së pagesës ose të preferimit së paku të të njëjtës radhë *(pari passu)* me të gjithë kreditorët e pasiguruar ose të preferuar të të njëjtës radhë.

14. Pranon se ekstrakti që Banka nxjerr nga librat ose sistemi informatik i saj ku regjistrohen të gjitha veprimet lidhur me kredinë do të përbëjë në çdo rast provë të plotë të shumës që Kredimarrësi i detyrohet Bankës. Kredimarrësi pranon si të mirëqenë dhe të vlefshëm çdo detyrim që rezulton në çdo kohë në ngarkim të tij në librat e Bankës, duke hequr dorë shprehimisht nga e drejta e tij për të kundërshtuar detyrimin në fjalë për çfarëdo lloj arsye, me përjashtim të gabimeve matematikore.

15. Kredimarrësi është në dijeni të faktit, kupton dhe pranon plotësisht se kjo kontratë kredie bankare përbën titull ekzekutiv në bazë të nenit 510, germa "d", të Kodit të Procedurës Civile, dhe është menjëherë e ekzekutueshme kundrejt tij në rastet e zgjidhjes së kontratës parashikuar në pikat 7 dhe 9 që vijojnë të kësaj kontrate në përgjithësi, dhe në veçanti për mospërmbushje detyrimi të pagimit të principalit të kredisë dhe interesit përkatës. Mosrespektimi i pagimit të çdonjërës prej shumave të detyrueshme, në vlerën ose afatin e përcaktuar te Banka, përbën mospërmbushje thelbësore të kontratës dhe i jep të drejtë Bankës për të kërkuar vënien në ekzekutim të detyrueshëm të pasurive të Kredimarrësit, me qëllim shlyerjen e detyrimit kontraktor.

16. Banka ka të drejtë që të cedojë tek të tretë, pa pëlqimin apo njoftimin paraprak të Kredimarrësit, tërësisht ose pjesërisht, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë kredie dhe nga çdo ndryshim i saj, nëse do të ketë.

17. Pranon se njeh dhe merr përsipër rrezikun që paraqet për të:

i. lëvizja e pafavorshme e kursit të këmbimit të monedhës së huaj në të cilën akordohet kredia kundrejt monedhës vendase LEK, veçanërisht në rastin kur të ardhurat e tij janë në LEK;

Shembull ilustrues:

Kredi me afat në monedhën EUR	**Vlera e kështit**
Kësti mujor	210.00 EUR
Kësti i supozuar në LEK kur 1 EUR këmbehet me 133.5 LEK	28,035 LEK
Kësti i supozuar në LEK kur 1 EUR këmbehet me 134.5 LEK	28,245 LEK

ii. rritja e normës së interesit të kredisë gjatë kohëvazhdimit të saj, si rezultat i rritjes së indeksit orientues.

Shembull ilustrues: Kredi në shumën 5,000,000 LEK, me afat 25 vjet

Norma e interesit: Bono thesari 3M + marzh	**Vlera e kështit mujor (principal +interes)**
Interesi i kredisë Bono thesari 3M (1.091%) + marzh (4.5%) = 5.591%	720,664 LEK
Interesi i kredisë me rritje të supozuar të indeksit me 0.5% Bono thesari 3M (1.591%) + marzh (4.5%) = 6.091%	732.611 LEK

18. Lidhur me të dhënat personale të Kredimarrësit të mbledhura nga Banka, me qëllim lidhjen dhe përmbushjen e kësaj kontrate kredie bankare, Kredimarrësi deklaron shprehimisht:

1. se u njoftua për përpunimin në mënyrë manuale dhe të automatizuar të të dhënave të tij me karakter personal dhe financiar, që bëhet nga Banka;

2. se njeh që të dhënat e tij personale dhe financiare të mbledhura nga Banka lidhen me qëllimin dhe përmbushjen e kësaj kontrate, janë të nevojshme dhe nuk tejkalojnë sa kërkohet në çdo rast në pikëpamje të përmbushjes së qëllimit të kësaj kontrate;

3. se, në përputhje me ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, i jep Bankës pëlqimin e plotë të tij për përpunimin e të dhënave të tij, si dhe transmetimin e tyre në Regjistrin e Kredive të mbajtur pranë Bankës së Shqipërisë në përmbushje të detyrimit për raportim që përcakton kuadri rregullator në fuqi, si dhe tek të tretët, të cilëve Banka mund t'u cedojë, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, të drejtën e kredisë që rrjedh nga kjo kontratë kredie bankare;

4. se u njoftua se dhënia e të dhënave të tij personale është e detyrueshme për përmbushjen nga Banka të kërkesave rregullative përcaktuar nga rregulloret e Bankës së Shqipërisë "Mbi

transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", si dhe "Për funksionimin e Regjistrit të Kredive në Bankën e Shqipërisë", si dhe kushtet dhe procedurat për njohjen, përdorimin dhe rishikimin e të dhënave që administrohen në të, dhe se ushtrimi nga Kredimarrësi i të drejtës për të revokuar pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale i jep Bankës të drejtën për të zgjidhur këtë kontratë në përputhje me përcaktimet e pikës 9 të kësaj Kontrate në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim të këtij revokimi.

Gjithashtu, Kredimarrësi deklaron se iu komunikua dhe mori dijeni nga Banka për sa vijon:

a) se ai ka të drejtë të informohet qartë dhe në mënyrë të përshtatshme për identitetin e përfaqësuesit të caktuar për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale të përpunuara; dhe

b) se ai ka të drejtën për akses në të dhënat e tij personale të mbledhura nga Banka dhe të drejtën për kërkimin e korrigjimit të tyre.

6. Kredimarrësi merr përsipër që gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate dhe deri në shlyerjen e plotë të kredisë:

1. Të njoftojë menjëherë Bankën për sa më poshtë:

a) Ndryshimin e adresës dhe të të gjitha të dhënave të tjera që ka deklaruar për identifikimin e tij dhe mbajtjen e korrespondencës me Bankën;

b) Ndryshimin e cilitdo prej deklarimeve dhe garancive të dhëna nga Kredimarrësi në pikën 5 të kësaj kontrate;

c) Konstatimin e njërit prej Rasteve të Mospërmbushjes;

d) Parashikimin e verifikimit të ndonjë Rasti Mospërmbushjeje ose çdo ngjarjeje të mundshme që mund të cenojë interesat e Bankës në bazë të kësaj kontrate.

2. Të mos ndryshojë formën e saj ligjore pa njoftimin paraprak me shkrim të Bankës.

3. Të zotërojë lejet e nevojshme që në bazë të legjislacionit në fuqi janë ose do të jenë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë, si dhe të kryejë rinovimin e tyre.

4. T'i dorëzojë Bankës, me kërkesë të kësaj të fundit, çdo marrëveshje ose kredi tjetër të lidhur me palë të treta, garanci ose ndonjë marrëveshje tjetër financiare të lidhur pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, të cilat mund të sjellin pasoja negative mbi përmbushjen e detyrimeve të kësaj kontrate.

Gjithashtu, merr përsipër që pa pëlqimin paraprak të Bankës, të mos marrë detyrime të tjera (kredi) të cilat në radhën e pagesave preferohen ndaj kësaj kredie.

5. T'i paraqesë Bankës të gjitha njoftimet dhe dokumentet zyrtare (pasqyra financiare etj.) që mund të kërkohen prej saj në lidhje me gjendjen financiare të Kredimarrësit.

6. Kur garancia shtetërore e huas e dhënë për marrjen e kredisë sipas gjykimit të Bankës bëhet e pamjaftueshme, të japë një garanci suplementare ose të bëjë zëvendësimin e saj. Kjo garanci duhet të jetë e kënaqshme për Bankën në formë, qëllim dhe përmbajtje.

7. Të çelë dhe të mbajë llogari rrjedhëse pranë Bankës nëpërmjet të cilës të qarkullojë të ardhura të shoqërisë.

7. Çdonjëra prej ngjarjeve të mëposhtme përbën Rast Mospërmbushjeje:

1. Kredimarrësi nuk shlyen vleftën e plotë të interesit dhe/ose të principali, sipas Planit të Shlyerjes dhënë nga Banka, me kalimin e 60 ditëve kalendarike nga data kur pagesa e këstit duhet të kryhej.

2. Banka konstaton se nuk është realizuar qëllimi i dhënies së kredisë nga Kredimarrësi, pra ky i fundit nuk e shfrytëzon kredinë e marrë sipas objektit të parashikuar në pikën 1 të kësaj kontrate.

3. Kredimarrësi pranon me shkrim pamundësinë për të paguar ose nuk shlyen në afat detyrimet (borxhet) e maturuara në përgjithësi, falimenton ose bie në paaftësi paguese, ose ndaj tij ngrihet një padi falimentimi sipas procedurave të ligjit "Për falimentimin".

4. Pozita financiare e Kredimarrësit ose aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet e kësaj kontrate për shkak të mbylljes ose tjetërsimit të plotë ose pjesor të aktivitetit apo aseteve të tyre, ose të ekzekutimit të ndonjë vendim arbitrazhi apo gjykate mbi asetet e Kredimarrësit ka ndryshuar duke ndikuar negativisht në aftësinë e tij paguese.

5. Kredimarrësi nuk përmbush ose shkel cilindo prej detyrimeve që ka marrë përsipër në bazë të kësaj kontrate (përveç detyrimit për të paguar).

6. Çdo deklarim i Kredimarrësit në ose lidhur me këtë kontratë, mund të rezultojë në ndonjë moment të ketë qenë jo i vërtetë ose jo i rregullt në përmbajtje në momentin e deklarimit.

7. Kredimarrësi ose ndonjë prej ortakëve/aksionarëve të palës Kredimarrëse është: i. përfshirë në ndonjë çështje civile me cilësinë e të paditurit; apo ii. shpallur si person nën hetim apo i akuzuar lidhur me hetimin ose gjykimin e ndonjë çështjeje penale, ngjarje këto që mund të kenë pasoja negative materiale në përmbushjen e detyrimeve të kësaj kontrate.

8. Nëse cilido prej Kredimarrësit dhe/ose Bashkëkredimarrësve dhe/ose përfaqësuesi i tyre revokon pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale dhënë Bankës nëpërmjet kësaj kontrate ose në kontratat përkatëse të lidhura, ose që do të lidhen me qëllim sigurimin e shlyerjes së detyrimeve të kredisë dhënë me këtë Kontratë, duke e penguar Bankën të përmbushë kërkesat e kuadrit rregullativ.

Në rast se verifikohet ndonjë prej ngjarjeve që përbën Rast Mospërmbushjeje dhe Kredimarrësi dhe/ose cilido nga Bashkëkredimarrësit nuk përmbush detyrimin e shkelur kontraktor, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e marrjes së njoftimit përkatës me shkrim nga Banka, Banka ka të drejtë të ndërpresë përdorimin e kredisë dhe ta deklarojë të zgjidhur këtë kontratë duke kërkuar kthimin e menjëhershëm të pjesës së pashlyer të kredisë, së bashku me interesat e akumuluara dhe të gjitha shumat e tjera të papaguara, pa qenë e nevojshme zgjidhja e kontratës me proces gjyqësor ose ndjekja e ndonjë procedure tjetër ligjore, si dhe të ndërmarrë çdo veprim ligjor dhe akt të nevojshëm për të realizuar të drejtën e saj, në radhën e mëposhtme:

1. Banka do t'i kërkojë me shkrim Ministrisë së Financave pagesën e detyrimeve të pashlyera të Kredimarrësit dhe Bashkëkredimarrësve, në përputhje me kushtet dhe afatet e Marrëveshjes së Garancisë, të lidhur midis Këshillit të Ministrave të RSH-së, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe "Banka e Tiranës" sh.a., për dhënien e garancisë shtetërore të huas; dhe

2. Banka, pas kalimit të afatit të parashikuar në Marrëveshjen e Garancisë për kryerjen nga Ministria e Financave të pagesës së detyrimeve të papaguara të Kredimarrësit, ka të drejtë të kërkojë lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, si dhe të fillojë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të këtij akti që përbën titull ekzekutiv në bazë të nenit 510, germa "d", të Kodit të Procedurës Civile, për shlyerjen nga Kredimarrësi dhe Bashkëkredimarrësit të shumës së detyrimit të kredisë që do të rezultojë i pashlyer pas zbritjes së shumës të arkëtuar nga garancia qeveritare e huas, dhe në rast mospagese të detyrimeve brenda afatit të parashikuar në Marrëveshjen e Garancisë, për të gjithë shumën e papaguar të detyrimit të kredisë.

8. Në rast mospagimi nga Kredimarrësi në afatet e përcaktuara ose njoftuara çdoherë të ndonjë ose çdo detyrimi që rrjedh nga kjo kontratë, Banka, pa qenë e nevojshme kryerja e ndonjë veprimi ligjor, është e autorizuar dhe ka të drejtë të prekë me iniciativë dhe debitojë kundrejt detyrimit ekzistues shumat e depozituara në llogarinë ose llogaritë në monedha të ndryshme që pala Kredimarrëse ka ose mund të ketë pranë "Bankës së Tiranës" sh.a.

9. Banka ka të drejtë të tërhiqet (zgjidhë) në mënyrë të njëanshme nga kjo kontratë kredie bankare në rastet kur ajo vjen në dijeni të fakteve të reja ose të panjohura më parë në lidhje me Kredimarrësin, me mjetet e përdorura për të siguruar shlyerjen e detyrimit, ose çdo gjë tjetër që vë në rrezik, sipas gjykimit të saj të lirë, shlyerjen e kredisë nga ana e Kredimarrësit. Heqja dorë nga kontrata do të ndërpresë menjëherë përdorimin e kredisë dhe Kredimarrësi detyrohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim nga Banka të kthejë të gjitha shumat e përdorura dhe të pashlyera të kredisë, si dhe shumat plotësuese (interesa, shpenzime, etj.) të detyrueshme për t'u paguar në bazë të kontratës.

10. Shpenzimet që lidhen me negociatat, hartimin, nënshkrimin, ekzekutimin e detyruar, shlyerjen ose fshirjen e kredisë dhe/ose të garancive, përfshirë kompletimin e barrëve dhe regjistrimin e të drejtave reale, që sigurojnë detyrimet e Kredimarrësit ndaj Bankës do të përballohen nga Kredimarrësi. Në shpenzimet dhe kostot e mësipërme përfshihen edhe shpenzimet noteriale të kësaj kontrate dhe të kontratave të mjeteve që sigurojnë shlyerjen e detyrimit të kredisë, primet e sigurimit për çdo pasuri të hipotekuar, të lënë peng ose pasurive të bllokuara (sekuestruara) në favor të Bankës, si dhe çdo tarifë e arsyeshme dhe shpenzim i juristëve, avokatëve të Bankës, si dhe i ndonjë llogaritari,

kontrollori, vlerësuesi ose ndonjë eksperti tjetër për çdo konsultim ose shërbim që Banka do ta konsiderojë të nevojshëm për nënshkrimin dhe përmbushjen e kontratës në fjalë, dhe të çdo sigurie dytësore që garanton kredinë, dhe të mbrojtjes e vlerësimit të të drejtave të Bankës.

B. SIGURITË E DHËNA PËR SHLYERJEN E KREDISË

Pagesa e kësaj kredie do të sigurohet nga:

Marrëveshja e Garancisë Shtetërore të Huas, lidhur midis Bankës së Tiranës dhe Këshillit të Ministrave, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për miratimin e garancisë shtetërore në favor të "Bankës së Tiranës" sh.a., për kontratën e kredisë ndërmjet Bankës së Tiranës në cilësinë e "Kredidhënësit" dhe shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a. në cilësinë e Kredimarrësit, dhe shoqërisë "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" sh.a., "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. dhe "Furnizuesit të Tregut të Lirë" sh.a., në cilësinë e Bashkëkredimarrësve, që garanton detyrimin e kredimarrësit për shlyerjen e principalit dhe të interesave sipas skedulit fillestar të shlyerjes apo çdo skeduli të ndryshuar të shlyerjes, të dakordësuar ndërmjet palëve, të principalit dhe interesave, të përcaktuar **në Kontratën për Dhënie Kredie Bankare, duke përjashtuar këtu interesvonesa apo penalitete mbi mosshlyerjen në kohë të detyrimeve nga Kredimarrësi** apo kosto administrative për dhënien e kredisë, kosto të cilat duhet të paguhen nga Kredimarrësi.

Marrëveshja e Garancisë Shtetërore i bashkëngjitet si shtojca "A" kësaj kontrate.

C. TË NDRYSHME

1.1 Palët bien dakord se marrëdhëniet midis Kredimarrësit dhe Bashkëkredimarrësit, lidhur me përdorimin, njohjen dhe shlyerjen e detyrimit të kësaj kredie do të rregullohen, si vijon:

1.2 Kredimarrësi ka të drejtë që pa pëlqimin paraprak të Bashkëkredimarrësit, të kërkojë me shkrim nga Banka përdorimin e pjesshëm apo të plotë të shumës së Kredisë, sipas kushteve të rëna dakord në këtë Kontratë.

1.3 Kredimarrësi dhe Bashkëkredimarrësi bien dakord midis tyre të shlyejnë çdo shumë që mund të rezultojë në tejkalim të Kredisë menjëherë pas marrjes së njoftimit përkatës nga Banka.

1.4 Pavarësisht përdorimit të kredisë nga Kredimarrësi, sipas përcaktimeve në pikat 1.2–1.4 të kësaj Kontrate, detyrimi i Kredimarrësit dhe Bashkëkredimarrësve kundrejt Bankës për kthimin e çdo shume të Kredisë, si dhe të interesave kontraktore dhe çdo shpenzimi tjetër sipas kësaj Kontrate është detyrim solidar pasiv dhe Banka ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e çdonjërit prej detyrimeve në bazë të kësaj Kontrate, tërësisht apo pjesërisht, si nga Kredimarrësi dhe Bashkëkredimarrësit së bashku, ashtu edhe nga secili prej tyre veç e veç, dhe Kredimarrësi dhe Bashkëkredimarrësit mbeten të detyruar solidarisht derisa Banka të ketë realizuar të drejtën e saj.

Kur njëri prej Kredimarrësit ose Bashkëkredimarrësit e përmbush plotësisht detyrimin e tyre ndaj Bankës, edhe debitori tjetër solidar shkarkohet nga detyrimi ndaj Bankës.

Secili prej Kredimarrësit ose Bashkëkredimarrësve do të njoftojë menjëherë debitorin tjetër solidar në rast se ka përmbushur plotësisht detyrimin kundrejt Bankës.

1.5 Kredimarrësi dhe Bashkëkredimarrësit kanë të drejtën e regresit ndaj njeri-tjetrit, për shumën e detyrimit të paguar nga secili prej tyre për shlyerjen e detyrimeve të lindura nga përdorimi i Kredisë nga debitori tjetër solidar.

1.6 Në rast se nga ana e Kredimarrësit dhe Bashkëkredimarrësve nuk do të kthehet shuma e marrë kredi nga Banka dhe do të verifikohen kushtet e mospërmbushjes së detyrimit kontraktor, atëherë Kredimarrësi dhe Bashkëkredimarrësit do të konsiderohen se nuk kanë përmbushur detyrimin e mësipërm ndaj Bankës dhe kjo e fundit ka të drejtë të kërkojë realizimin e të drejtës së saj në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.

2. Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në nenet 1031 e në vijim, nenet 423–435, 585–600, të Kodit Civil, ligji nr. 110/2018, "Për noterinë", ligji nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë', ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për

mbrojtjen e të dhënave personale". Gjykata kompetente për shqyrtimin e çdo çështjeje, lidhur me ekzekutimin dhe interpretimin e kësaj kontrate është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Çdo modifikim i kësaj kontrate do të bëhet vetëm me shkrim dhe vetëm pas marrëveshjes midis palëve.

4. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim midis palëve, përveç rasteve kur ato bien ndryshe dakord midis tyre, do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet në adresat ose numrat respektiv si me poshtë:

KREDIMARRËSI:
"Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a.
A: Blv. "Gjergj Fishta", nd. 88, h. 1, kati II, Nj. Admin. nr. 7, 1023, Tiranë
email: Algert.Luzi@fshu.al

BASHKËKREDIMARRËSIT:
"Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" sh.a.
A: Blv. "Gjergj Fishta", nd. 88, h. 1, Nj. Admin. nr. 7, 1023, Tiranë
email: Redvin.Marku@oshee.al

"Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a.
A: Blv. "Gjergj Fishta", nd. 88, h. 1, kati V, Nj. Admin. nr. 7, 1023, Tiranë
email: Blendian.Dalipi@ossh.al

"Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a.
A: Blv. "Gjergj Fishta", nd. 88, h. 1, kati IV, Nj. Admin. nr. 7, 1023, Tiranë
email: Albi.Gjenarali@ftl.al

Data e marrjes së njoftimeve ose kërkesave me shkrim të përmendura më sipër do të konsiderohet:

1. dita e dorëzimit në adresën e sipërpërmendur të marrësit, nëse janë dërguar me korrier;
2. dita e pestë (5të) pasi është depozituar pranë shoqërisë së shërbimeve postare, nëse është dërguar me postë të regjistruar nëpërmjet një shoqërie shërbimesh postare; ose
3. nëse është dërguar me faks, mesazh telefonik (sms) ose *email*, data e konfirmimit të dërgimit nga aparati i faksit, i telefonit ose data e dërgimit të *email*-it.

Kredimarrësi duhet të njoftojnë me shkrim Bankën për ndryshimin e adresës dhe mënyrës së njoftimit të treguar më sipër.

5. Kjo kontratë do të zgjidhet (përfundojë) në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

1. me shlyerjen e plotë të detyrimit të Kredimarrësit;
2. me mbarimin e afatit të kontratës;
3. me heqjen dorë të Bankës, të parashikuar në pikën 9;
4. me zgjidhjen e kontratës në mënyrë të njëanshme nga Banka parashikuar në pikën 7;
5. nëse Kredimarrësi është person juridik ose person fizik, me mbarimin e tij.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, kontrata në fjalë hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët, në gjashtë kopje origjinale (një kopje për secilën palë dhe kopja e tretë për noterin), në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë e të pavesuar para meje noterit, sot më datë _____ **2025.**

PALËT KONTRAKTUESE

BANKA "BANKA E TIRANËS" SHA
përfaqësuar nga:

_____
Drejtore e Divizionit të Korporatave

KREDIMARRËSI "FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL" SHA
përfaqësuar nga:

_____

BASHKËKREDIMARRËS:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA
përfaqësuar nga:

_____
Drejtore e Departamentit të Administrimit të Kredive

FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË SHA
përfaqësuar nga:

_____

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SHA
përfaqësuar nga:

_____

NOTERE

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 3, datë 15.7.2025

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË TARIFËS FIKSE TË VEPRIMIT PËRMBARIMOR, LLOJET E VEPRIMEVE PËRMBARIMORE TË TARIFUARA DHE RASTET E PËRJASHTIMIT NGA PARAPAGIMI I TARIFËS PËR KATEGORI TË CAKTUARA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 34, pika 3, të ligjit nr. 8/2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij udhëzimi është:

a) përcaktimi i masës së tarifës së shërbimeve përmbarimore të ofruara nga përmbaruesi gjyqësor shtetëror gjatë procedurës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv;

b) përcaktimi i llojeve të veprimeve përmbarimore të tarifuara;

c) përcaktimi i rasteve të përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara.

II. LLOJET E VEPRIMEVE PËRMBARIMORE TË TARIFUARA DHE MASAT E TARIFËS FIKSE TË SHËRBIMEVE PËRMBARIMORE

1. Masa e tarifës fikse të shërbimit përmbarimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar si kthim shume dhe/ose pagim detyrimi, përllogaritet si më poshtë:

a) Tabela e tarifave fikse përmbarimore në lek, sipas vlerave të detyrimit:

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në lekë mbi vlerën e detyrimit)
1 – 10,000	6,000
10,001 – 20,000	7,000
20,001 – 30,000	8,000
30,001 – 40,000	9,000
40,001 – 50,000	10,000
50,001 – 60,000	11,000
60,001 – 70,000	12,000
70,001 – 80,000	13,000
80,001 – 90,000	14,000
90,001 – 100,000	15,000
100,001 – 150,000	17,000
150,001 – 200,000	18,000
200,001 – 250,000	20,000
250,001 – 300,000	22,000
300,001 – 350,000	24,000
350,001 – 400,000	26,000
400,001 – 450,000	28,000
450,001 – 500,000	30,000

b) Tabela e tarifave fikse përmbarimore në %, sipas vlerave të detyrimit:

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në përqindje mbi vlerën e detyrimit)
500,001 – 2,000,000	5.5%
2,000,001 – 5,000,000	3.85%
5,000,001 – 10,000,000	2.75%
10,000,001 – 30,000,000	2.2%
30,000,001 – 90,000,000	1.65%
Mbi 90,000,000	1.1% Minimumi 1, 485,000 lekë Maksimumi 2, 500,000 lekë

2. Masa e tarifës fikse të shërbimit përmbarimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të pavlerësueshëm, përllogaritet në varësi të objektit të ekzekutimit si më poshtë:

a) për reklamimin e një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, vlera e tarifës fikse përllogaritet në masën e 1 page bazë minimale në shkallë vendi, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) për lirimin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, vlera e tarifës fikse përllogaritet në masën e 2 pagave bazë minimale mujore, kur sendi nuk ka një vlerë monetare të përcaktuar për çmimin e shitjes sipas të dhënave nga regjistri i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, apo sipas vlerësimit të një eksperti të pavarur të caktuar nga gjykata dhe/ose përmbaruesi gjyqësor. Në rast se sendi i paluajtshëm ka një vlerë referuese për çmimin e shitjes së tij sipas të dhënave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës apo

sipas vlerësimit të ekspertit, atëherë tarifa fikse përllogaritet në përqindje mbi vlerën e sendit, sipas tabelës së treguar në pikën 1 të këtij kreu;

c) për vënien në posedim të sendit të luajtshëm, vlera e tarifës fikse përllogaritet në masën e 1 page bazë minimale në shkallë vendi, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, kur sendi nuk ka një vlerë të përcaktuar për çmimin e shitjes. Në rast se sendi i luajtshëm ka një vlerë të përcaktuar për çmimin e shitjes në dokumentacionin e regjistruar apo ka një vlerë të përcaktuar për të cilën ky send është regjistruar si barrë siguruese, atëherë tarifa fikse do të përllogaritet në përqindje sipas tabelës së parashikuar në pikën 1 të këtij kreu;

ç) për marrjen e fëmijës dhe lejimin e së drejtës së vizitës, masa e tarifës fikse përllogaritet në masën 5,000 lekë, ndërsa tarifa fikse që lidhet me ekzekutimin e masës së detyrimit ushqimor është zero lekë;

d) për organizimin dhe shitjen e sendit në ankand, masa e tarifës fikse përllogaritet në masën e 1 page bazë minimale në shkallë vendi, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

dh) për zbatimin e një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv me objekt të pavlerësueshëm, nëpërmjet të cilit debitori duhet të përmbushë një detyrim të caktuar jo monetar, masa e tarifës fikse përllogaritet në masën e 1 page bazë në shkallë vendi, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Masa e tarifës fikse të shërbimit përmbarimor, kur titulli ekzekutiv është vendim i gjykatës për sigurimin e padisë, përllogaritet si më poshtë:

a) nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është deri në 500,000 lekë, tarifa është 1/4 e pagës bazë minimale mujore;

b) nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është më shumë se 500,000 lekë deri në 2,000,000 lekë, tarifa është 1/2 e pagës bazë minimale mujore;

c) nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është më shumë se 2,000,000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me 1 pagë bazë minimale mujore;

ç) nëse vendimi për sigurimin e një padie përmban një detyrim jomonetar ose vlera e padisë nuk është e përcaktuar, tarifa e subjektit përmbarimor është një shumë e barabartë me 1/3 e pagës bazë minimale mujore.

4. Tarifa për ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt "gjobë penale", "gjobë administrative" dhe "shpenzime procedurale" është:

a) për vlerën deri në 100.000 lekë, tarifa është 10%;

b) për vlerën mbi 100.000 lekë, tarifa është 5%.

5. Tarifa fikse e përllogaritur, sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij kreu, parapaguhet nga kreditori në llogarinë bankare të Zyrës Përmbarimore Gjyqësore në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit përmbarimor prej subjektit përmbarues dhe në fund të ekzekutimit i ngarkohet debitorit ose personave të barazuar me të.

6. Tarifa fikse e përllogaritur sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4, të këtij kreu, paguhet nga debitori apo personi i barazuar me të pas ekzekutimit tërësor të detyrimit që përmban titulli ekzekutiv ose në proporcion me vlerën e detyrimit të ekzekutuar.

7. Tarifa për ekzekutimin e titujve ekzekutivë sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4, të këtij kreu, në çdo rast nuk mund të jetë më e madhe se 2,500,000 lekë, pavarësisht vlerës së detyrimit.

8. Për të gjitha tarifat e parashikuara nga ky udhëzim zbatohet vlera përkatëse e TVSH-së.

III. RASTET E PËRJASHTIMIT NGA PARAPAGIMI I TARIFËS PËR KATEGORI TË CAKTUARA

1. Përjashtohen nga parapagimi i tarifës fikse të shërbimit përmbarimor:

a) subjekte përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti sipas ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" ose që përjashtohen nga pagesa e një tarife shtetërore, për shkak të paaftësisë paguese;

b) subjekti që paraqet për ekzekutim një vendim gjyqësor, i cili ka vendosur mbi të drejtat civile në procesin penal;

c) pala kreditore që paraqet për ekzekutim një vendim përfundimtar të gjykatës administrative, që ka marrë formë të prerë ose vendim për sigurimin e padisë, sipas legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative;

ç) organet e administratës shtetërore përjashtohen nga detyrimi për parapagimin e

tarifave për vënien në ekzekutim të vendimeve për kundërvajtjet administrative.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ky udhëzim zbatohet për veprimet përmbarimore të ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror, pas hyrjes në fuqi të tij.

2. Udhëzimi i përbashkët nr. 1276/5, datë 27.7.2017, i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror", i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 4, datë 15.7.2025

PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT MINIMAL DHE MAKSIMAL TË ZBATIMIT TË VLERËS SË TARIFËS SË SUKSESIT PËR VEPRIMET PËRMBARIMORE TË OFRUARA NGA SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 35, pika 2, të ligjit nr. 8/2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i nivelit maksimal dhe minimal të zbatimit të tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror.

2. Masa e tarifës së suksesit është shprehje e vullnetit të palës kreditore dhe përmbaruesit gjyqësor dhe përcaktohet me marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët, sipas formatit "tip", miratuar me urdhër të veçantë nga ministri i Drejtësisë.

3. Masa e tarifës së suksesit përcaktohet në marrëveshjen e nënshkruar midis kreditorit dhe subjektit përmbarues, duke respektuar nivelin minimal dhe maksimal të aplikimit të saj, sipas përcaktimit në këtë udhëzim.

4. Pala kreditore dhe subjekti përmbarues përcaktojnë vlerën konkrete, të tarifës së suksesit, bazuar në kriteret e mëposhtme si:

a) shumën totale të detyrimit;

b) kohën e ekzekutimit nga ana e subjektit përmbarues;

c) shpejtësinë e kryerjes së veprimeve përmbarimore, brenda afateve maksimale ligjore;

ç) përcaktimin e veprimeve apo rezultateve alternative që konsiderohen në mënyra të ndryshme si sukses, duke përllogaritur tarifa alternative suksesi;

d) përcaktimin e nivelit minimal të arkëtimit të detyrimit, që do të konsiderohet si sukses nga palët;

dh) sekuestrimin dhe/ose ekzekutimin e sendeve në pronësi të palës debitore, përveç pasurive të hipotekuara nga pala debitore si mjet për të siguruar ekzekutimin e detyrimit.

5. Tarifa e suksesit paguhet në çdo rast nga kreditori, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar nga kreditori dhe zyra përmbarimore. Tarifa e suksesit nuk parapaguhet dhe nuk i ngarkohet debitorit.

6. Në çdo rast, aplikohet TVSH-ja mbi tarifën e suksesit të bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshje.

II. TARIFA E SUKSESIT E PËRLLOGARITUR MBI BAZËN E SHUMËS SË EKZEKUTUAR

1. Kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar, pala kreditore dhe subjekti përmbarues, sipas vullnetit të tyre, mund të parashikojnë në marrëveshje masën e tarifës së suksesit, por në çdo rast kjo tarifë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 20% e vlerës së ekzekutuar të detyrimit. Në rast të marrjes pjesë në ekzekutim edhe të kreditorëve të tjerë të po atij debitori, secili prej tyre ka të drejtë të përcaktojë se cila do të jetë vlera e tarifës së suksesit.

2. Pala kreditore ka detyrimin që të informojë për shumat e ekzekutuara në llogarinë e saj, si dhe

t'i paguajë subjektit përmbarues tarifën e suksesit për shërbimin e arkëtimit të detyrimit monetar të mbledhur, jo më vonë se 30 ditë nga momenti i realizimit të arkëtimit të detyrimit monetar. Në rast se ekzekutimi i shumës së detyrimit monetar kryhet nëpërmjet llogarisë bankare të subjektit përmbarues, pagesa/faturimi i tarifës së suksesit do të bëhet pas kreditimit të kësaj pagese në llogarinë e palës kreditore/kërkuesit.

3. Tarifa e suksesit e caktuar në marrëveshje ndërmjet kreditorit dhe subjektit përmbarues, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar në vlerë:

a) deri në 500,000 lekë, nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 20% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose kombinimit të të dyjave;

b) mbi 500,000 lekë deri në 90,000,000 lekë, nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 10% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose kombinimit të të dyjave;

c) mbi 90,000,000 lekë, nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 5% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar dhe/ose vendimit të ndërmjetëm të ekzekutuar ose kombinimit të të dyjave, por jo më shumë se 10,000,000 lekë.

4. Tarifa e suksesit paguhet në çdo rast nga kreditori në përfundim të procesit të ekzekutimit ose në përfundim të veprimeve të caktuara, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar nga kreditori dhe subjekti përmbarues kur kanë dakordësuar zbatimin e tarifës së suksesit për titullin ekzekutiv në fjalë.

III. TARIFA E SUKSESIT E PËRLLOGARITUR MBI BAZËN E VEPRIMEVE PËRMBARIMORE TË KRYERA

1. Vlera e tarifës së suksesit të shërbimit përmbarimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të pavlerësueshëm, përllogaritet në varësi të:

a) vendit të ekzekutimit;

b) objektit të ekzekutimit;

c) kohës së kryerjes së veprimit përmbarimor dhe/ose përsëritjes së këtij veprimi përmbarimor.

2. Bazuar në kriteret si më sipër treguar, tarifa e suksesit për veprime përmbarimore të kryera është një vlerë monetare, e cila nuk mund të jetë më pak se 1,000 (një mijë) lekë dhe jo më shumë se 100,000 (njëqind mijë) lekë.

IV. KOMBINIMI I TARIFËS SË SUKSESIT

1. Pala kreditore dhe subjekti përmbarues mund të bien dakord në përputhje me marrëveshjen "tip" të miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë, aplikimin e tarifës në mënyrë të kombinuar, mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar, por gjithmonë shuma e tarifës së suksesit e kombinuar nuk duhet të kalojë shumën që do të aplikohej në aplikimin e secilës metodë tarifimi më vete.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ky udhëzim zbatohet për veprimet përmbarimore të ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror, pas hyrjes në fuqi të tij.

2. Udhëzimi i përbashkët nr. 1276/6, datë 27.7.2017, i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave "Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror", i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 444, datë 15.7.2025

PËR PËRCAKTIMIN E NDARJES SË TË ARDHURAVE, KRITEREVE E PROCEDURAVE TË ADMINISTRIMIT DHE SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 14, pika 2 të ligjit nr. 8/2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave,

URDHËROJNË:

1. Objekti i këtij urdhri është përcaktimi i ndarjes së të ardhurave, kritereve e procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së të ardhurave që arkëtojnë Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe zyrat përmbarimore vendore nga masa e tarifës fikse të veprimit përmbarimor dhe vlera e tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror.

2. Të ardhurat e përfituara nga kryerja e veprimeve përmbarimore, i kalojnë në masën 10% Shërbimit Përmbarimor Shtetëror, ndërsa 90% derdhen në buxhetin e shtetit.

3. Masa e të ardhurave të përfituara nga Shërbimi Përmbarimor Shtetëror shpërndahet në mënyrë përpjestimore, si më poshtë:

a) në masën 60%, për shpërblimin e punonjësve të nivelit qëndror dhe vendor të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror;

b) në masën 20%, për investime;

c) në masën 20%, për mallra dhe shërbime të tjera.

4. Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, për shërbimin që kryejnë si Agjent Tatimor, përfitojnë komision, të cilin e marrin në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi shumat e arkëtuara të të ardhurave që kanë transferuar në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore për Buxhetin e Shtetit.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe zyrat përmbarimore vendore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

URDHËR
Nr. 483, datë 19.9.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 313, DATË 20.10.2020, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE PROCEDURAT E EMËRIMIT, PEZULLIMIT DHE LARGIMIT NË SHËRBIMIN PSIKOSOCIAL", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 20 dhe shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial", i ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

A. Pika 4, e kreut II, ndryshon si më poshtë:

"*4. Numri i psikologëve/punonjësve socialë, në njësinë e shërbimit psikosocial, përcaktohet si vijon:*

a) një psikolog/punonjës social për çdo shkollë që ka 251–450 nxënës;

b) dy psikologë/punonjës socialë për çdo shkollë me 451 ose më shumë nxënës;

c) një psikolog/punonjës social për çdo shkollë që ka të paktën 8 nxënës me aftësi të kufizuara të përcaktuar me raport të Komisionit Mjekoligjor;

ç) një psikolog për çdo shkollë të arsimit special;

d) në rastet kur shkollat kanë numër më të vogël nxënësish, një psikolog/punonjës social do të mbulojë disa shkolla dhe numri total i nxënësve do të jetë nga 80–250".

B. Pika 3, e kreut IV, ndryshon si më poshtë:

"3. DRAP-i, bazuar në kërkesën e ZVAP-së, shpall vendin e lirë të punës për psikologë/punonjës socialë, menjëherë sapo vendi i punës del i lirë".

C. Pika 7, e kreut IV, ndryshon si më poshtë:

"7. Për realizimin e procedurave të konkurimit dhe shpalljes së listës së kandidatëve fitues, DRAP-i përkatës krijon një komision ad-hoc, i cili përbëhet nga 1 (një) përfaqësues nga AKAP-ja, 1 (një) përfaqësues nga DRAP dhe 1 (një) përfaqësues nga njëra prej ZVAP-ve".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Orjana Osmani

URDHËR
Nr. 490, datë 25.9.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit, z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm, si vijon:

a) të nënshkruajë autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Arsimit, në emër të nëpunësit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha gjykatat dhe shkallët e gjykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si edhe t'i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;

b) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore dhe të huaja për Ministrinë e Arsimit;

c) autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Arsimit, jashtë qendrës së punës, brenda vendit të punës, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit;

d) vënien në zbatim të programit institucional të transparencës dhe rishikimin e tij sipas së njëjtës procedurë që është miratuar, në zbatim të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit;

e) të nënshkruajë marrëveshje për Ministrinë e Arsimit, me palë të treta sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi;

f) të nënshkruajë urdhrat për ngritjen e grupeve të punës me nëpunës të Ministrisë së Arsimit apo strukturave vartëse për hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore që mbulon fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit;

g) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Arsimit;

h) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Arsimit me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon ministrit;

i) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër apo autorizim nga ministri.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

3. Urdhri nr. 523, datë 15.9.2023, "Për delegimin e kompetencave", shfuqizohet.

4. Ngarkohet z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit në Ministrinë e Arsimit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

NJOFTIM
Nr. 13471, datë 24.9.2025

PËR PEZULLIMIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. "Marrëveshja midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Bashkëpunuese të Guajanës mbi përjashtimin e kërkesave për vizë për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit dhe pasaportave të zakonshme", nënshkruar më 27.1.2020, pezullohet duke filluar nga data 29.7.2024.

2. "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Bjellorusisë për heqjen reciproke të kërkesave për vizë", nënshkruar më 27.12.2019, pezullohet duke filluar nga data 30.9.2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
Nr. 42, datë 1.7.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 25.2.2025 dhe 23.6.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 10 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria "Studio Pustina" sh.p.k., përfaqësuar nga avokat Klodjan Skënderaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorja Enkeleda Millonai.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve datë 28.4.2023, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 206, datë 1.6.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 128, datë 15.9.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-741 (26), datë 8.2.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 37 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të shoqërisë "Studio Pustina" sh.p.k. *(kërkuesja),* e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e saj në fushën e konsulencës dhe shërbimeve financiare, ekonomike prej vitit 2011, me ortake të vetme dhe administratore shtetasen A.P.

2. Në muajin dhjetor 2020 Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr.

287/2020 për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal *(KP)*. Objekti i hetimit kishte të bënte me procesin e kthimit të pronës në favor të pesë familjeve ish-pronare, me procesin e privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish-klubit sportiv "Partizani"), si dhe me procesin e ndryshimit të destinacionit dhe më pas edhe të zhvillimit të pronës, nën dyshimin se për këto procese janë dhënë dhe marrë përfitime monetare, paligjshmëria në origjinën e të cilave është fshehur nëpërmjet veprimeve financiare, transaksioneve të copëzuara ose në *cash*, duke u favorizuar në mënyrë të paligjshme shtetasit J.M., Xh.B. dhe F.B., të cilët, sikundër edhe shoqëria "H." sh.p.k. e lidhur me ta, kanë realizuar në atë pronë ndërtimin e një blloku pallatesh.

3. Gjatë hetimeve paraprake ka rezultuar se zhvillimi i pronës është bërë nga shoqëria "H." sh.p.k., e krijuar në vitin 2008, me ortak të vetëm dhe administrator shtetasin F.B. (përfitues i një prej familjeve ish-pronare), referuar dokumentacionit të saj, të sekuestruar në datën 24.1.2023, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit *(QKB)*. Po sipas këtij dokumentacioni, shtetasit Xh.B. dhe J.M. (përfitues të një familjeje tjetër ish-pronare) janë bërë formalisht ortakë të shoqërisë në vitin 2018, me regjistrimin e kontratave për blerje kuotash, ndonëse ato datojnë në vitin 2014, ndërkohë që përgjatë kësaj periudhe shtetasi F.B. ka vijuar të sillet si ortak i vetëm dhe administrator i saj. Këtij të fundit, në datën 28.4.2023, ora 12:12, i janë marrë deklarime nga ka dalë e dhëna se dokumentacioni financiar i shoqërisë në lidhje me aktivitetin e ndërtimit në pronën objekt hetimi është mbajtur nga kërkuesja. Mbi dyshimin se në zyrën e saj mund të gjendeshin prova për gjendjen reale të ortakëve të shoqërisë "H." sh.p.k., investimet e tyre dhe ndarjen e fitimit në vite, të kamufluar në funksion të pastrimit të produkteve të veprës penale, me vendimin e së njëjtës datë, mbështetur në nenet 208 e vijuese të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), prokurorët e çështjes kanë urdhëruar sekuestrimin në zyrën e kërkueses: i. të të gjitha dokumenteve që kishin lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k.; ii. të kompjuterit në të cilin mbaheshin të dhënat e kësaj shoqërie; iii) të çdo gjëje tjetër që vlerësohej me rëndësi për hetimin dhe që ofronte të dhëna për faktin objekt hetimi *(vendimi i sekuestrimit)*. Për kryerjen e sekuestrimit janë ngarkuar tre oficerë të policisë gjyqësore (*OPGJ*), hetues financiarë të Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët janë urdhëruar të njihnin personat e interesuar me vendimin, për të cilin lejohej ankim sipas ligjit.

4. Po në datën 28.4.2023 OPGJ-të janë paraqitur në zyrën e kërkueses dhe kanë zbatuar vendimin e sekuestrimit në prani të përfaqësueses së saj, administratores A.P. Në procesverbalin e sekuestrimit, krahas orës së përpilimit, 15:30, OPGJ-të kanë evidentuar se ai mbahej në bazë të neneve 300 dhe 301 të KPP-së, në zbatim të vendimit të prokurorëve dhe në vijim kanë përshkruar "*Sendet/dokumentet e gjetura (apo të dorëzuara) nga shtetasja A.P., pronare e vetme e subjektit tregtar "Studio Pustina*" dhe konkretisht 4 pajisje kompjuterike (2 laptopë dhe 2 njësi qendrore) me të dhënat përkatëse të identifikimit, 407 dokumente shkresore (fatura tatimore, kontrata, akt-marrëveshje, raporte, mandatarkëtime, pasqyra financiare etj.) që lidhen me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe 4 dokumente shkresore të tjera (pasqyra financiare) që në dukje u përkisnin subjekteve të tjera juridike. Procesverbali është nënshkruar rregullisht pa vërejtje edhe nga përfaqësuesja e kërkueses dhe asaj i është dhënë një kopje e tij.

5. Në datën 2.5.2023 përfaqësuesja A.P. e kërkueses është pyetur nga OPGJ-të në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, ndërsa ajo ka dhënë deklarime për lidhjen e saj dhe të "Studio Pustina" me shoqërinë "H." sh.p.k., administratorin dhe ortakët e saj, si dhe për veprimet financiare të kryera për ata.

6. Ndërkohë, në datën 3.5.2023 kërkuesja ka paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të sekuestrimit, duke kërkuar deklarimin e tij si të marrë në kundërshtim me nenin 208/a të KPP-së dhe kthimin e sistemeve kompjuterike të sekuestruara, si dhe konstatimin e veprimeve të OPGJ-ve si të kryera në shkelje të dispozitave të KPP-së për kontrollin e vendeve, për rrjedhojë në kundërshtim me nenin 37 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së.

7. Në datën 19.5.2023 Prokuroria e Posaçme, me arsyetimin se mbajtja e sekuestros nuk ishte e nevojshme, i ka kthyer kërkueses 1 nga pajisjet kompjuterike (laptop) të sekuestruara, duke vijuar mbajtjen nën sekuestro të 3 pajisjeve të tjera.

8. Për kërkesën ankimore të kërkueses, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(GJKKO-ja e Shkallës së Parë),* me vendimin nr. 206, datë 1.6.2023, ka vendosur rrëzimin e saj. Sipas asaj gjykate, referuar procesverbalit të sekuestrimit, OPGJ-të kanë vepruar në bazë të neneve 300 dhe 301 të KPP-së dhe kërkueses i janë sekuestruar dokumentet që kishin lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., si dhe kompjuteri në të cilin mbaheshin të dhënat e kësaj shoqërie, duke vlerësuar se sekuestrimi është kryer në përputhje me nenin 208 të KPP-së. Po sipas saj, ndërsa çështja ndodhej në fazën e hetimeve, është detyrim i prokurorit të kryejë një hetim të plotë dhe shterues dhe sendet e sekuestruara duhet të vazhdojnë të qëndrojnë në këtë gjendje deri në përfundimin e hetimeve. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

9. Në vijim, në datën 7.6.2023 Prokuroria e Posaçme, me të njëjtin arsyetim për panevojshmërinë e mbajtjes së sekuestros, i ka kthyer kërkueses edhe 2 nga pajisjet e tjera kompjuterike (njësitë qendrore) të sekuestruara, duke vijuar mbajtjen nën sekuestro tashmë vetëm të njërës prej tyre.

10. Në lidhje me ankimin e kërkueses, Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(GJKKO-ja e Apelit),* me vendimin nr. 128 (87-2023-196), datë 15.9.2023, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas asaj gjykate, masa e sekuestrimit provues e zbatuar në rastin konkret rregullohet nga neni 208 i KPP-së, i cili i jep të drejtë edhe prokurorit për të vendosur për sekuestrimin ose kufizimin e disponimit të lirë të sendeve dhe provave materiale kur kjo është e domosdoshme për vërtetimin e fakteve të caktuara të procedimit penal. Për nga qëllimi dhe "urgjenca" që paraqet, ky lloj sekuestrimi është kryesisht mjet i prokurorit, pasi ai drejton hetimet paraprake dhe njeh nevojat e procedimit penal. Pajisjet e sekuestruara, ndërsa janë të pandërlidhura në një rrjet/sistem kompjuterik, në referim të nenit 1 të Konventës "Për krimin në fushën e kibernetikës" (*Konventa e Budapestit*), nuk janë sisteme kompjuterike në kuptim të nenit 208/a të KPP-së, por veçse mekanizma të automatizuar ose sende në kuptim të nenit 187 të KPP-së, të cilat me të dhënat apo gjurmët që mund të përmbajnë, shërbejnë si prova materiale. Për rrjedhojë, disponimi i prokurorëve për sekuestrimin e sendeve dhe dokumenteve është në përputhje me nenin 208, pika 1, të kombinuar me nenet 187 dhe 191 të KPP-së, pasi ato lidhen dhe ofrojnë të dhëna për faktet objekt hetimi. Në lidhje me veprimet e OPGJ-ve, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se procesverbali i sekuestrimit dokumenton korrektësisht veprimet e kryera nga OPGJ-të, nga del qartazi se ato nuk janë veprime kontrolli sipas nenit 202 të KPP-së, ndaj, për rrjedhojë, ata kanë vepruar brenda hapësirës së veprimit të deleguar nga prokurorët, në përputhje me nenet 30, pikat 2 e 3 dhe 208, pika 2, të KPP-së. Kundër vendimit të GJKKO-së së Apelit kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-741(26), datë 8.2.2024, pasi ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore dhe ka dëgjuar palët, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të asaj gjykate, duke vlerësuar se në rekurs nuk ngrihen shkaqe për cenimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe se kjo e fundit ka arsyetuar në mënyrë shteruese në lidhje me pretendimet e ankueses (kërkueses). Sipas Gjykatës së Lartë, disponimi i prokurorëve për sekuestrimin e sendeve/dokumenteve është në përputhje me nenin 208 të KPP-së dhe me konkluzionet e vendimit njësues nr. 147/2021, ndërkohë që në këtë rast nuk është i zbatueshëm neni 208/a i KPP-së, pasi ai u referohet veprave penale që kanë të bëjnë me krime që lidhen me teknologjinë e informacionit. Ndërsa gjatë hetimeve paraprake është organi i prokurorisë ai që vlerëson se cilat sende/dokumente janë të nevojshme për hetimin dhe duhen sekuestruar, në rastin konkret ky organ, pasi ka identifikuar faktin se ankuesja ka pasur në administrim akte ose të dhëna në lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe ka kryer veprime ekonomike ligjore për të, ka disponuar me vendimin e sekuestrimit të kundërshtuar nga ankuesja. Megjithatë, kjo e fundit nuk argumenton faktin se në pajisjet e sekuestruara nuk ndodhet asnjë e dhënë e kësaj shoqërie apo për personat nën hetim, ndërkohë që asaj, pas ekzaminimit, i janë kthyer disa prej tyre. Po sipas Gjykatës së Lartë, në zbatim të vendimit të sekuestrimit, OPGJ-të, në vlerësim dhe për aq sa është e mundur të sendeve që kanë pasur të dhëna për shoqërinë në fjalë, i kanë sekuestruar

ato sipas procesverbalit të sekuestrimit, me të cilin është njohur edhe përfaqësuesja e ankueses, ndërsa kjo e fundit nuk ka referuar në procesverbal asnjë problematikë për përmbajtjen dhe përkatësinë e sendeve dhe dokumenteve. Nga analiza e vendimit të sekuestrimit dhe e veprimeve të kryera nga OPGJ-të nuk konstatohet të jemi përpara një kontrolli, por ka një pasqyrim të qartë të qëllimit të sekuestrimit të sendeve/dokumenteve ku mund të ndodhen të dhëna të dobishme për hetimin. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, nuk ndodhemi para veprimeve të cilat nuk kanë respektuar parashikimet e nenit 37 të Kushtetutës ose të nenit 8 të KEDNJ-së.

12. Në vijim të hetimeve paraprake, Prokuroria e Posaçme ka ngritur akuzë ndaj kërkueses, "Studio Pustina" sh.p.k. dhe ndaj administratores së saj, shtetases A.P., për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë, i KP-së, në formën e parashikuar nga shkronjat "b", "ç" dhe "dh" të tij, të kryer në bashkëpunim. Në datën 10.10.2024 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesë për dërgimin për gjykim të çështjes penale edhe në ngarkim të kërkueses dhe administratores së saj, krahas disa subjekteve të tjerë, ndërsa këta të fundit janë akuzuar për veprat penale "Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", në bashkëpunim apo edhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuara nga nenet 245, 260 e 25 dhe 287 të KP-së.

13. Më herët, në datën 20.6.2024, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankimin kushtetues individual në shqyrtim, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 23.9.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 22.10.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

14. Ankimi kushtetues i kërkueses është shqyrtuar në seancën plenare mbi bazë të dokumenteve të datës 25.2.2025. Pas përfundimit të seancës trupa është tërhequr në dhomën e këshillimit për vendimmarrje dhe diskutimet kanë vijuar deri në datën 11.4.2025, kur Gjykata, bazuar në parashikimet e nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur riçeljen e seancës plenare mbi bazë të dokumenteve, duke vlerësuar të nevojshëm sqarimin e rrethanave plotësuese me rëndësi për çështjen. Palët janë njoftuar për këtë vendim dhe u është kërkuar paraqitja e argumenteve me shkrim, përfshirë edhe të çdo prove relevante, në drejtim të disa aspekteve konkrete të gjykimit kushtetues. Në vijim, seanca plenare mbi bazë të dokumenteve është zhvilluar në datën 23.6.2025 dhe palët janë njoftuar rregullisht.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. Kërkuesja, në mënyrë të përmbledhur, në ankimin kushtetues individual dhe në parashtrimet e saj, ka pretenduar se janë cenuar:

15.1. *E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

15.1.1. Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi gjyqtarja I.Gj., që ka dhënë vendimin në shkallë të parë, ka qenë në kushtet e mbarimit të mandatit të magjistratit, në kuptim të nenit 6/1 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" *(ligji nr. 96/2016),* pasi nuk ka deklaruar në formularin përkatës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*" (ligji nr. 138/2015),* dënimin penal nga gjykata e shtetit grek. Ky vendim dënimi është siguruar nga një subjekt tjetër në datën 2.5.2025 dhe ai i është vënë në dispozicion kërkueses pas datës 5.5.2025, të përcaktuar nga Gjykata për paraqitjen e argumenteve dhe provave shtesë. Ndërkohë, në deklaratën publike të datës 4.3.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka konsideruar këto "sulme" ndaj gjyqtares, çka ka penguar zbulimin e provave për faktin e dënimit të saj.

15.1.2. Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi gjykatat më të larta nuk u kanë dhënë përgjigje të argumentuara pretendimeve të kërkueses, siç është ai se OPGJ-të për të zbatuar vendimin e sekuestrimit kanë kryer kontroll të hollësishëm të zyrës pa vendim gjyqësor, në shkelje të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së. Gjykata e shkallës së parë

ka theksuar se OPGJ-të kanë vepruar në kushtet e ngutshmërisë, sipas neneve 300 dhe 301 të KPP-së, çka nuk është rasti konkret, kurse gjykatat më të larta e kanë injoruar këtë pretendim. Gjykata e apelit ka përshkruar përkufizimin e sistemeve kompjuterike sipas Konventës së Budapestit, por nuk ka argumentuar se përse pajisjet e sekuestruara kërkueses nuk janë të tilla. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë është jologjik dhe në të nuk u jepen përgjigje pretendimeve të mbrojtjes se përse kontrolli pa vendim gjyqësor është i ligjshëm dhe përse nuk duhet vendim gjyqësor për sekuestrimin e të dhënave dhe të sistemeve kompjuterike dhe, për më tepër, nuk argumentohet se ku ndryshon ky rast nga ai në vendimin e saj njësues nr. 147/2021. Gjykatat nuk kanë arsyetuar për domosdoshmërinë e kontrollit të zyrës dhe sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike, kur të paktën në 3 nga pajisjet nuk ka të dhëna që kanë lidhje me hetimin.

15.1.3. Parimit të sigurisë juridike, për shkak të mosrespektimit të vendimit njësues nr. 147/2021 të Gjykatës së Lartë dhe zbatimit arbitrar të neneve 202 e 208 të KPP-së. Siç është theksuar në vendimin njësues, në përputhje me parashikimet e nenit 208 të KPP-së, prokurori duhet të kishte përcaktuar specifikisht sendet dhe dokumentet që kërkonte të sekuestronte, çka do të kishte shmangur kontrollin e paautorizuar të zyrës së kërkueses.

15.2. *E drejta e jetës private,* sipas neneve 22, 23, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, pasi:

15.2.1. OPGJ-të kanë kryer kontroll të zyrës pa vendim gjyqësor, në kundërshtim me nenin 202 të KPP-së, gjatë të cilit kanë sekuestruar sisteme kompjuterike pa disponim gjyqësor, në kundërshtim me nenin 208/a të KPP-së dhe vendimin njësues nr. 147/2021. Për zbatimin e vendimit të sekuestrimit OPGJ-të kanë hyrë në zyrën e kërkueses dhe kanë kontrolluar të gjithë kompjuterët, dollapët dhe sirtarët bazuar në bindjen e tyre. Ata kanë sekuestruar jo vetëm kompjuterin ku mbaheshin të dhënat e shoqërisë "H." sh.p.k., por edhe 3 kompjuterë të tjerë, që nuk kanë qenë objekt i vendimit të sekuestrimit dhe nuk kanë lidhje me hetimin. Po ashtu, kanë sekuestruar edhe dokumente, disa nga të cilat nuk kanë lidhje me objektin e hetimit.

15.2.2. Fakti që është kryer kontroll përpara sekuestrimit shpjegohet në mënyrë të besueshme nga përfaqësuesja e kërkueses, shtetasja A.P., përveçse ai rezulton qartësisht edhe nga vendimi dhe procesverbali i sekuestrimit. Kontrolli nga OPGJ-të është diktuar *de facto* nga përmbajtja e vendimit të sekuestrimit, përndryshe ai ishte i paekzekutueshëm. Në atë vendim, në shkelje të nenit 208 të KPP-së, prokurorët nuk kanë specifikuar sendet dhe dokumentet objekt sekuestrimi, për të shmangur kontrollin e paautorizuar të zyrës. Ata janë shprehur për sekuestrimin edhe për "*të çdo gjëje tjetër që vlerësohet me rëndësi mbi faktin objekt hetimi*", duke mos nënkuptuar kështu një dorëzim vullnetar nga kërkuesja. Edhe nga procesverbali i sekuestrimit kuptohet qartë se është kryer kontroll dhe se shumë sende e dokumente janë marrë kundër vullnetit të kërkueses, pasi në të shënohet "*sendet/dokumentet e gjetura apo të dorëzuara*". Kontrolli i zyrës, për më tepër, është kryer pa u thirrur një person i besuar, siç mund të ishin avokatët që kanë njohuri të posaçme, sipas nenit 205 të KPP-së.

15.2.3. Nëse nuk do të kishte kontroll, por vetëm dorëzim vullnetar, përfaqësuesja A.P. e kërkueses nuk do të kishte dorëzuar edhe një kompjuter që nuk është në pronësi të saj dhe në të cilin mbahet kontabiliteti i një prej operatorëve më të mëdhenj në vend. Për më tepër, për të ka qenë e pamundur të vlerësonte se cilat ishin "dokumentet e tjera që kishin rëndësi mbi faktin objekt hetimi", në mënyrë që t'i dorëzonte vullnetarisht, pa u kryer kontroll nga OPGJ-të. Fakti që ajo nuk ka bërë vërejtje në procesverbal, nuk do të thotë se nuk ka shkelje. Kërkuesja ka paraqitur ankim, ndërkohë që KPP-ja nuk parashikon që për të drejtën e shkelur duhet të bëhen shënime në procesverbal.

15.2.4. Nuk qëndron pretendimi se sekuestrimi është urdhëruar në kushte urgjence, pas marrjes së deklarimit të shtetasit F.B., pasi këtij shtetasi i janë marrë disa herë deklarime. Për më tepër, dinamika e hetimit, ndërsa procedimi penal është regjistruar në datën 1.12.2020, pra më shumë se 2 vjet përpara, tregon se nuk ka pasur asnjë urgjencë, ndaj është e pakuptimtë përse nuk mund të merrej paraprakisht nga gjykata një vendim kontrolli. Edhe në rast të ekzistencës së kushteve të

urgjencës, dispozitat procedurale kërkojnë verifikimin gjyqësor të tyre.

15.2.5. Sekuestrimi i të dhënave dhe i sistemeve kompjuterike kryhet vetëm me vendim gjyqësor dhe ai mund të bëhet vetëm nëse është i domosdoshëm dhe vetëm për aq kohë sa është i nevojshëm për marrjen e të dhënave ose bërjen e kopjeve. Nëse ka disa sisteme ose pajisje kompjuterike duhet të përzgjidhen ato që cenojnë më pak personin, duke mbajtur në konsideratë bërjen e kopjeve, për të shmangur sa më shumë sekuestrimin. Në rastin konkret nuk është arsyetuar se përse sekuestrimi i të dhënave ose i sistemeve kompjuterike është i domosdoshëm për çështjen penale, kur të paktën në 3 prej tyre nuk ka të dhëna për shoqërinë "H." sh.p.k.; nuk është përcaktuar se cilat janë të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t`i nënshtrohen sekuestrimit dhe se çfarë synohet të provohet përmes kësaj mase; nuk janë përcaktuar modalitetet e sekuestrimit në mënyrë që të sekuestrohen vetëm të dhënat ose sistemet kompjuterike të përcaktuara shprehimisht; nuk është përcaktuar koha kur sistemet kompjuterike duhet të jenë në dispozicion të organit të akuzës. Sekuestrimi i sendeve të gjetura gjatë kontrollit as nuk është vleftësuar nga prokurori.

15.2.6. Në pajisjet e sekuestruara ndodhen informacione edhe për shumë klientë të tjerë të zyrës, informacione konfidenciale me kredenciale për akses në *e-Albania, self-care, e-filing* (faqja e tatimeve), *Profisc* (program për lëshimin e faturave *online),* llogari bankare, fjalëkalime për aksese në llogari bankare, posta elektronike të klientëve, si dhe programe kontabiliteti të domosdoshme për punën e kërkueses, të cilat ruhen nga sekreti profesional ose tregtar. Për më tepër, në dy nga pajisjet nuk ka asnjë informacion për shoqërinë "H." sh.p.k.

15.2.7. Ndërhyrja nuk respekton kriteret e nenit 17 të Kushtetutës dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ),* e cila ka theksuar se shtetet palë mund të kenë konsideruar të nevojshme t'u drejtohen masave të tilla si kontrollet dhe sekuestrimet për të marrë prova fizike për vepra penale dhe në raste të tilla shqyrtimi i masave do të synojë rëndësinë dhe përshtatshmërinë e arsyeve të dhëna për t'i justifikuar ato, si dhe pajtueshmërinë me parimin e proporcionalitetit të tyre me qëllimin e ndjekur. Seriozitetі i veprës penale që shkaktoi kontrollin dhe sekuestrimin, rrethanat në të cilat u dha urdhri, në veçanti nëse kishte ndonjë provë të mëtejshme në atë kohë, përmbajtja dhe qëllimi i urdhrit, duke pasur parasysh veçanërisht natyrën e objektit të kontrolluar dhe masat mbrojtëse të zbatuara për të kufizuar ndikimin e masës në kufij të arsyeshëm, mënyra në të cilën është kryer kontrolli dhe shkalla e pasojave të mundshme në respektimin e jetës private të personit në fjalë, janë të gjitha kritere të rëndësishme që duhen marrë parasysh në balancimin e interesave të ndryshëm konkurrues. GJEDNJ-ja, gjithashtu, kërkon që ligji vendas të ofrojë garanci të përshtatshme dhe të mjaftueshme kundër arbitraritetit, të cilat përfshijnë edhe "shqyrtimin efektiv" të masave që cenojnë nenin 8 të Konventës.

15.3. *E drejta e pronës private*, e cila gëzon mbrojtje edhe kur zhveshja e titullarit të sendit nga disponimi i ligjshëm bëhet për një kohë relativisht të shkurtër. Masa e sekuestros është e vlefshme dhe e ekzekutueshme menjëherë dhe qëndron në fuqi, si rregull, deri në përfundim të çështjes me vendim përfundimtar. Sekuestrimi i dokumenteve dhe i sendeve në rastin konkret është kryer në kundërshtim me ligjin, pa vendim gjyqësor, pa argumentuar domosdoshmërinë e sekuestrimit dhe janë sekuestruar dokumente që haptazi nuk i shërbejnë hetimit. Sekuestrimi jo vetëm i kompjuterit ku mbaheshin të dhënat e shoqërisë "H." sh.p.k. nuk ka qenë i domosdoshëm dhe proporcional, duke i sjellë dëme kërkueses, pasi në ato pajisje, sipas kërkesave ligjore, kryhen regjistrimet kontabël për mbylljen e pasqyrave financiare të klientëve.

16. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme,* në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

16.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt është i pabazuar, pasi gjykatat u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkueses dhe arsyetimi i tyre është i qartë dhe i mjaftueshëm për të kuptuar arsyet e vendimmarrjes dhe qëndrimin ndaj pretendimeve të ngritura. Vendimet gjyqësore janë logjike, nuk kanë kundërthënie dhe përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm.

16.2. Edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. Referuar praktikës së Kolegjit Penal nuk konstatohet që

neni 208/a i KPP-së të zbatohet në të gjitha rastet kur sekuestrohen pajisje elektronike. Evokimi i kësaj dispozite për sekuestrimin e çdo pajisjeje elektronike, siç janë kompjuterët ose aparatet telefonike, është abuziv për sa kohë ligjvënësi nuk e ka parashikuar një gjë të tillë, ndërkohë që kjo dispozitë zbatohet vetëm për krime në fushën e teknologjisë së informacionit. Për sa kohë pajisjet elektronike nuk ndërveprojnë dhe nuk transmetojnë tek të tretët informacion nëpërmjet rrugëve elektronike të komunikimit, nuk kemi të bëjmë me sisteme kompjuterike, por me sende.

16.3. Pretendimet për cenimin e së drejtës për jetë private dhe asaj të pronës private janë të pabazuara. Sekuestrimi është kryer në përputhje me ligjin, bazuar në nenet 208 e vijuese të KPP-së. Ai është urdhëruar në kuadër të një procedimi penal, të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, ndërsa ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se shoqëria "H." sh.p.k. po shërbente si strukturë, hallkë e pastrimit të parave. Sekuestrimi është urdhëruar për një qëllim të ligjshëm. Ai synonte zbulimin e të dhënave për ligjshmërinë e aktivitetit të shoqërisë dhe ortakëve të saj, duke qenë i domosdoshëm pikërisht për vërtetimin e momentit se kur realisht shtetasit J.M. dhe Xh.B. janë bërë ortakë të shoqërisë dhe cila ka qenë arsyeja e depozitimit të vendimit të shitjes së kuotave 4 vjet më vonë në QKB, si dhe hallkat që kanë vijuar për pastrimin e parave, ku një nga format e konsumimit të kësaj vepre penale është edhe mbulimi i natyrës së produktit të veprës penale, fshehja e origjinës, duke u kamufluar në formën e një dividenti, sikurse është krijuar dyshimi edhe në rastin konkret. Megjithatë, në vendimin e sekuestrimit nuk mund të evidentohej ajo se çfarë do të provohej nga sendet dhe dokumentet objekt sekuestrimi, për sa kohë të dhënat e hetimit paraprak mbulohen nga sekreti hetimor. Një gjë e tillë mund të evidentohet vetëm pas marrjes dhe shqyrtimit të tyre, në ndërthurje edhe me prova të tjera.

16.4. Sekuestrimi është drejtuar ndaj kërkueses, pasi ajo ka mbajtur kontabilitetin e shoqërisë për ndërtimet e kryera në pronën objekt hetimi. Asaj i janë sekuestruar vetëm ato pajisje kompjuterike dhe dokumente që kanë pasur lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe në të vërtetë në ato pajisje janë gjetur dokumente që kanë të bëjnë me këtë shoqëri. Edhe sekuestrimi i bilanceve të shoqërive që nuk kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. nuk i ka cenuar kërkueses asnjë të drejtë, ndërsa shoqëritë tregtare kanë detyrimin për depozitimin e bilanceve pranë QKB-së. Nisur nga rëndësia e veprës penale, sekuestrimi në këtë rast ka ruajtur proporcionalitetin mes interesit publik dhe interesit të kërkueses.

16.5. Pretendimi se në rastin konkret është ushtruar kontroll për shkak të përmbajtjes së vendimit të sekuestrimit është i pabazuar. Nisur nga fakti se dokumentacioni i shoqërive tregtare mund të mbahet në format letër ose elektronik, prokurorët kanë disponuar për sekuestrimin e të gjitha dokumenteve që kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe të kompjuterit ku mbahen të dhënat e saj, si dhe të çdo gjëje tjetër që vlerësohej me rëndësi për hetimin dhe që ofronte të dhëna për fakte objekt hetimi. Një mënyrë e tillë disponimi është e qartë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi në këtë rast ka qenë e pamundur bërja e një liste të dokumenteve. Ato mund të ishin bilance, kontrata, vendime ortakësh etj. dhe sidoqoftë lista do të përfundonte me fjalën "e të tjera", për shkak të pafundësisë së llojeve të akteve që mund të dispononte kërkuesja, si dhe për sa kohë që hetimi shtrihej në ngjarje ndër vite, në episode ku ishin implikuar shumë persona, roli dhe përgjegjësia e të cilëve ishte ende për t`u përcaktuar. Prokurorët janë shprehur edhe për sekuestrimin e çdo sendi tjetër që vlerësohet me rëndësi për hetimin dhe që ofron të dhëna për faktin objektin hetimi, duke mos abuzuar me të drejtën për vlerësimin e domosdoshmërisë, por duke ia deleguar OPGJ-ve sekuestrimin e tyre, në respektim të nenit 208 të KPP-së.

16.6. Sekuestrimi është urdhëruar në kushte urgjence, pas deklarimeve të shtetasit F.B., duke qenë se ekzistonte rreziku që ky shtetas, pasi të dilte nga ambientet e prokurorisë, të kontaktonte me bashkëpunëtorët e tij dhe kërkuesen dhe dokumentacioni që ajo kishte për shoqërinë "H." sh.p.k. mund të manipulohej ose zhdukej. Për zbatimin e vendimit, sikurse parashtrohet edhe në informacionin me shkrim të datës 28.4.2023, OPGJ-të janë paraqitur menjëherë pranë zyrës së kërkueses ku kanë marrë kontakt me recepsionisten që ka kërkuar të mos kryhet asnjë veprim deri në ardhjen e përfaqësueses A.P. të kërkueses, e cila është paraqitur disa minuta më

pas. Asaj i është vënë në dispozicion vendimi i sekuestrimit dhe i është kërkuar vënia në dispozicion e materialit. Ajo është treguar bashkëpunuese, duke krijuar kushtet dhe lehtësitë e nevojshme për realizimin e veprimeve hetimore, përfshirë vënien në dispozicion dhe të një kompjuteri për mbajtjen e procesverbalit nga OPGJ-të. Vetë ajo ka vënë në dispozicion të tyre dokumentet, kurse për pajisjet kompjuterike, duke qenë zyrë kontabiliteti, ka shprehur shqetësimin se sekuestrimi i tyre ndikonte në punën e përditshme, shqetësim që është marrë parasysh dhe ajo është sqaruar se nuk do të sekuestrohen pajisjet që nuk lidhen me shoqërinë "H." sh.p.k. Në vijim, OPGJ-të kanë marrë vetëm ato pajisje që nga vetë shtetasja A.P. janë identifikuar se përmbanin dokumente që lidheshin me këtë shoqëri. Në procesverbalin e sekuestrimit janë përshkruar hollësisht të gjitha dokumentet dhe pajisjet e sekuestruara dhe një kopje e tij i është dhënë A.P., e cila nuk ka pasur pretendime dhe nuk ka bërë ndonjë shënim. Ajo nuk ka ngritur pretendime për veprimet e OPGJ-ve as kur është pyetur në datën 2.5.2023 në ambientet e prokurorisë.

16.7. Nëse do të ishte ushtruar kontroll, do të ishin sekuestruar edhe një tërësi sendesh të tjera që u gjetën dhe u sekuestruan vetëm gjatë kontrollit të muajit tetor 2023. Pretendimi se në procesverbal është shënuar "sendet/dokumentet e gjetura apo të dorëzuara" nuk vërteton se është ushtruar kontroll, pasi përveçse fjalët janë vendosur si alternativë, gjetja dhe dorëzimi i tyre është bërë nga përfaqësuesja A.P. e kërkueses dhe OPGJ-të i kanë marrë në dorëzim prej saj. Procedura e ndjekur është kontrolluar nga gjykatat, të cilat, gjithashtu, kanë vlerësuar se nuk ndodheshin përpara një kontrolli të zyrës së kërkueses.

16.8. Në vijim të hetimeve pajisjet e sekuestruara i janë nënshtruar ekspertimit teknik-kompjuterik nga sektori i ekspertizës pranë Prokurorisë së Posaçme. Të gjitha dokumentet e ruajtura dhe të rikuperuara nga memoriet e tyre i janë vënë në dispozicion organit procedues në format të lexueshëm dhe kopje bruto. Imazhet dhe kopjet e raporteve të të dhënave të nxjerra ruhen në pajisje ruajtëse që nuk janë të lidhura në internet dhe në to kanë akses vetëm ekspertët përkatës. Ekspertimi bazohet në përcaktime të qarta ligjore për kompetencën e ekspertëve dhe në standarde të larta teknike ndërkombëtarisht të njohura për programet e përdorura. Po ashtu, është kryer edhe këqyrja e të dhënave, duke u bërë kërkimi me fjalë kyçe, vetëm për të dhënat që lidhen me procedimin penal dhe kjo është dokumentuar në procesverbal. Për materialet në format "pdf" ose të skanuara, mundësia e vetme për verifikimin e të dhënave është kontrolli manual, por duke dokumentuar në procesverbalin e këqyrjes vetëm ato të dhëna që kanë lidhje me faktet objekt hetimi dhe që i shërbejnë sqarimit të rrethanave objekt hetimi.

16.9. Duke qenë se kërkuesja ka pasur pretendime se pajisjet e sekuestruara mbanin edhe dokumente të klientëve të tjerë, me qëllim mospengimin e punës së saj, me urdhrat e datave 18.5.2023 dhe 7.6.2023, pra brenda një periudhe relativisht të shkurtër pas sekuestrimit, është vendosur kthimi i 3 pajisjeve, pasi janë administruar të dhënat që lidhen me hetimin. Ato janë mbajtur për një kohë të shkurtër, aq sa ka qenë e nevojshme për ekspertimin dhe këqyrjen e tyre. Pajisja tjetër është mbajtur për nevoja të hetimit dhe në vijim është dërguar si provë materiale në gjykatë, e cila do të vendosë në lidhje me të.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

17. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Për sa i takon legjitimimit *ratione personae,* Gjykata ka pohuar se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, individi mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me të drejtat themelore të tij, duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 21, datë 22.4.2025; nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të tyre dhe me thelbin e këtyre të drejtave e lirive.

19. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesja, në cilësinë e personit juridik, ka kundërshtuar vendimin e sekuestrimit për qëllime provuese të prokurorëve dhe mënyrën e zbatimit të tij nga OPGJ-të, sikundër edhe vendimet gjyqësore që kanë rrëzuar ankimin e saj, me pretendimin se ato akte dhe veprime kanë ndërhyrë drejtpërdrejt në të drejtat e saj themelore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesja justifikon interesin në çështjen e parashtruar, ndaj legjitimohet *ratione personae*.

20. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet për ato vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të të drejtave. Ky rregull, në thelb, synon t'u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të zakonshme mundësinë e parandalimit ose korrigjimit në substancë të shkeljeve të të drejtave kushtetuese të individit *(shih vendimet nr. 21, datë 22.4.2025; nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimet e kundërshtuara gjyqësore dhe të prokurorisë, që janë shprehur për kontrollin dhe sekuestrimin, nuk kanë vendosur për themelin e akuzave, por janë vendime të ndërmjetme të procedimit penal në funksion të mbledhjes së provave për faktin penal. Në jurisprudencën kushtetuese vendimet e ndërmjetme të sekuestros, të dhëna gjatë hetimeve paraprake, i janë nënshtruar kontrollit kushtetues, edhe pse gjykimi i themelit të fajësisë ende nuk kishte përfunduar, duke u konsideruar si vendime përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për këto lloj vendimesh, Gjykata është shprehur se ndonëse me karakter të përkohshëm dhe nuk vendosin për themelin e çështjes, ato ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale, ndaj konsiderohen me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues *(shih vendimet nr. 21, datë 22.4.2025; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese).* Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se vendimet objekt kërkese e përmbushin këtë kriter.

22. Në lidhje me këtë kriter të legjitimimit, për sa u përket pretendimeve të kërkueses për cenimin e paprekshmërisë së banesës për shkak të kontrollit të pretenduar të zyrës, Gjykata mban në konsideratë edhe qëndrimin e saj për kontrollin kushtetues të pretendimeve për cenimin e të drejtave substanciale për shkak të kontrollit personal ose të vendeve. Sipas këtij qëndrimi, referuar parashikimeve aktuale ligjore, kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrohen nga individi në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual. Po kështu, për sa kohë që kriteri i shterimit të mjeteve juridike kërkon edhe që të gjitha pretendimet që ngrihen në këtë Gjykatë të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata ndalet edhe në verifikimin e pretendimeve të kërkueses në këtë aspekt.

23. Gjykata vëren se kërkuesja, në aspektin formal, i është drejtuar asaj me ankim kushtetues, pasi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit përpara gjykatave të zakonshme të të tria shkallëve të gjykimit. Për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për jetë private në këndvështrim të neneve 22, 23, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së. Në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës, që garanton lirinë e shprehjes, nuk rezulton që

kërkuesja të ketë ngritur më parë pretendime në ankimet drejtuar gjykatave të zakonshme, në formë ose në përmbajtje, duke mos parashtruar, në asnjë rast, argumente dhe as ka bërë ndonjë referim specifik në këtë dispozitë kushtetuese. Ajo i ka mbështetur pretendimet e saj përpara gjykatave të zakonshme në nenin 8 të KEDNJ-së, por duke mos pretenduar dhe argumentuar se kjo dispozitë mbron edhe lirinë e shprehjes. Për rrjedhojë, për pretendimin për cenimin e lirisë së shprehjes kërkuesja nuk ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit.

24. Edhe në lidhje me nenin 23 të Kushtetutës, që garanton të drejtën e informimit, Gjykata vëren se kërkuesja nuk rezulton të ketë ngritur më parë pretendime në ankimet drejtuar gjykatave të zakonshme. Megjithatë, ndërsa pretendon se OPGJ-të kanë ushtruar kontroll të zyrës pa praninë e një personi të besuar, siç mund të ishin avokatët që kanë njohuri të posaçme, duket se kërkuesja, në thelb, pretendon mungesën e informimit nga ana e OPGJ-ve për të drejtat e saj në procedurën që ata po ndiqnin. Për rrjedhojë, argumentet e kërkueses kanë të bëjnë me pretendimin për paprekshmërinë e banesës, ndaj do të trajtohen në kuadër të këtij pretendimi.

25. Në ankimin kushtetues individual është pretenduar edhe cenimi i nenit 36 të Kushtetutës, në lidhje me lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës dhe të mjeteve të komunikimit. Në ankimet përpara gjykatave të zakonshme, ndonëse nuk ka një referim specifik në këtë dispozitë kushtetuese, kërkuesja ka ngritur pretendime në lidhje me masën e sekuestros edhe për sa u përket të dhënave dhe informacioneve konfidenciale të klientëve të tjerë të saj (të ndryshëm nga shoqëria "H." sh.p.k.), ashtu edhe të dhënave që, sipas saj, përbëjnë sekret profesional ose tregtar. Për rrjedhojë, vlerësohet se kërkuesja i ka shteruar mjetet juridike të zakonshme për pretendimin për cenimin e lirisë së korrespondencës dhe të mjeteve të komunikimit.

26. Gjykata vëren, gjithashtu, se në ankimin kushtetues individual kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e nenit 41 të Kushtetutës, për të drejtën e pronës private. Në ankimet përpara gjykatave të zakonshme ajo ka një referim specifik në këtë dispozitë kushtetuese dhe ka ngritur pretendime në lidhje me masën e sekuestros dhe në veçanti ndaj pajisjeve kompjuterike, duke parashtruar edhe disa argumente në këtë drejtim. Për rrjedhojë, vlerësohet se kërkuesja i ka shteruar mjetet juridike të zakonshme për këtë pretendim.

27. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 8.2.2024, i cili, bazuar në informacionin e dërguar nga ajo gjykatë për nevoja të këtij shqyrtimi, është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 23.4.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 20.6.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

28. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, të së drejtës së aksesit, të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të parimit të sigurisë juridike, sipas nenit 42 të Kushtetutës, cenimin e lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe së drejtës për paprekshmërinë e banesës, sipas neneve 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, si dhe të së drejtës së pronës private, sipas nenit 41 të Kushtetutës, pretendime këto që janë me natyrë kushtetuese.

29. Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, me argumentin se gjyqtarja I.Gj., që ka dhënë vendimin në shkallë të parë, ka qenë në kushtet e mbarimit të mandatit të magjistratit, në kuptim të nenit 6/1 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 96/2016, pasi nuk kishte deklaruar në formularin përkatës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 138/2015, dënimin e saj me vendim penal të huaj (të shtetit grek). Sipas kërkueses, edhe pse këto të dhëna janë bërë publike në vitin 2024, ajo ka siguruar kopje të vendimit të shtetit grek vetëm në muajin maj të vitit 2025, pas riçeljes së seancës plenare nga Gjykata.

30. Gjykata konstaton se një pretendim i tillë nuk është ngritur nga kërkuesja në ankimin kushtetues, por vetëm në parashtrimet e datës 12.5.2025, pasi çështja kishte kaluar për shqyrtim në seancë plenare dhe, për më tepër, pas riçeljes së saj për arsye të tjera të gjykimit kushtetues. Në këto kushte, për këtë pretendim, lind pyetja nëse ai është ngritur brenda afatit ligjor. Megjithatë, Gjykata nuk do të ndalet në këtë çështje, pasi konsideron se ky pretendim është gjithsesi haptazi

i pabazuar *ratione materiae*. Konkretisht, çështja që ngrihet nga kërkuesja ka të bëjë me faktin se gjyqtarja I.Gj. ka qenë në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit për shkak të ligjit, ndaj ushtrimi i tij në rastin konkret ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Megjithatë, sikurse pranohet edhe nga vetë kërkuesja, nuk ka ndonjë akt të organit publik të ngarkuar nga ligji që të ketë vendosur për ndalimin e ushtrimit të funksionit nga ajo gjyqtare për shkakun e pretenduar nga kërkuesja ose për ndonjë shkak tjetër ligjor. Në këtë kuptim, gjyqtarja në fjalë, ndërsa ka qenë në detyrë, ka vepruar në kushte legjitimiteti në ushtrimin e funksioneve në rastin konkret dhe, për pasojë, pretendimi i kërkueses është qartazi pa bazë ligjore.

31. Për sa i takon pretendimit për cenimin e lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe mjeteve të komunikimit, sipas nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, edhe në ankimin kushtetues individual kërkuesja e ka argumentuar me natyrën personale, konfidenciale dhe sekretin profesional ose tregtar të të dhënave që ndodheshin në pajisjet kompjuterike të sekuestruara. Në lidhje me këtë pretendim, kërkuesja ka kundërshtuar pranë gjykatave të zakonshme masën e sekuestrimit, duke argumentuar se është shkelur neni 208/a i KPP-së, pasi ndonëse bëhej fjalë për të dhëna ose sisteme kompjuterike, sekuestrimi nuk është vendosur me vendim gjyqësor. Gjykata vëren se kërkuesja ka dijeni të plotë për informacionin që pajisjet e sekuestruara përmbajnë dhe po ashtu, është njohur mjaftueshëm për veprimet e kryera nga organi i ndjekjes penale. Megjithatë, ajo nuk ka parashtruar ndonjë argument faktik ose ligjor se cila konkretisht është korrespondenca apo e dhëna profesionale në pajisjet e sekuestruara dhe se cili është veprimi konkret i prokurorit ose policisë gjyqësore që ka prekur të dhënat e ruajtura nga sekreti profesional. Në këtë kuptim, pretendimi i saj ka mbetur vetëm një deklaratë me natyrë të përgjithshme, sipas së cilës sekuestrimi i katër kompjuterëve përbën ndërhyrje në korrespondencën, të dhënat personale dhe sekretet tregtare të saj. Në këto rrethana, Gjykata çmon se fakti i sekuestrimit të 4 kompjuterëve, të cilët për nga natyra nuk janë domosdoshmërisht mjete komunikimi, nuk mjafton për të prezumuar se ka pasur ndërhyrje në lirinë e korrespondencës së kërkueses, sipas neneve 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, në kushtet kur ajo nuk ka argumentuar dhe as ka arritur të provojë se në ato pajisje ruheshin komunikime që përfshihen në konceptin e korrespondencës, fshehtësia e të cilave të jetë prekur. Për rrjedhojë, vetëm ngritja e pretendimit për cenimin e së drejtës substanciale, pa e arsyetuar dhe argumentuar në terma konkretë dhe ligjorë, e bëjnë atë haptazi të pabazuar.

32. Për sa i përket së drejtës së pronës private, Gjykata vëren se kërkuesja i ka ngritur pretendimet, në thelb, në drejtim të të dhënave, dokumenteve dhe programeve që pajisjet kompjuterike të sekuestruara përmbajnë, të cilat i shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë e saj. Vetë kërkuesja, qoftë përpara gjykatave të zakonshme, ashtu dhe në ankimin kushtetues, ka parashtruar se për këtë shkak mund të ishte evituar sekuestrimi i pajisjeve kompjuterike, duke u disponuar vetëm kopjimi i të dhënave të nevojshme, ndërsa nga sekuestrimi i pajisjeve ajo është dëmtuar në veprimtarinë e saj. Për rrjedhojë, Gjykata, bazuar në parimin *iura novit curia,* duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e këtij pretendimi, vlerëson ta shqyrtojë atë në themel në këndvështrim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, e cila përmban në vetvete edhe të drejtën e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende *(shih vendimet nr. 29, datë 2.7.2021; nr. 33, datë 8.6.2016; nr. 14, datë 21.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese).*

33. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkueses, Gjykata vëren se ato kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e ndërhyrjes në ambientet ku kërkuesja, person juridik, ushtron veprimtarinë e saj në fushën e konsulencës dhe shërbimeve financiare, ekonomike. Për rrjedhojë, Gjykata duhet të vlerësojë fillimisht nëse kërkuesja mund të pretendojë cenimin e së drejtës së paprekshmërisë së banesës në kuptim të nenit 37 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të KEDNJ-së, pra nëse zyra e saj përfshihet në nocionin e banesës ose mjedisit të njësuar me të, ndaj të cilave shtrihet mbrojta e ofruar nga dispozitat kushtetuese dhe konventore.

34. Në lidhje me të drejtën për jetë private, Gjykata ka vlerësuar se ajo nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës, por nga disa prej tyre, ku përfshihet edhe neni 37, që bën fjalë për

paprekshmërinë e banesës (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 52, datë 1.12.2011; nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas kësaj dispozite, paprekshmëria e banesës është e garantuar (pika 1) dhe kontrollet e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe mënyrat e parashikuara me ligj (pika 2). Ndërsa sipas nenit 8 të KEDNJ-së çdokush ka edhe të drejtën e respektimit të banesës dhe autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji, kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

35. Neni 37 i Kushtetutës përfshin në fushën e mbrojtjes së tij jo vetëm banesën e individit, por edhe çdo mjedis tjetër që është i tillë që të njësohet me të. Për sa i përket nocionit "banesë" sipas GJEDNJ-së, ai është një koncept autonom që nuk varet nga klasifikimi sipas ligjit të brendshëm dhe ky përcaktim varet nga rrethanat faktike, përkatësisht nga ekzistenca e lidhjeve të mjaftueshme dhe të vazhdueshme me një vend specifik *(shih Winterstein dhe të tjerë kundër Francës, datë 17.10.2013, § 141; Prokopovich kundër Rusisë, datë 8.1.2004, § 36; McKay-Kopecka kundër Polonisë, datë 19.9.2006).* Ky përkufizim nuk kufizohet vetëm në banesat tradicionale *(shih Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 19.1.2001, §§ 71–74*), por mbulon dhe mund të shtrihet edhe në ambiente biznesi, siç është edhe zyra ku ushtron profesionin personi *(shih Niemietz kundër Gjermanisë, datë 16.12.1992, § 30),* duke përfshirë selinë e regjistruar të një shoqërie të drejtuar nga një individ privat (*shih Buck kundër Gjermanisë, datë 28.4.2005, § 31),* ashtu edhe atë të një personi juridik, degëve të tij dhe ambienteve të tjera të biznesit *(shih Société Colas Est dhe të tjerë kundër Francës, datë 16.4.2002, § 41; Sallinen dhe të tjerë kundër Finlandës, datë 27.9.2005, § 70; Bernh Larsen Holding AS dhe të tjerë kundër Norvegjisë, datë 14.3.2013, § 104).*

36. Për sa më lart, Gjykata çmon se selia/zyra e kërkueses, person juridik, ku ajo ushtron veprimtarinë e saj profesionale, përbën mjedis të njësuar me banesën në kuptim të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, ndaj paprekshmëria e saj është e garantuar.

37. Për sa u përket pretendimeve të kërkueses në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, Gjykata ka theksuar se në rastin përjashtimor të kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar, ndaj, në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, ajo niset nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për sa kohë që në bazë të parimit të subsidiaritetit u takon atyre gjykatave që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit, duke qenë kjo Gjykatë mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për rrjedhojë, për sa kohë që pretendimet në drejtim të së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit, në thelb, kanë të bëjnë me përcaktimin e fakteve dhe me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të dispozitave që përcaktojnë rregullat për kontrollin e vendit apo të banesës, me qëllim sekuestrimin e provave materiale, çka sipas kërkueses, vë në dyshim ligjshmërinë, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e veprimeve dhe masave të marra nga autoritetet e ndjekjes penale dhe vlerësimin e gjykatave të zakonshme në këtë drejtim, ato do të shqyrtohen në këndvështrim të respektimit të kritereve kushtetuese të ndërhyrjes në të drejtën substanciale të paprekshmërisë së banesës. Gjykata, referuar natyrës dhe thelbit të këtyre pretendimeve të kërkueses, për sa kohë që ato kanë të bëjnë me njërin nga aspektet e së drejtës për jetë private, atë për paprekshmërinë e banesës, vlerëson t'i trajtojë në vijim, në themel,

në këndvështrim të së drejtës së garantuar nga neni 37 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së.

39. Thënë sa më sipër, Gjykata do të ndalet në vijim në shqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkueses për të drejtën për paprekshmërinë e banesës, në këndvështrim të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së dhe për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, në këndvështrim të nenit 11 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për të drejtën e paprekshmërisë së banesës

40. Sipas kërkueses, zyra e saj është kontrolluar nga OPGJ-të dhe janë sekuestruar një sasi dokumentesh dhe disa pajisje kompjuterike. Sipas saj, OPGJ-të sapo kanë hyrë në zyrë kanë urdhëruar që asnjë punonjës të mos lëvizte nga vendi i punës, kanë kontrolluar të gjithë kompjuterët e zyrës, dollapët dhe sirtarët bazuar në bindjen e tyre, duke sekuestruar pajisjet kompjuterike dhe dokumentet e përshkruara në procesverbalin e sekuestrimit. Vendimi i sekuestrimit, vijon ajo, ishte i paqartë, pasi nuk kishte të specifikuara sendet që duhet të sekuestroheshin, ndaj OPGJ-të praktikisht kanë kryer kontroll të hollësishëm të zyrës pa vendim gjyqësor, siç përcaktohet në nenin 202 të KPP-së, duke cenuar nenin 37 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së. Bazuar në nenin 208 të KPP-së, në vendimin e sekuestrimit duhet të specifikohen sendet dhe dokumentet që duhet të sekuestrohen, për të shmangur kontrollin e paautorizuar, ndërkohë që në rastin konkret ato nuk janë specifikuar dhe prokurorët shprehen edhe për "*çdo gjë tjetër që vlerësohet me rëndësi mbi faktin objekt hetimi*". Në këtë kuptim, sipas kërkueses, prokurorët nuk kanë nënkuptuar një dorëzim vullnetar. Kështu, për përfaqësuesen A.P. të kërkueses ka qenë e pamundur të vlerësonte se cilat ishin "dokumentet e tjera që kishin rëndësi mbi faktin objekt hetimi", në mënyrë që t'i dorëzonte ato vullnetarisht, pa u kryer kontroll. Po sipas kërkueses, edhe sipas procesverbalit të sekuestrimit kuptohet qartësisht se është kryer kontroll dhe shumë sende e dokumente janë marrë kundër vullnetit të A.P., për sa kohë në të shënohet "*sendet/dokumentet e gjetura apo të dorëzuara* ...", duke pranuar vetë OPGJ-të se një pjesë e tyre janë të gjetura, pra jo të dorëzuara. Edhe fakti i sekuestrimit jo vetëm të një kompjuteri, sipas vendimit të sekuestrimit, por katër të tillëve, tregon se ka pasur kontroll të zyrës. Po ashtu, nëse nuk do të ishte kryer kontroll, nuk do të kishte pasur dorëzim vullnetar edhe të kompjuterit ku mbahej kontabiliteti i një prej operatorëve më të mëdhenj në vend, pajisje kjo që për më tepër nuk ishte as në pronësi të saj. Fakti që nuk ka pasur vërejtje në procesverbalin e sekuestrimit, nuk do të thotë se nuk ka shkelje në kontrollin e zyrës, ndërkohë që ajo ka paraqitur ankim ndaj kësaj procedure.

41. Po sipas kërkueses, ndërhyrja në të drejtën e paprekshmërisë së banesës nuk respekton kriteret e nenit 17 të Kushtetutës dhe ato të jurisprudencës së GJEDNJ-së. Ndërhyrja përmes kontrollit dhe sekuestrimit në vijim nuk ka qenë as e ligjshme, as e domosdoshme dhe proporcionale. Kontrolli është kryer pa vendim të gjykatës, në shkelje të nenit 202 të KPP-së. Nuk qëndron pretendimi për kryerjen në kushte urgjence, pasi shtetasit F.B. i janë marrë disa herë deklarime. Për më tepër, dinamika e hetimit nuk tregon se ka pasur ndonjë urgjencë që bënte të pamundur marrjen e një vendimi kontrolli nga gjykata, sepse procedimi penal është regjistruar në datën 1.12.2020, pra më shumë se 2 vjet përpara. Sipas kërkueses, edhe në rastet e urgjencës, dispozitat procedurale kërkojnë verifikimin gjyqësor të kushteve të saj, çka nuk ka ndodhur në rastin konkret, ndërsa kontrolli nga gjykatat i procedurës së ndjekur nuk ka qenë efektiv, për sa kohë ato nuk kanë shqyrtuar dhe nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve për ligjshmërinë, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masës. Gjatë kontrollit janë sekuestruar edhe 3 pajisje kompjuterike që nuk kanë qenë objekt i vendimit të sekuestrimit dhe nuk kanë lidhje me hetimin, si dhe disa dokumente që nuk kanë lidhje me objektin e tij. Po ashtu, sipas kërkueses, kontrolli është kryer pa u thirrur një person i besuar, siç mund të ishin avokatët që kanë njohuri të posaçme, sipas nenit 205 të KPP-së.

42. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, pretendimi se në rastin konkret është ushtruar kontroll është i pabazuar dhe ai ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e zakonshme, sipas të cilave nuk ka pasur kontroll të zyrës së kërkueses. Në vendimin e sekuestrimit nuk mund të evidentohej se çfarë do të provohej nga sendet dhe dokumentet objekt sekuestrimi, për sa kohë të dhënat e hetimit paraprak mbulohen nga sekreti hetimor. Po ashtu, fakti se nuk është bërë një listë

e dokumenteve që duhet të sekuestroheshin, nuk tregon se OPGJ-ve u është kërkuar të ushtrojnë kontroll dhe as se ata kanë kryer një të tillë, pasi lista në çdo rast do të përfundonte me fjalën "e të tjera", për shkak të pafundësisë së llojeve të akteve që kërkuesja mund të dispononte dhe për sa kohë që hetimi shtrihej në ngjarje ndër vite, ku implikoheshin shumë persona. Ky subjekt ka prapësuar se prokurorët janë shprehur për sekuestrimin edhe të çdo sendi që vlerësohej me rëndësi për hetimin dhe që ofronte të dhëna për faktin objekt hetimi, duke mos abuzuar aspak me të drejtën për vlerësimin e domosdoshmërisë, por duke ia deleguar OPGJ-ve sekuestrimin e këtyre sendeve, në respektim të nenit 208 të KPP-së. Sipas këtij subjekti, sekuestrimi është urdhëruar në kushte urgjence, pas marrjes së deklarimit të shtetasit F.B. se të gjitha dokumentet e shoqërisë "H." sh.p.k. gjendeshin në zyrën e kërkueses dhe pasi është vlerësuar se në rast vonese ai mund të lajmëronte bashkëpunëtorët e tij për të manipuluar ose zhdukur provat që do të hidhnin dritë mbi ngjarjen dhe autorët. Në zbatim të vendimit të sekuestrimit, OPGJ-të janë paraqitur menjëherë pranë zyrës së kërkueses, ku kanë kontaktuar recepsionisten që ka kërkuar të mos kryhej asnjë veprim derisa të vinte përfaqësuesja A.P. dhe pas ardhjes së saj, pasi i është vënë në dispozicion vendimi i sekuestrimit, ajo është treguar bashkëpunuese, jo vetëm duke krijuar lehtësitë e nevojshme përmes vënies në dispozicion të sendeve/dokumenteve të kërkuara, madje edhe të një kompjuteri për mbajtjen e procesverbalit të sekuestrimit, por edhe duke vënë në dispozicion dokumentet e kërkuara, ndërsa për pajisjet kompjuterike ka shprehur shqetësimin se sekuestrimi do të ndikonte në punën e përditshme, shqetësim që është marrë parasysh, duke u marrë vetëm ato pajisje të identifikuara nga vetë A.P. si pajisje ku ndodheshin dokumente që lidheshin me shoqërinë "H." sh.p.k. Sipas subjektit të interesuar, në procesverbalin e sekuestrimit janë përshkruar hollësisht të gjitha sendet/dokumentet e sekuestruara dhe një kopje e tij i është dhënë përfaqësues A.P. të kërkueses, e cila nuk ka pasur pretendime dhe nuk ka bërë ndonjë shënim. Edhe kur është pyetur në datën 2.5.2023, përfaqësuesja A.P. e kërkueses nuk ka ngritur pretendime për veprimet e kryera gjatë sekuestrimit. Nëse do të ishte ushtruar kontroll, vijon subjekti i interesuar, atëherë do të ishin sekuestruar edhe një tërësi sendesh të tjera, të cilat u gjetën dhe u sekuestruan vetëm gjatë kontrollit të muajit tetor 2023. Shënimi në procesverbalin e sekuestrimit "*sendet/dokumentet e gjetura apo të dorëzuara*" nuk vërteton se është ushtruar kontroll, pasi përveçse fjalët janë vendosur si alternativë, gjetja dhe dorëzimi i tyre është bërë nga vetë përfaqësuesja A.P. e kërkueses.

43. Po sipas subjektit të interesuar, në rastin konkret janë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore procedurale penale, pasi sekuestrimi është urdhëruar në kuadrin e një procedimi penal, të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, ndërsa ka ekzistuar një dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e kësaj vepre penale, ka ekzistuar situata e urgjencës dhe rëndësisë që paraqisnin provat për të cilat është proceduar me sekuestrimin. Po ashtu, sekuestrimi është bërë për një qëllim të ligjshëm dhe është garantuar proporcionaliteti mes rëndësisë së veprës, interesit publik dhe interesit të kërkueses. Sipas subjektit të interesuar, në pajisjet e sekuestruara, ndryshe nga sa kërkuesja pretendon, kanë rezultuar dokumente që kanë të bëjnë me shoqërinë "H." sh.p.k., por se çfarë konkretisht provohet, evidentohet vetëm pas marrjes së provës dhe shqyrtimit të saj, ekspertimit dhe këqyrjes të të dhënave, në ndërthurje edhe me prova të tjera.

44. Gjykata vëren se sipas nenit 37 të Kushtetutës, paprekshmëria e banesës është e garantuar (pika 1) dhe kontrollet e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj (pika 2). Gjykata vëren, po ashtu, se sipas GJEDNJ-së, objekti i nenit 8 të KEDNJ-së është në thelb mbrojtja e individit nga ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike *(shih Lozovyye kundër Rusisë, datë 24.4.2018, § 36).* E drejta për respektimin e banesës kuptohet jo vetëm si e drejtë për hapësirën aktuale fizike, por edhe për gëzimin e qetë të kësaj hapësire (*shih Giacomelli kundër Italisë, datë 2.11.2006, § 76; Halabi kundër Francës, datë 16.5.2019, § 54).*

45. Gjykata vlerëson se garancia kushtetuese e paprekshmërisë së banesës, sipas nenit 37, pika 1, të Kushtetutës, i garanton individit një hapësirë themelore jetese në lidhje me dinjitetin e tij njerëzor dhe në interes të zhvillimit të lirë të

personalitetit të tij, duke pasur të drejtën të lihet i qetë në hapësirën e tij të jetesës. Kontrollet e banesës dhe të mjediseve që njësohen me të, që bën fjalë pika 2 e kësaj dispozite, përbëjnë një ndërhyrje serioze në këtë sferë personale thelbësisht të mbrojtur. Megjithatë, ndryshe nga sa ka përcaktuar për kontrollin vetjak (personal) në pikën 3 të dispozitës, kushtetutëbërësi për kontrollet e banesës dhe të mjediseve që njësohen me të nuk ka përcaktuar garancitë minimale, kriteret për kufizimin e kësaj të drejte (rastet, autoritetin publik kompetent, proporcionalitetin). Gjithsesi, kjo nuk duhet kuptuar se pesha dhe rëndësia kushtetuese e mbrojtjes së hapësirës private të individit është më e pakët, pasi vetë norma kushtetuese, për garantimin e kësaj të drejte kushtetuese dhe për të siguruar sundimin e së drejtës dhe mënjanimin e arbitraritetit, kërkon që kontrollet të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj. Arsyet që kanë çuar kushtetutëbërësin në delegimin për ligjvënësin e zakonshëm të rregullimit të kontrolleve të banesës dhe të mjediseve duket se kanë të bëjnë me faktin se në praktikë fushat e ndërhyrjes së shtetit në këtë të drejtë përmes kontrolleve të autoriteteve publike mund të jenë disa, në varësi të objektit të mbrojtjes dhe qëllimit të kontrollit, ndërkohë që ligjvënësi i zakonshëm ka mundësi të gjera njohjeje dhe vlerësimi, përveç edhe fleksibilitetin e nevojshëm, për të përcaktuar, modifikuar dhe përshtatur në vijimësi me praktikat më të mirat ndërkombëtare dhe, në veçanti, me jurisprudencën e GJEDNJ-së, rregullat konkrete procedurale në çdo fushë, për të garantuar në çdo rast një ekuilibër të drejtë mes kësaj të drejte kushtetuese dhe interesit publik.

46. Në kuptim të sa më sipër dhe duke mbajtur parasysh qëndrimet diametralisht të kundërta të palëve për mënyrën sesi u sekuestruan sendet në zyrën e kërkueses (me kontroll apo dorëzim vullnetar), Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, do të shqyrtojë fillimisht nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e saj për paprekshmërinë e zyrës në formën e kontrollit dhe nëse po, në vijim do të shqyrtojë nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar, pra nëse ajo ka qenë në përputhje me ligjin, nëse ka ndjekur një qëllim të ligjshëm dhe nëse ka qenë proporcionale, domethënë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

a) Nëse ka pasur ndërhyrje

47. Gjykata vëren se kërkuesja pretendon se ka pasur kontroll të zyrës së saj nga OPGJ-të dhe sekuestrim nga ata në vijim të disa dokumenteve dhe pajisjeve kompjuterike në zbatim të vendimit të sekuestrimit të prokurorëve, në kuadër të një hetimi penal që po zhvillohej. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar pranon se në zbatim të një mase sekuestrimi (provues) të ndërmarrë në kuadër të hetimit penal që zhvillohej, OPGJ-të janë futur në zyrën e kërkueses, me lejen e saj, por mohon që ata të kenë ushtruar kontroll të zyrës. Ai pranon se OPGJ-të kanë kryer sekuestrim të dokumenteve dhe pajisjeve kompjuterike sipas urdhrit të sekuestrimit të prokurorëve, por kërkimi, gjetja dhe dorëzimi i tyre është bërë nga vetë kërkuesja, përfaqësuesja e saj A.P., e cila nuk ka paraqitur asnjë vërejtje ose kundërshtim në procesverbalin ku janë dokumentuar veprimet e OPGJ-ve.

48. Gjykata vëren se sipas GJEDNJ-së si shembuj të "ndërhyrjes" së mundshme në të drejtën për respektimin e banesës janë: hyrja e policisë në shtëpinë e një personi *(shih Gutsanovi kundër Bullgarisë, datë 15.10.2013, § 217; Sabani kundër Belgjikës, datë 8.3.2022, § 41)* dhe kontrolli *(shih Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 18.1.1994, § 86)*, edhe kur aplikanti ka bashkëpunuar deri në atë masë sa i ka hapur derën policisë, e cila nuk kishte njoftuar paraprakisht, sepse heqja dorë nga e drejta themelore për mbrojtjen e banesës mund të bëhet vetëm pa detyrim dhe në bazë të pëlqimit të qartë dhe të informuar *(shih Sabani kundër Belgjikës, datë 8.3.2022, § 46);* kontrollet dhe sekuestrimet *(shih Chappell kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 30.3.1989, §§ 50–51; Funke kundër Francës, datë 25.2.1993, § 48),* edhe kur aplikanti ka bashkëpunuar me policinë *(shih Saint-Paul Luxembourg S.A. kundër Luksemburgut, datë 18.4.2013, § 38*) dhe kur vepra penale që ka çuar në kontroll është kryer nga një palë e tretë *(shih Buck kundër Gjermanisë, datë 28.4.2005)* dhe, në përgjithësi, çdo masë, nëse nuk është e ndryshme në mënyrën e ekzekutimit dhe efektet e saj praktike nga një kontroll, pavarësisht nga karakterizimi i tij sipas ligjit të brendshëm *(shih Belousov kundër Ukrainës, datë 7.11.2013, § 103; Kruglov dhe të tjerë kundër Rusisë, datë 4.2.2020, § 123);* vizitat në shtëpitë e zyrtarëve publikë pa leje,

edhe kur nuk kryhet asnjë kontroll dhe as nuk sekuestrohen dokumente ose sende të tjera *(shih Halabi kundër Francës, datë 16.5.2019, §§ 54–56)*. Po sipas GJEDNJ-së, shpërndarja e barrës së provës dhe niveli i bindjes së nevojshme për të arritur në një përfundim të caktuar janë të lidhura në mënyrë të pandashme me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit dhe të drejtën konventore në fjalë. Ndaj, në rastet kur qëndrimet e palëve për ngjarjet janë të ndryshme, Gjykata përcakton nëse kërkuesi ka paraqitur prova *prima facie* në mbështetje të versionit të tij dhe nëse është kështu, barra e provës duhet t'i kalojë qeverisë *(shih Fadeyeva kundër Rusisë, datë 9.6.2005, § 79; N.D. dhe N.T. kundër Spanjës, datë 13.2.2020, § 85; Sabani kundër Belgjikës, datë 8.3.2022, § 43)*.

49. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në procesin gjyqësor të zhvilluar mbi ankimin e kërkueses, në lidhje me pretendimin për ushtrim kontrolli të zyrës nga OPGJ-të, gjykatat e zakonshme kanë mbështetur qëndrimin e subjektit të interesuar, duke arritur në përfundimin se nuk ka pasur kontroll të zyrës së kërkueses dhe se OPGJ-të kanë kryer vetëm sekuestrim të dokumenteve dhe pajisjeve kompjuterike në zbatim të urdhrit të sekuestrimit të prokurorëve. Gjykatat, sikundër edhe kërkuesja dhe subjekti i interesuar, në lidhje me veprimet e kryera nga OPGJ-të, qëndrimet e tyre i kanë mbështetur në përmbajtjen e vendimit të sekuestrimit dhe të procesverbalit të sekuestrimit. Edhe gjatë gjykimit kushtetues, pavarësisht ftesës së Gjykatës, palët nuk paraqitën prova të tjera.

50. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 64, datë 1.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

51. Megjithatë, duke marrë shkas nga specifikat e rastit konkret, pretendimet e kërkueses dhe rëndësinë e së drejtës së pretenduar të shkelur, duke mbajtur në konsideratë edhe elaborimin nga GJEDNJ-ja të parimit të barrës së provës, Gjykata çmon se është i pashmangshëm vlerësimi nga ajo i respektimit nga gjykatat e zakonshme të këtij parimi në rastin konkret, për sa kohë përcaktimet e faktit determinojnë përfundimet mbi ekzistencën e ndërhyrjes në të drejtën kushtetuese të paprekshmërisë së banesës të pretenduar si të shkelur nga kërkuesja.

52. Gjykata vëren se ndërhyrja e pretenduar nga kërkuesja ka ndodhur në kuadër të një procedimi penal të regjistruar në dhjetor të vitit 2020. Ky procedim, në kohën e ndodhjes së fakteve, në datën 28.4.2023, ka qenë i regjistruar për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i KP-së. Si të dyshuar për këtë vepër penale, megjithëse ende të paregjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, kanë qenë shoqëria e ndërtimit "H." sh.p.k. dhe ortakët e saj, për të cilët kërkuesja, prej disa vitesh, ka ofruar shërbime konsulence financiare përfshirë, në veçanti, edhe në lidhje me aktivitetin e shoqërisë në ndërtimet e zhvilluara në pronën që ishte objekt hetimi penal. Megjithatë, në atë kohë, as kërkuesja, as administratorja dhe as ndonjë punonjës tjetër i saj, nuk kanë qenë të dyshuar për kryerjen e veprës penale të regjistruar ose të ndonjë vepre tjetër penale.

53. Gjatë hetimit të procedimit penal, mesditën e datës 28.4.2023, prokurorët kanë marrë në pyetje një nga ortakët dhe njëherazi administratorin e shoqërisë "H." sh.p.k., shtetasin F.B. Në deklarimet e tij, ndër të tjera, në lidhje me dokumentet e shoqërisë për aktivitetin e ndërtimit në pronën që ishte objekt hetimi, ai ka pohuar se ato gjendeshin në zyrën e kërkueses, kurse për disa pyetje specifike të prokurorëve në lidhje me ortakërinë, investimet dhe ndarjen e dividentit, ai ka kërkuar dhënien e një kohe të nevojshme për t'u konsultuar me ato dokumente. Pas përfundimit të pyetjes së këtij shtetasi, prokurorët kanë përpiluar vendimin e sekuestrimit të sendeve/dokumenteve. Në këtë vendim përshkruhet se në kuadër të veprimeve hetimore

për procedimin penal në fjalë, lind e nevojshme të sekuestrohen pranë zyrës së A.P. të gjitha dokumentet që kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., kompjuteri në të cilin mbaheshin të dhënat e kësaj shoqërie, si dhe çdo gjë tjetër që vlerësohet me rëndësi për hetimin dhe që ofron të dhëna mbi faktin objekt hetimi. Mbi këtë bazë, mbështetur në nenet 208 e vijuese të KPP-së, prokurorët kanë urdhëruar sekuestrimin e sendeve/dokumenteve si më lart, duke ngarkuar për zbatimin e vendimit tre OPGJ të cilët, përveç dokumentimit me procesverbal të sekuestrimit, janë urdhëruar të njihnin personat e interesuar me atë vendim, ndaj të cilit lejohej ankim sipas ligjit. Megjithatë, në vendim, përveç të dhënës identifikuese *"që kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k",* nuk tregohet që përfaqësueses së kërkueses i është dhënë ndonjë informacion për faktet objekt hetimi apo për të dhënat që kishin rëndësi për hetimin, në mënyrë që ajo të kishte mundësi të identifikonte sendet dhe dokumentet që përmbanin ato të dhëna dhe për të cilat urdhërohej sekuestrimi, por edhe për t'i dorëzuar ato vullnetarisht.

54. Megjithëse në vendimin e sekuestrimit nuk tregohet koha kur kjo masë duhej të zbatohej, referuar procesverbalit të sekuestrimit del se ajo është zbatuar menjëherë. Sipas procesverbalit të hartuar në 15 faqe, në fillim të tij pasqyrohet momenti i përpilimit, pikërisht në datën 28.4.2023, ora 15:30. Në vijim, përshkruhet se ai mbahet në bazë të "*neneve 300 dhe 301 të KPP-së*", për sekuestrimin e dokumenteve "*të gjetura*" në zbatim të vendimit të prokurorëve të datës 28.4.2023, në funksion të hetimeve që zhvillohen në kuadër të procedimit penal nr. 287/2020 dhe, më pas, përshkruhen *"sendet/dokumentet e gjetura (apo të dorëzuara) nga shtetasja A.P., pronare e vetme e subjektit tregtar "Studio Pustina" sh.p.k...."*. Në procesverbal, në mënyrë të detajuar, janë evidentuar 4 pajisje kompjuterike, 407 dokumente shkresore që lidhen me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe 4 dokumente shkresore të tjera (pasqyra financiare) që u përkasin subjekteve juridike të tjera, duke u evidentuar gjithashtu se 2 grupe dokumentesh shkresore (të përcaktuara konkretisht) gjendeshin në 2 dosje, ku në pjesën anësore të njërës shënohej "P. Parkimi 2010-2011", ndërsa në atë të tjetrës "H. Kontrata 2011".

55. Gjykata vëren, megjithatë, se në procesverbalin e sekuestrimit nuk ka ndonjë sqarim se përse OPGJ-të janë mbështetur në nenin 300 të KPP-së, që bën fjalë për veprimet me iniciativë të policisë gjyqësore në rastet e verifikimeve të ngutshme në vend, kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë. Po kështu, nuk tregohet që përfaqësueses A.P. të kërkueses t'i jetë dhënë ndonjë informacion, qoftë edhe në atë masë që nuk shkelte sekretin hetimor, në lidhje me faktet objekt hetimi ose për të dhënat që kishin rëndësi për hetimin, referuar të cilit ajo të mund të identifikonte dhe të dorëzonte ato dokumente, pajisje kompjuterike ose çdo gjë tjetër që përmbante të dhëna për shoqërinë "H.", me rëndësi për hetimin dhe mbi faktet objekt të tij. Nuk ka as ndonjë sqarim të mëtejshëm për sa përshkruhet për sendet/dokumentet "e gjetura (apo të dorëzuara)". Gjithashtu, nuk tregohet nëse në zyrën e kërkueses janë sekuestruar të gjitha dokumentet dhe pajisjet kompjuterike apo vetëm një pjesë e tyre, sikurse kjo e fundit deklarohet nga subjekti i interesuar, ndërsa kërkuesja nuk parashtron asgjë konkrete në këtë drejtim. Së fundi, në procesverbal nuk tregohet as se kur sekuestrimi ka përfunduar, pra sa ka zgjatur në kohë zbatimi i masës. Gjithsesi, procesverbali është nënshkruar edhe nga përfaqësuesja A.P. e kërkueses, pa ndonjë vërejtje apo shënim tjetër.

56. Në datën 2.5.2023 përfaqësuesja A.P. e kërkueses është pyetur nga OPGJ-të në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale dhe ajo ka dhënë deklarime për lidhjen e saj dhe të "Studio Pustina" me shoqërinë "H." sh.p.k., administratorin dhe ortakët e saj, si dhe për veprimet financiare të kryera për ata. Ajo nuk është pyetur dhe as ka bërë ndonjë deklarim në lidhje me veprimet e kryera në zyrën e kërkueses në datën 28.4.2023. Ndërkohë, në datën 8.5.2023, përmes shërbimit postar, kërkuesja ka paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të sekuestrimit të prokurorëve të datës 28.4.2023, të zbatuar po në këtë datë nga OPGJ-të, duke ngritur pretendime për vendimin e sekuestrimit dhe për mënyrën e ekzekutimit të tij nga OPGJ-të, duke pretenduar, ndër të tjera, se për realizimin e sekuestrimit është ushtruar prej tyre kontroll i paautorizuar i zyrës.

57. Gjykata konstaton, gjithashtu, se në vijim të hetimeve paraprake, me kërkesë të prokurorëve, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me

vendimin nr. 420, datë 21.10.2023, ka autorizuar kontrollin edhe të zyrës së kërkueses, duke disponuar dhe për sekuestrimin e sendeve të gjetura gjatë kontrollit dhe që përbënin provë materiale. Në zbatim të këtij vendimi, në datën 22.10.2023 OPGJ-të, pas kontrollit të zyrës së kërkueses, bazuar në nenin 300, pika 2, të KPP-së, kanë sekuestruar disa dokumente dhe sende të gjetura (ose dorëzuara) nga përfaqësuesja A.P. e saj, përfshirë, ndër të tjera, edhe 2 njësi qendrore, 2 laptopë dhe 2 *hard disc.* Duket se në zyrën e kërkueses ka pasur edhe dokumente dhe pajisje kompjuterike që në vlerësim të organit të prokurorisë kanë pasur interes për hetimin, çka mbështet deklarimin e subjektit të interesuar se në datën 28.4.2023 OPGJ-të kanë sekuestruar vetëm sende dhe dokumente të dorëzuara nga vetë kërkuesja. Megjithatë, ndërsa kontrolli dhe sekuestrimi në këtë rast ka ndodhur rreth 6 muaj më pas, është e paqartë nëse dokumentet dhe pajisjet e sekuestruara kanë qenë në zyrën e kërkueses edhe në datën 28.4.2023.

58. Gjykata vëren se versionet e palëve për mënyrën sesi OPGJ-të kanë vepruar për zbatimin e vendimit të sekuestrimit duken të mundshme. Megjithatë, ka edhe një version tjetër, i cili, në kontekst të rrethanave, duket më i besueshëm në rastit konkret. Sipas këtij versioni, një pjesë e paidentifikuar e sendeve dhe dokumenteve të sekuestruara është dorëzuar nga vetë kërkuesja, administratorja e saj A.P., kurse një pjesë tjetër e tyre, po ashtu të paidentifikuara, janë gjetur nga OPGJ-të. Një gjë e tillë nënkupton një lloj kërkimi nga këta të fundit, qoftë edhe sipërfaqësor dhe të kufizuar të zyrës së kërkueses. Në këtë pikë mbahet parasysh fakti i pranuar nga palët se kanë qenë tre OPGJ të cilët kanë qenë brenda zyrës së kërkueses dhe kanë qëndruar aty për një periudhë jo të shkurtër, referuar për këtë kohës së nevojshme për pasqyrimin në procesverbal të asaj sasie të madhe të sendeve dhe dokumenteve të sekuestruara, përveçse edhe përshkrimit të detajuar të tyre. Gjykata vlerëson se kërkuesja ka përmbushur *prima facie* barrën e saj të provës, ndërkohë që subjekti i interesuar nuk ka arritur të hedhë poshtë faktin se ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për paprekshmërinë e zyrës.

59. Në vlerësim të Gjykatës do të ishte joproporcionale që barra e provës t'i ngarkohej vetëm individit, sikurse gjykatat e zakonshme kanë konsideruar praktikisht në rastin konkret, ndërsa është në detyrimin e autoritetit publik, subjektit të interesuar në këtë rast, të dokumentojë dhe provojë qartësisht masat dhe veprimet e ndërmarra, në veçanti kur ato prekin ose mund të prekin të drejta dhe liri kushtetuese. Ndërhyrja në të drejtën e kërkueses në rastin konkret ka konsistuar në zbatimin praktikisht të një mase kërkimi në zyrën e saj, e shoqëruar me sekuestrim, e cila për nga mënyra e zbatimit dhe efektet e saj praktike në thelb përbën një kontroll banese për efekte të zbatimit të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së.

60. Nga ana tjetër, në lidhje me faktin se përfaqësuesja e kërkueses ka nënshkruar procesverbalin e sekuestrimit pa vërejtje, Gjykata vlerëson të shqyrtojë, së pari, nëse kjo do të konsiderohet, në çdo rast, se përbën heqje dorë nga e drejta kushtetuese, pra nëse në parim do të përbënte lejim të një mase kontrolli. Sipas GJEDNJ-së, heqja dorë nga një e drejtë themelore duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë, duke u bërë me njohuri të plotë të fakteve, pra në bazë të pëlqimit të informuar *(shih Pfeifer dhe Plankl kundër Austrisë, datë 25.2.1992, §§ 37–38)* të qartë dhe pa detyrim *(shih Sabani kundër Belgjikës, datë 8.3.2022, § 46).* Përveç kësaj, heqja dorë duhet të shoqërohet me garanci minimale në përpjesëtim me rëndësinë e saj *(shih Dvorski kundër Kroacisë, datë 20.10.2015, § 100; Bože kundër Letonisë, datë 18.5.2017, § 69)* dhe, pasi të përdoret, jo vetëm që duhet të jetë vullnetare, por duhet të përbëjë edhe një heqje dorë të vetëdijshme dhe inteligjente nga një e drejtë *(shih Pishchalnikov kundër Rusisë, datë 24.9.2009, § 77).*

61. Thënë sa më lart, në rastin konkret nuk rezulton ndonjë e dhënë mbi të cilën Gjykata të vërejë mënyrën sesi është proceduar në respekt të këtij parimi, pra nëse përfaqësuesja A.P. e kërkueses është informuar për ushtrimin e të drejtave të saj, përfshirë atë për të refuzuar kërkimin nga OPGJ-të në ambientet e saj, qoftë edhe në mënyrë sipërfaqësore ose të kufizuar, të sendeve dhe dokumenteve apo për pasojat e dhënies së pëlqimit për këtë qëllim, si dhe nëse kjo heqje dorë nga kjo e drejtë ka qenë e vetëdijshme, në kuptimin e shprehjes së vullnetit pa vese, pasi të jetë kuptuar rëndësia e veprimit dhe e pasojave. Referimi nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në nënshkrimin e procesverbalit pa

vërejtje, nuk përbën bazë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se kjo përbën në thelb miratim kontrolli nga ana e kërkueses.

62. Po ashtu, fakti se përfaqësuesja A.P. e kërkueses i ka lejuar OPGJ-të të futen në zyrë apo se ajo ka bashkëpunuar me ta, duke iu ofruar edhe një post pune dhe kompjuter për përpilimin e procesverbalit të sekuestrimit, rrethana këto që nuk kundërshtohen nga kërkuesja, nuk mund të interpretohet si dhënie pëlqimi edhe për lejimin e tyre për të kërkuar në zyrën e saj, të sendeve, dokumenteve apo çdo gjëje tjetër me interes për hetimin penal që zhvillohej. Edhe për këtë aspekt vlen parimi i evidentuar më lart se heqja dorë nga një e drejtë themelore duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë, duke u bërë me njohuri të plotë të fakteve, pra në bazë të pëlqimit të informuar dhe pa detyrim.

63. Së fundi, fakti se disa muaj më vonë ka pasur një procedurë kontrolli dhe sekuestrimi edhe të dokumenteve/sendeve të tjera në zyrën e kërkueses, ndryshe nga sa subjekti i interesuar pretendon, nuk përjashton pasjen e një kontrolli edhe në rastin në shqyrtim. Një rrethanë e tillë mund të tregojë vetëm se kontrolli dhe sekuestrimi në rastin konkret mund të mos ketë qenë i plotë apo i kujdesshëm, mbase edhe për arsye objektive që lidheshin me faktet e identifikuara si pjesë e objektit të hetimit, i cili duket se ka qenë dinamik.

64. Për sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për paprekshmërinë e banesës.

b) Nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar

65. Gjykata, në vijim, do të ndalet në analizën nëse ndërhyrja në të drejtën e kërkueses për paprekshmërinë e banesës është e justifikuar, pra respekton kriteret kushtetuese të kufizimit, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe ato të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së.

i. Nëse ndërhyrja ka qenë në përputhje me ligjin

66. Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar se kontrolli i zyrës së saj është bërë në kundërshtim me ligjin, nenin 202 të KPP-së, pasi është bërë pa vendim gjyqësor. Përkundër kësaj, subjekti i interesuar, pavarësisht se ka mohuar që zyra e kërkueses të jetë kontrolluar nga OPGJ-të, ka prapësuar se masa e sekuestros (provuese) ndaj kërkueses është zbatuar në kushte urgjence, pasi sendet dhe dokumentet objekt sekuestrimi mund të zhdukeshin ose të humbitnin. Ndërkohë, për zbatimin e masës së sekuestrimit provues, OPGJ-të janë bazuar në nenin 300 të KPP-së.

67. Sikurse dhe më lart u parashtrua, neni 37 i Kushtetutës, rregullimin e rasteve dhe të mënyrës së kontrolleve të banesës dhe të mjediseve që njësohen me të, ia ka deleguar ligjvënësit të zakonshëm. Në lidhje me kontrollin në fushën penale, ai rregullohet nga KPP-ja. Sipas kësaj të fundit, kontrolli dhe sekuestrimi (provues) janë dy mjete të ndryshme të kërkimit të provës që rregullohen nga dispozita të veçanta të KPP-së. Sekuestrimi paraqitet si një masë hetimore procedurale autonome, por megjithatë në praktikë ai shpesh shoqëron ose pason një masë kontrolli ose këqyrjeje, sepse pikërisht përmes këtyre të fundit mund të gjenden sendet, dokumentet ose diçka tjetër që duhet sekuestruar. Nenet 202-207 të KPP-së rregullojnë kushtet dhe mënyrën e kryerjes së kontrolleve, përfshirë edhe të vendit apo të banesës, duke pasur si synim gjetjen e provave materiale të veprës penale ose të sendeve që i përkasin asaj, në rastet kur ekzistojnë arsye të bazuara për të menduar se ato gjenden në një vend të caktuar. Në veçanti, pikat 1 dhe 2 të nenit 202 të KPP-së parashikojnë se kontrolli edhe i vendit apo i banesës, si rregull, lejohet të kryhet vetëm me vendim të gjykatës dhe, përjashtimisht, në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, që nuk lejon nxjerrjen e një vendimi kontrolli nga gjykata, OPGJ-të kryejnë edhe kontrollin e vendit apo të banesës, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298 të kodit (pika 3). Ndërsa neni 207 i KPP-së rregullon sekuestrimin gjatë kontrollit, duke parashikuar se sendet e gjetura gjatë kontrollit sekuestrohen, me kusht që të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit (pika 1). Sendet që nuk përfshihen në vendimin përkatës të kontrollit, por që lidhen me të njëjtën vepër penale, mund të sekuestrohen (pika 2) dhe po ashtu sekuestrohen sendet që nuk kanë lidhje me veprën penale për të cilat është dhënë vendimi i kontrollit, por që lidhen me një vepër tjetër penale që ndiqet kryesisht (pika 3), duke u zbatuar në këto dy raste kriteret e nenit 301 të kodit (pika 4).

68. Nga ana tjetër, sekuestrimi provues rregullohet në nenet 208–220 të KPP-së, të cilat, mes të tjerash, parashikojnë se ai mund të vendoset nga gjyqtari ose prokurori, me vendim të

arsyetuar, për sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve, dhe se ai kryhet nga vetë ai që ka nxjerrë vendimin ose OPGJ-të e deleguar me të njëjtin vendim (neni 208). Në rastin e procedimeve për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, neni 208/a parashikon sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike, me kërkesë të prokurorit dhe me vendim të gjykatës, në të cilin përcaktohet e drejta për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimi për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimi i të dhënave ose i sistemit kompjuterik. Neni 212 i kodit parashikon të drejtën e ankimit në gjykatë edhe të personit tek i cili janë sekuestruar sendet dhe të atij që ka të drejtën e kërkimit të tyre.

69. Ndërkohë, KPP-ja, në nenet 293–303 të saj, rregullon posaçërisht veprimtarinë me iniciativë të policisë gjyqësore në kuadër të hetimeve paraprake. Kështu, neni 294 rregullon "sigurimin e burimeve të provave", duke parashikuar se edhe pas referimit të veprës penale policia gjyqësore vazhdon të kryejë funksionet e treguara në nenin 30, duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit, duke proceduar sidomos edhe për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale, si dhe për ruajtjen e tyre dhe të vendit të ngjarjes për aq kohë sa kjo gjë është e domosdoshme apo dhe për kryerjen e veprimeve të caktuara në nenet vijuese (pika 1). Pas ndërhyrjes së prokurorit, policia gjyqësore kryen çdo veprim të urdhëruar ose të deleguar posaçërisht nga prokurori, si dhe kryen me iniciativë çdo veprim hetimor të nevojshëm dhe siguron burime të reja të provës (pika 2). Neni 298 i KPP-së në vijim, i cili është i lidhur me nenin 202, pika 3, të tij rregullon "kontrollet". Sipas pikës 1 të këtij neni, në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, OPGJ-të kryejnë kontroll edhe në një vend të caktuar kur kanë arsye të bazuara të mendojnë se në të ndodhen sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin. Veprimet e kryera i nënshtrohen kontrollit të prokurorit sipas nenit 301 të këtij kodi (pika 4). Kurse neni 300 i kodit rregullon "verifikimet e ngutshme në vend", duke përcaktuar se OPGJ-të dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë dhe kur ka rrezik që ato të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, OPGJ-të kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale. Neni 301 parashikon se sekuestrimi kontrollohet nga prokurori, i cili me vendim të motivuar e vleftëson atë në qoftë se ekzistojnë kushtet ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara, vendim ndaj të cilit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve edhe nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato, ankim që nuk pezullon zbatimin e sekuestros. Ndërsa neni 303 i KPP-së përcakton detyrimin për dokumentim të veprimeve nga policia gjyqësore, ndër të tjera, edhe të kontrolleve dhe sekuestrimeve (shkronja "ç").

70. Nga sa më lart, Gjykata vëren se KPP-ja, për sa i përket kontrollit të vendit apo të banesës, me qëllim sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve, parashikon se ai, si rregull, kryhet me vendim të gjykatës. Megjithatë, kodi lejon kryerjen e një kontrolli të tillë edhe pa vendim të gjykatës, me iniciativë të OPGJ-ve, por vetëm në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, që nuk lejon nxjerrjen e një vendimi kontrolli nga gjykata dhe kur kanë arsye të bazuara të mendojnë se në të ndodhen sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin.

71. Po ashtu, KPP-ja bën fjalë edhe për "verifikime të ngutshme në vend" nga ana e OPGJ-ve të cilët, në rastin kur gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve ka rrezik që të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht, kanë përgjegjësinë të kryejnë të gjitha veprimet hetimore të domosdoshme, duke përfshirë edhe sekuestrimin e provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale.

72. Nisur nga sa më sipër Gjykata vëren se, duke parashikuar mundësinë e kontrollit të vendit apo të banesës me iniciativë të OPGJ-ve, pra pa vendim të gjykatës, KPP-ja u referohet kërkesave të efikasitetit.

73. Gjykata vëren, po ashtu, se KPP-ja nuk ka ndonjë rregullim specifik për nocionin "rast flagrance" të përdorur në nenet 202 dhe 298. Megjithatë, në kreun që rregullon "arrestimin në flagrancë", pikërisht në nenin 252 të saj, rregullohet nocioni "gjendje e flagrancës", duke përcaktuar se është në gjendje të tillë personi që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi viktimë ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale. Kurse në lidhje me "verifikimet e ngutshme në vend", që bën fjalë neni 300 i KPP-së, duket se ato janë të lidhura me "vendngjarjen", por edhe për këtë nocion nuk ka ndonjë rregullim specifik. Megjithatë, referuar neneve 198 e vijuese, që rregullojnë "këqyrjet" si një nga mjetet e kërkimit të provës, duket se nocioni "vendngjarje" mund të ketë kuptimin e një hapësire fizike apo edhe virtuale dhe të përfshijë vendin ku është përgatitur vepra penale, vendin ku ajo është realizuar, vendin ku janë lënë pasojat materiale të saj apo dhe vendin ku gjenden prova materiale ose gjurmë të lidhura me të.

74. Së fundi, Gjykata vëren se KPP-ja nuk ka ndonjë parashikim për mundësinë e ankimimit të një mase kontrolli të vendit apo të banesës, qoftë të lejuar me vendim të gjykatës, ashtu edhe të kryer me iniciativë nga OPGJ-të. Megjithatë, në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se referuar parashikimeve aktuale ligjore, kur gjatë kontrollit sekuestrohen prova materiale, atëherë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit parashtrohen nga individi në aktin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit drejtuar një gjykate më të lartë dhe pas shterimit të atyre mjeteve juridike ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual *(shih paragrafin 22 të vendimit)*. Kurse kur nga kontrolli nuk gjenden sende për t'u sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe individit i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t'i paraqesë pretendimet kushtetuese për procedurën e kontrollit drejtpërdrejt në Gjykatë me anë të ankimit kushtetues individual *(shih vendimin nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*.

75. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se sekuestrimi nga prokurorët është urdhëruar duke konsideruar ekzistencën e një rreziku të afërt për humbjen ose zhdukjen e sendeve dhe dokumenteve që përmbanin të dhëna me rëndësi për hetimin, ndërkohë që OPGJ-të, nga ana tjetër, për zbatimin e masës së sekuestrimit, kanë konsideruar kryerjen e veprimeve me iniciativë në kuadër të një verifikimi të ngutshëm në vend. Gjykata vëren se kontrolli i vendit apo i banesës me iniciativë nga OPGJ-të, pa vendim të gjykatës, është një masë e lejuar nga KPP-ja, por vetëm në kushte të përcaktuara rigozorisht prej saj. Megjithatë, nëse ato kushte kanë ekzistuar në rastin konkret, nuk ka një përgjigje nga gjykatat e zakonshme, të cilat ndërsa kanë konkluduar se nuk ka pasur kontroll të zyrës së kërkueses, nuk kanë vënë në diskutim interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural për këtë aspekt. Po ashtu, Gjykata vëren se nuk evidentohet as ndonjë praktikë gjyqësore e qëndrueshme dhe aq më tepër njësuese e Gjykatës së Lartë për sa i përket kontrollit të vendit apo të banesës, në veçanti, me iniciativë të OPGJ-ve, që t'i përgjigjet rrethanave të ngjashme me ato të çështjes konkrete. Në këtë situatë, ndërsa çështja në thelb kërkon interpretimin e dispozitave ligjore, që në respektim të parimit të subsidiaritetit i përket funksionit të gjykatave të zakonshme dhe sidomos atij të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerëson të mos ndalet në mënyrë të veçantë në lidhje me respektimin në rastin konkret të dispozitave të KPP-së për sa i përket masës së kontrollit të zbatuar praktikisht nga OPGJ-të në kuadër të ekzekutimit të vendimit të sekuestrimit. Duke thënë këtë, mënyra e zbatimit të masës në këtë rast do të vlerësohet nga Gjykata në lidhje me proporcionalitetin e saj.

ii. Nëse ndërhyrja ka ndjekur një qëllim të ligjshëm

76. Për sa i përket qëllimit të ndërhyrjes, Gjykata vëren se kontrolli (i kufizuar) në rastin konkret ka synuar gjetjen e të dhënave dhe provave për kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale. Nisur nga kjo, ndërsa as kërkuesja nuk ka ndonjë kundërshtim në këtë drejtim, është e qartë se ai ka pasur për qëllim parandalimin dhe ndjekjen penale të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, domethënë ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike nga veprimtaria kriminale, çka përbën një qëllim të ligjshëm në aspekt të interesit publik, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.

iii. Nëse ndërhyrja ka qenë proporcionale, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë

77. Gjykata, për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, është shprehur se ai nënkupton që marrëdhënia midis ndërhyrjes (kufizimit) dhe qëllimit të ndjekur duhet të jetë e arsyeshme. Gjykata e ka analizuar këtë kriter në drejtim të nevojës, pra nëse masa e zbatuar është e aftë të realizojë pasojën që ajo synon, të përshtatshmërisë, pra nëse masa e zbatuar është e arsyeshme, duke balancuar qëllimin për të cilin është zbatuar me interesat e individit të përfshirë, si dhe ashpërsisë, në kuptimin që ajo nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme *(shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese).*

78. Sipas GJEDNJ-së, për të përcaktuar nëse një shkelje e veçantë e nenit 8 të Konventës është "e nevojshme në një shoqëri demokratike", ajo balancon interesat e shtetit me të drejtën e individit *(shih Vavřička dhe të tjerë kundër Republikës Çeke, datë 8.4.2021, §§ 273–275).* "E nevojshme" në kontekst të nenit 8 të Konventës, nuk ka fleksibilitetin e shprehjeve të tilla si "e dobishme", "e arsyeshme" ose "e dëshirueshme", por nënkupton ekzistencën e një "nevoje të ngutshme shoqërore" për ndërhyrjen në fjalë. U takon autoriteteve kombëtare të bëjnë vlerësimin fillestar të nevojës së ngutshme shoqërore në secilin rast dhe në përputhje me rrethanat atyre u lihet një hapësirë vlerësimi. Një kufizim i një të drejte të Konventës nuk mund të konsiderohet si "i domosdoshëm në një shoqëri demokratike", përveçse nëse, ndër të tjera, është në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur *(shih Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 22.10.1981, §§ 51–53).* Shtetet palë gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi në drejtim të domosdoshmërisë së një ndërhyrjeje dhe përjashtimet e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 8 të Konventës duhet të interpretohen ngushtësisht, ndërsa domosdoshmëria në një rast të caktuar duhet të përcaktohet bindshëm *(shih Miailhe kundër Francës, datë 25.2.1993, § 36; Ernst dhe të tjerë kundër Belgjikës, datë 15.7.2003, § 113).*

79. Po sipas GJEDNJ-së, shtetet palë mund të konsiderojnë të nevojshme të përdorin masa të tilla për të marrë prova fizike për vepra të caktuara penale, por është detyrë e gjykatës të vlerësojë nëse arsyet e paraqitura për të justifikuar masa të tilla ishin relevante dhe të mjaftueshme, dhe nëse është respektuar parimi i proporcionalitetit. Lidhur me pikën e fundit, gjykata duhet, së pari, të sigurojë që legjislacioni dhe praktika përkatëse t'u ofrojnë individëve mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive kundër abuzimit. Së dyti, ajo duhet të marrë në konsideratë rrethanat specifike të secilit rast për të përcaktuar nëse në rastin e veçantë ndërhyrja në fjalë ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur. Kriteret që gjykata ka marrë në konsideratë në përcaktimin e kësaj çështjeje të fundit janë, ndër të tjera: rrethanat në të cilat është lëshuar urdhri, në veçanti nëse ka pasur prova të mëtejshme në dispozicion në atë kohë; përmbajtja dhe fushëveprimi i urdhrit, duke pasur parasysh veçanërisht natyrën e mjediseve të kontrolluara dhe mënyrën sesi është kryer kontrolli, duke përfshirë nëse kanë qenë të pranishëm apo jo vëzhgues të pavarur; shkalla e pasojave të mundshme për reputacionin e personit të prekur nga kontrolli *(shih Smirnov kundër Rusisë, datë 7.6.2007, § 44; K.S. dhe M.S. kundër Gjermanisë, datë 6.10.2016, § 44; Modestou kundër Greqisë, datë 16.3.2017, § 42).* Në kontekstin e kontrolleve dhe sekuestrimeve, gjykata kërkon, gjithashtu, që ligji i brendshëm të ofrojë garanci të mjaftueshme dhe të përshtatshme kundër arbitraritetit *(shih Gutsanovi kundër Bullgarisë, datë 15.10.2013, § 220; Vinci Construction dhe GTM Génie Civil et Services kundër Francës, datë 2.4.2015, § 66),* garanci këto që përfshijnë edhe ekzistencën e "shqyrtimit efektiv" të masave që cenojnë nenin 8 të Konventës *(shih Lambert kundër Francës, datë 24.8.1998, § 34; Modestou kundër Greqisë, datë 16.3.2017, § 43).*

80. Në lidhje me një urdhër për kërkimin e provave, GJEDNJ-ja është shprehur se ai duhet të shoqërohet me kufizime të caktuara, në mënyrë që ndërhyrja që ai autorizon të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe, për këtë arsye, joproporcionale. Formulimi i urdhrit duhet të specifikojë fushëveprimin e tij (në mënyrë që të sigurohet që kontrolli të përqendrohet vetëm në veprat penale nën hetim) dhe kriteret për zbatimin e tij (për të lehtësuar kontrollin e shtrirjes së veprimeve). Ai duhet të përmbajë një informacion minimal për të mundësuar mbikëqyrjen e oficerëve që e ekzekutuan atë për të siguruar që fushëveprimi i hetimit që ai ka përcaktuar është respektuar. Një urdhër i formuluar gjerësisht, që nuk përmban

informacion për hetimin ose sendet që do të sekuestrohen, nuk plotëson ekuilibrin e drejtë midis të drejtave të palëve të përfshira për shkak të kompetencave të gjera që u jep hetuesve *(shih Van Rossem kundër Belgjikës, datë 9.12.2004, §§ 44–45; Bagiyeva kundër Ukrainës, datë 28.4.2016, § 52).* Fakti që hetuesit "në të vërtetë dinin se çfarë duhej të kërkonin" nuk është i mjaftueshëm. Faktori vendimtar është që personi/personat e synuar nga masa, ose një palë e tretë, të kenë informacion të mjaftueshëm në lidhje me procedurat që çuan në këtë operacion për t'u mundësuar atyre të zbulojnë, parandalojnë dhe raportojnë abuzimet *(shih Funke kundër Francës, datë 25.2.1993, § 56; Miailhe kundër Francës, datë 26.9.1996, § 37; Van Rossem kundër Belgjikës, datë 9.12.2004, §§ 47).* Po sipas GJEDNJ-së, mungesa e një urdhri gjyqësor paraprak kontrolli mund të balancohet nga disponueshmëria e një shqyrtimi gjyqësor *ex post factum* të ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së masës. Ky shqyrtim, megjithatë, duhet të jetë efektiv në rrethanat e veçanta të çështjes në fjalë *(shih Smirnov kundër Rusisë, datë 7.6.2007, § 45; Gutsanovi kundër Bullgarisë, datë 15.10.2013, § 222; Modestou kundër Greqisë, datë 16.3.2017, § 49).*

81. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren së pari se kontrolli (i kufizuar) i zyrës së kërkueses është kryer gjatë fazës së hetimit paraprak të një procedimi penal, ndaj një kontroll i tillë duhet të shoqërohet me mbrojtje të përshtatshme dhe të mjaftueshme. Në vijim, Gjykata, në kontekst të kundërshtimit të kërkueses se vendimi i sekuestrimit ka përbërë shkas për kontrollin e zyrës së saj nga OPGJ-të, do të shqyrtojë formulimin e këtij vendimi me qëllim për të verifikuar nëse janë marrë masa paraprake të mjaftueshme për të siguruar që ai nuk ka tejkaluar qëllimin e parandalimit dhe ndjekjes penale të veprës penale për të cilën ajo masë është marrë. Një vendim i tillë duhet t'u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, në mënyrë që ndërhyrja që ai mund të shkaktojë, veçanërisht në të drejtën për respektimin e banesës, të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe, si pasojë, joproporcionale. Ai duhet të përfshijë, po ashtu, një numër minimal treguesish, çka mund të bënte të mundur më pas verifikimin nëse OPGJ-të e ngarkuar për zbatimin e tij kanë përmbushur fushëveprimin e hetimit të autorizuar në këtë mënyrë. Përveç kësaj, individi i prekur, kërkuesja në rastin konkret, duhet të ketë një informacion të mjaftueshëm, pa shkelur kufijtë e sekretit hetimor, për procedimin penal që ka përbërë shkak për ndërmarrjen e masës, për t'i mundësuar të dallojë, parandalojë dhe ankohet për abuzim.

82. Gjykata vëren se urdhri i sekuestrimit duket se është hartuar në terma të gjerë. Prokurorët e çështjes kanë urdhëruar sekuestrimin me qëllim gjetjen e provave për të verifikuar kryerjen e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale përmes shoqërisë "H." sh.p.k., ndërsa të dyshuar në atë moment kanë qenë persona të ndryshëm nga kërkuesja, administratorja apo punonjësit e saj. Ata, gjithashtu, kanë urdhëruar OPGJ-të të sekuestronin dokumente dhe kompjuterin që kishte lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., si dhe "çdo gjë tjetër që kishte rëndësi për hetimin dhe ofronte të dhëna mbi faktin objekt hetimi", mbështetur në vlerësimin e tyre. Duket se prokurorët nuk kanë përfshirë ndonjë informacion në lidhje me hetimin në fjalë dhe as ndonjë informacion specifik për të dhënat që duhet të përmbanin dokumentet dhe sendet që do të sekuestroheshin, përveç atij se ato duhet të kishin lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., duke u dhënë kështu kompetenca të gjera OPGJ-ve, pavarësisht se ata mund ta kenë pasur këtë informacion për shkak të përfshirjes së tyre në hetimin e procedimit penal. Vendimi nuk përmbante as ndonjë listë shteruese të sendeve dhe dokumenteve në raport me natyrën e veprës penale në hetim dhe me faktet me rëndësi për hetimin në atë moment. Përveç kësaj, në vendim nuk është përshkruar as lidhja e mundshme e kërkueses me çështjen në hetim.

83. Gjykata pranon se mund të ketë situata në të cilat është e pamundur që vendimet e sekuestrimit të hartohen me një shkallë të lartë saktësie, në veçanti si ai në rastin konkret, kur provat që synohej të mblidheshin lidhen me dyshime për një aktivitet kriminal të shtrirë përgjatë disa viteve dhe ku ishin të përfshirë disa persona, ndaj do të ishte iluzore të kërkohej që urdhri të përmbante informacion të saktë, siç është edhe një listë shteruese e sendeve ose dokumenteve që do të sekuestrohen. Megjithatë, në raste të tilla, dhe veçanërisht për sa kohë ligji procedural penal nuk parashikon shqyrtim paraprak gjyqësor të ligjshmërisë dhe

domosdoshmërisë së një mase hetimore, do të duhet të zbatohen masa të tjera mbrojtëse, veçanërisht në lidhje me ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit, në mënyrë që të kompensohet mungesa e lëshimit paraprak nga gjykata të një vendimi kontrolli dhe kufizimet e përcaktuara përmes tij. Në rastin konkret, siç edhe u përmend, KPP-ja, megjithëse parashikon, si rregull, një shqyrtim paraprak gjyqësor, përjashtimisht, në raste urgjente, lejon të mos ketë një shqyrtim të tillë. Megjithatë, sikurse GJEDNJ-ja ka pranuar, por edhe në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, mungesa e një vendimi gjyqësor paraprak kontrolli të vendit apo të banesës, të zyrës së kërkueses në rastin konkret, mund të balancohet nga një shqyrtim gjyqësor efektiv *ex post factum* i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së kësaj mase hetimore, përfshirë edhe të kushtit të urgjencës së saj.

84. Gjykata vëren, së pari, se kontrolli i kryer në rastin konkret është shoqëruar me disa masa mbrojtëse procedurale. Ai është ndërmarrë në zbatim të një urdhri sekuestrimi të nxjerrë nga prokurorët e çështjes, detyrë të cilën ata ia deleguan OPGJ-ve, ndërsa për zbatimin e saj kanë vepruar tre të tillë. Po ashtu, kontrolli është kryer në prani të përfaqësueses së kërkueses, së cilës në përfundim i është vënë në dispozicion edhe një kopje e procesverbalit të mbajtur nga OPGJ-të për masën hetimore të zbatuar nga ata. Gjykata vëren se pavarësisht pranisë së përfaqësueses së kërkueses, ajo nuk duket se është informuar mjaftueshëm për çështjen penale në hetim, për faktet që kishin interes për hetimin dhe as për specifikën e të dhënave që duhet të përmbanin sendet dhe dokumentet që kërkoheshin për t'u sekuestruar. Po ashtu, duket se ajo nuk është informuar as për të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar ose mbrojtësit të saj, sikurse përcakton neni 205, pika 1, i KPP-së.

85. Përveç mungesës së shqyrtimit paraprak gjyqësor, natyrës jo tërësisht të saktë të vendimit të sekuestrimit dhe faktit që kërkueses nuk i është garantuar e drejta për të qenë i pranishëm një person i besuar ose mbrojtësi i saj, në rastin konkret pavarësisht se gjykatat u vunë në lëvizje *ex post factum* mbi ankimin e kërkueses, shqyrtimi gjyqësor nuk ka qenë efektiv. Kontrolli i zyrës së kërkueses në këtë rast ka çuar në sekuestrimin e 4 pajisjeve kompjuterike dhe të qindra dokumenteve, por, megjithatë, nuk është përcaktuar nëse të gjitha ato përmbanin të dhëna që lidheshin drejtpërdrejt me veprën penale në hetim. Duke pasur parasysh formulimin e vendimit të sekuestrimit, është e diskutueshme nëse kërkueses i është dhënë informacion i saktë në lidhje me fushëveprimin e zbatimit të tij, çka praktikisht ka rezultuar në një masë kontrolli (të kufizuar) të zyrës, gjë e cila do t'i kishte mundësuar asaj (kërkueses) të verifikonte nëse ky kontroll ishte i kufizuar vetëm në kërkimin e provave të veprës penale të përmendur në vendimin e sekuestrimit dhe të ankohej për çdo abuzim në këtë kontekst. Gjykatat e zakonshme, mbi ankimin e kërkueses, duke konsideruar se nuk ka pasur kontroll të zyrës së saj, nuk kanë vënë në diskutim ligjshmërinë dhe domosdoshmërinë e kësaj mase hetimore, përfshirë edhe të kushtit të urgjencës së saj. Në lidhje me këtë të fundit, ndonëse mund të ketë pasur premisa për të menduar se provat materiale që janë synuar të sekuestrohen mund të zhdukeshin ose humbnin, pra se ka pasur një rrezik të menjëhershëm ose të afërt në këtë drejtim, nuk ka ndonjë tregues nëse masa të tjera hetimore, siç mund të ishte, për shembull, sekuestrimi dhe vulosja e përkohshme e zyrës së kërkueses, nuk do të kishin qenë të afta për të shmangur një rrezik të tillë deri në kërkimin dhe marrjen paraprakisht nga gjykata të një vendimi kontrolli, procedurë për të cilin KPP-ja parashikon një afat shumë të shkurtër kohor, deri në 24 orë nga paraqitja e kërkesës së prokurorit (neni 202/a, pika 3).

86. Në këtë pikë, Gjykata çmon të theksojë se kompetenca që KPP-ja i ka dhënë gjyqtarit për të vendosur për kontrollin e vendit apo të banesës synon kontrollin parandalues të kësaj mase nga një organ i pavarur dhe neutral. Gjyqtarët, për shkak të pavarësisë së tyre personale dhe profesionale dhe nënshtrimit të tyre të rreptë ndaj Kushtetutës dhe ligjit (neni 145 i Kushtetutës), kanë aftësitë dhe besueshmërinë e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e të prekurve në raste individuale. Në hetimet penale paraprake, të cilat prokurori publik i kryen me përgjegjësinë e vet, gjyqtari, në përputhje me ndarjen e autoritetit të ndjekjes penale dhe gjykatës në procedurat penale, është një palë e tretë e papërfshirë, që sa i përket masave hetimore vepron vetëm me kërkesën e prokurorit publik. Në rastin e masës së kontrollit, e cila, sipas

nenit 202/a të KPP-së, merret në dhomën e këshillimit, pra pa dëgjimin paraprak të personit të prekur, përfshirja e gjyqtarit synon të sigurojë në veçanti që interesat e personit të prekur të merren parasysh siç duhet. Në këtë kuptim, organet e ndjekjes penale kanë detyrimin që rezerva ligjore e mbikëqyrjes paraprake gjyqësore, si një masë mbrojtëse e të drejtave themelore të individit, të jetë efektive në praktikë.

87. Po ashtu, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme janë fokusuar kryesisht në drejtim të faktit se sekuestrimi gjatë hetimeve paraprake është një masë hetimore në dorë të prokurorit të çështjes, por pa arsyetuar në lidhje me mënyrën e zbatimit dhe shtrirjen e tij në rastin konkret. Në këtë mënyrë, subjekti i interesuar dhe gjykatat e zakonshme në vijim nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre për të treguar arsye "relevante dhe të mjaftueshme" për të justifikuar zbatimin në rastin konkret të një mase kontrolli të zyrës së kërkueses.

88. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se këta faktorë janë të mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se ndërhyrja në zyrën e kërkueses nuk ka qenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, pra nuk ka qenë proporcionale, pasi nuk provohet të jetë gjetur një ekuilibër i drejtë midis interesave të ndryshëm të përfshirë në këtë rast, duke pasur parasysh interesin e një shoqërie demokratike për të siguruar respektimin e paprekshmërisë së banesës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së paprekshmërisë së banesës është i bazuar, ndaj kërkesa pranohet për këtë shkak.

B.2. Për lirinë e veprimtarisë ekonomike

89. Sipas kërkueses, kjo liri gëzon mbrojtje kushtetuese edhe kur zhveshja e titullarit të sendit nga disponimi i ligjshëm bëhet për një kohë relativisht të shkurtër. Sipas saj, masa është e vlefshme dhe e ekzekutueshme menjëherë dhe qëndron në fuqi, si rregull, deri në përfundim të çështjes me vendim përfundimtar dhe se sekuestrimi i dokumenteve dhe sendeve në zyrën e saj është kryer në kundërshtim me ligjin, pa vendim gjyqësor, pa argumentuar domosdoshmërinë e sekuestrimit dhe janë sekuestruar dokumente që haptazi nuk i shërbejnë hetimit.

90. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, pretendimi është i pabazuar, pasi në sendet e sekuestruara kanë rezultuar dokumente që kanë të bëjnë me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe veprimtarinë e saj dhe sekuestrimi është urdhëruar në kuadrin e një procedimi penal, të regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, pra për një qëllim të ligjshëm. Sipas tij, në vendimin e sekuestrimit kishte të dhëna të mjaftueshme për veprën penale dhe për dokumentet e sendet që kërkoheshin të sekuestroheshin dhe ai është bazuar në dyshimin e arsyeshëm se shoqëria "H." sh.p.k. po shërbente si strukturë, hallkë e pastrimit të parave dhe ato çfarë do të sekuestroheshin do të përdoreshin për të vërtetuar nëse aktiviteti i kësaj shoqërie dhe ortakëve të saj ishte në përputhje me ligjin. Sipas këtij subjekti, në lidhje me atë se çfarë kanë brenda këto pajisje kompjuterike dhe rëndësia për hetimin e të dhënave që ato përmbajnë, kjo zgjidhet pasi përfundon ekspertimi dhe këqyrja e të dhënave që këto pajisje kanë.

91. Kushtetuta në nenin 4, pika 1, ka parashikuar se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit kurse në nenin 11, pika 1, ka përkufizuar se sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike. Gjykata ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri, ndër ato edhe lirinë e biznesit, lirinë e punës dhe të drejtat e pronës, si aftësi e individëve edhe për të poseduar sende, të lirë nga ndërhyrja e shtetit *(shih vendimet nr. 21, datë 18.4.2023; nr. 56, datë 27.7.2016; nr. 24, datë 24.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese).*

92. Gjykata vëren se në zbatim të vendimit të sekuestrimit të datës 28.4.2023, OPGJ-të kanë sekuestruar në ambientet e punës së kërkueses 4 pajisje kompjuterike, 407 dokumente shkresore që lidhen me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe 4 dokumente shkresore të tjera (pasqyra financiare) që u përkasin subjekteve juridike të tjera, sipas procesverbalit të po kësaj date. Në vijim, pajisjet kompjuterike u janë nënshtruar ekzaminimeve përkatëse, pas të cilëve 3 nga ato (1 laptop dhe 2 njësi qendrore) i janë kthyer kërkueses në datat 19.5.2023 dhe 7.6.2023, me arsyetimin se mbajtja e sekuestros nuk ishte e nevojshme. Nga ana tjetër, 1 nga laptopët është mbajtur nën sekuestro dhe në vijim i është dërguar gjykatës si provë materiale në kuadër të procedimit penal të dërguar për gjykim. Nisur nga këto veprime të kryera nga

autoritetet e ndjekjes penale, si dhe duke konsideruar se sendet/pajisjet kompjuterike përdoreshin nga kërkuesja për ushtrimin e veprimtarisë tregtare së saj në fushën e konsulencës dhe shërbimeve financiare, ekonomike, Gjykata vlerëson se ka pasur ndërhyrje në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

93. Gjykata e vlerëson ndërhyrjen si në kuptim të pikës 3 të nenit 11 të Kushtetutës, që parashikon se kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike, ashtu edhe të nenit 17 të Kushtetutës, që përveç arsyes publike përmban detyrimin për të respektuar edhe kritere të tjera, si: kufizimi për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë. Parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet *(shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2024; nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 16, datë 1.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese).*

94. Për sa i përket kriterit të kufizimit me ligj dhe arsyes së rëndësishme publike Gjykata, nisur nga rrethanat e rastit dhe për sa kohë as nga palët nuk pati pretendime në lidhje me këto aspekte të ndërhyrjes, çmoi të mos ndalet në analizën e tyre, duke vlerësuar se ato përmbushen. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit, Gjykata në rastin konkret do ta analizojë atë në drejtim të kohëzgjatjes së masës së sekuestrimit ndaj sendeve/pajisjeve të kërkueses, ashtu si ka pohuar në jurisprudencën e saj (*shih vendimin nr. 79, datë 12.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese).*

95. Sipas GJEDNJ-së, mbajtja e provave materiale mund të jetë e nevojshme në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, që është një "qëllim legjitim" në "interesin e përgjithshëm" të komunitetit. Megjithatë, duhet të ketë gjithashtu një lidhje të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet nga çdo masë e zbatuar nga shteti, duke përfshirë masat e synuara për të kontrolluar përdorimin e pasurisë së individit (*shih Smirnov kundër Rusisë, datë 7.6.2007, § 57; BENet Praha, spol. S.r.o. kundër Republikës Çeke, datë 24.2.2011, §§ 100–01*). Ajo gjykatë ka konstatuar se mbajtja e vazhdueshme e pajisjeve elektronike të ruajtjes së të dhënave të sekuestruara nuk kishte asnjë justifikim të dukshëm kur vetë pajisjet nuk ishin objekt, instrument ose produkt i ndonjë vepre penale dhe, në këtë mënyrë, përbënin një ndërhyrje joproporcionale në të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë, të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së *(shih Smirnov kundër Rusisë, datë 7.6.2007, § 5–8).*

96. Nisur nga qëllimi i ligjshëm i ndërhyrjes, në kuptim të interesit publik, në raport me kohëzgjatjen e masës sekuestrimit, Gjykata e vlerësoi të pabazuar pretendimin e kërkueses në lidhje me 3 nga pajisjet kompjuterike të sekuestruara, të cilat i janë kthyer asaj pas 21 dhe 40 ditëve, pas përfundimit të ekzaminimit të tyre. Mbajtja e sekuestrimit në këtë hark kohor nuk duket e paarsyeshme në kontekst të rrethanave të rastit konkret, ndaj masa e zbatuar ka ruajtur një ekuilibër të drejtë mes interesit material të kërkueses dhe interesit publik për parandalimin dhe ndjekjen penale të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale.

97. Po ashtu, Gjykata vlerësoi të pabazuar pretendimin e kërkueses edhe në lidhje me atë pajisje kompjuterike të sekuestruar që nuk i është kthyer ende asaj. Lidhur me këtë, fakti që ajo pajisje është mbajtur nën sekuestro dhe në vijim i është dërguar gjykatës si provë materiale në kuadër të procedimit penal të dërguar për gjykim është në përpjesëtim me qëllimin e ndërhyrjes. Kjo do të thotë se pajisja duket se i shërben organit hetimor, jo vetëm për gjetjen e të dhënave që provojnë kryerjen ose jo të veprës penale, por edhe për t'u paraqitur si provë dhe për t'u debatuar gjatë procesit gjyqësor, sikurse ka argumentuar subjekti i interesuar. Po ashtu, nuk rezulton që kërkueses, për shkak të kësaj mase, t'i jetë penguar veprimtaria ekonomike në atë masë sa t'ia ketë bërë të pamundur atë, nisur nga fakti që asaj i janë kthyer pajisjet e tjera të sekuestruara, por edhe kur ajo ka pasur edhe pajisje të tjera kompjuterike, të cilat nuk i janë sekuestruar.[1]

[1] Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahimi votuan për bazueshmërinë e pretendimit të kërkueses për këtë pjesë, duke mbajtur qëndrimin se kohëzgjatja e mbajtjes nën sekuestro të pajisjes kompjuterike të sekuestruar tejkalon kriterin e ashpërsisë, pasi përbën një barrë të tepruar për kërkuesen në kushtet që ajo arriti të provojë se sendi i sekuestruar është i nevojshëm

98. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses në drejtim të së drejtës së paprekshmërisë së banesës janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht, duke u konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese. Ky konstatim, në vlerësimin e Gjykatës, përmbush kërkesat e efektivitetit të mjeteve dhe bën të panevojshëm dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për paprekshmërinë e banesës, sipas arsyetimit të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.7.2025.
Shpallur më 25.9.2025.

Kryetare (pjesërisht kundër): Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini
Anëtarë (pjesërisht kundër): Genti Ibrahimi, Sonila Bejtja

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 10 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar që i përket kërkueses, "Studio Pustina", me objekt: "*Shfuqizimi i vendimeve datë 28.4.2023 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 206, datë 1.6.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 128, datë 15.9.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-741 (26), datë 8.2.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", i bashkohemi shumicës për zgjidhjen e saj në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për paprekshmërinë e zyrës së kërkueses, që mbrohet nga neni 37 i Kushtetutës. Megjithatë, në lidhje me argumentet që kanë çuar në përfundimin se ky pretendim është i bazuar, ne kemi një qasje të ndryshme nga shumica në drejtim të vlerësimit të kritereve kushtetuese të ndërhyrjes në këtë të drejtë kushtetuese, për sa kohë jemi të qëndrimit se ndërhyrja në rastin konkret është bërë pa ligj, çka e bënte të panevojshme analizën e kritereve të tjera të ndërhyrjes në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.

2. Shumica ka vlerësuar se "*ndërhyrja në të drejtën e kërkueses në rastin konkret ka konsistuar në zbatimin praktikisht të një mase kërkimi në zyrën e saj, e shoqëruar me sekuestrim, e cila për nga mënyra e zbatimit dhe efektet e saj praktike në thelb përbën një kontroll banese për efekte të zbatimit të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së" (shih paragrafin 59 të vendimit).* Në vlerësimin tonë, një analizë e tillë, e fokusuar thelbësisht në mënyrën e zbatimit të vendimit të sekuestrimit, e zvogëlon mbrojtjen kushtetuese të banesës dhe ambienteve që njësohen me të, në drejtim të standardit të paprekshmërisë së saj dhe mbart rrezikun që të lihet në diskrecion të organeve publike (në këtë rast të prokurorisë) mënyra e vlerësimit dhe zbatimit rast pas rasti të këtij standardi kushtetues, ashtu edhe e vlerësimit të pasojave që sjell një ndërhyrje e tillë. Ne jemi të qëndrimit se kjo qasje është e tillë që lë shteg për ndërhyrje arbitrare dhe për legjitimimin e këtyre pasojave të paligjshme që një ndërhyrje e tillë sjell ndaj të drejtave kushtetuese të individit.

3. Referuar standardeve të elaboruara nga GJEDNJ-ja në drejtim të nenit 8 të KEDNJ-së, për të siguruar prova fizike për vepra të caktuara penale, autoritetet mund të konsiderojnë të nevojshme që të zbatojnë masa që përfshijnë

për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike prej saj, si dhe për sa kohë që subjekti i interesuar nuk arriti të provojë se nuk kishte asnjë mënyrë tjetër, përveç sekuestrimit të sendit si provë, që të mund të siguronte në të njëjtën mënyrë, marrjen dhe nxjerrjen e të dhënave të konsideruara si të nevojshme për qëllime të procedimit penal.

hyrjen në një banesë private *(shih Dragan Petrović kundër Serbisë, datë 14.4.2020, § 74),* por këto veprime duhet të jenë "të ligjshme" *(shih Bostan kundër Republikës së Moldavisë, datë 8.12.2020, §§ 21–30)* dhe në përpjesëtim me qëllimin e ndjekur *(shih McLeod kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 23.9.1998, §§ 53–57).* Në kontekstin e kontrolleve dhe sekuestrimeve ligji duhet t`i ofrojë individit mbrojtje kundër ndërhyrjes arbitrare në të drejtat e mbrojtura nga neni 8 i Konventës, ai duhet të jetë mjaftueshëm i qartë për t`u dhënë qytetarëve një tregues të përshtatshëm në lidhje me rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuara të përdorin masa të tilla. Për më tepër, kontrolli dhe sekuestrimi përfaqësojnë një ndërhyrje serioze në jetën private, banesën dhe korrespondencën dhe, në përputhje me rrethanat, duhet të bazohen në një "ligj" që është veçanërisht i saktë, ndaj është thelbësore që për këtë qëllim të ketë rregulla të qarta dhe të detajuara *(shih Petri Sallinen dhe të tjerë kundër Finlandës, datë 27.9.2005, §§ 82–90).* Një urdhër kontrolli duhet të shoqërohet me kufizime të caktuara, në mënyrë që ndërhyrja që ai autorizon të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe për këtë arsye joproporcionale. Formulimi i një urdhri të tillë duhet të specifikojë fushëveprimin e tij (në mënyrë që të sigurohet që kontrolli të përqendrohet vetëm në veprat penale nën hetim) dhe kriteret për zbatimin e tij (për të lehtësuar kontrollin e shtrirjes së veprimeve). Një urdhër i formuluar gjerësisht, që nuk përmban informacion për hetimin ose sendet që do të sekuestrohen, nuk plotëson ekuilibrin e drejtë midis të drejtave të palëve të përfshira, për shkak të kompetencave të gjera që u jep hetuesve *(shih Van Rossem kundër Belgjikës, datë 9.12.2004, §§ 44–50; Bagiyeva kundër Ukrainës, datë 28.4.2016, § 52).*

4. Referuar dispozitave përkatëse të KPP-së, kontrolli i vendeve (përfshirë edhe banesën) dhe sekuestrimi i sendeve/provave materiale janë dy mjete të ndryshme të kërkimit të provës që rregullohen nga dispozita të ndryshme të këtij kodi. Nenet 202-207 të KPP-së rregullojnë kushtet dhe mënyrën e kryerjes së kontrolleve, duke parashikuar se ato synojnë gjetjen e provave materiale të veprës penale ose të sendeve që i përkasin veprës penale. Si rregull, kontrollet lejohen të kryhen vetëm me vendim të gjykatës. Përjashtimisht, KPP-ja parashikon se kontrolli i vendeve mund të kryhet edhe nga OPGJ-të në rastet e mëposhtme: i) në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur[2]; ii) kur duhet të kryhet një ndalim, të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim[3].

5. Për sa i përket kontrollit, neni 202/a i KPP-së parashikon se vendimi duhet të tregojë llojin e kontrollit, vendin apo banesën objekt kontrolli, provat materiale apo sendet që kërkohen, përfshirë edhe të sistemeve informatike ose telematike, arsyet që lejojnë kontrollin, si edhe autoritetin që do të kryejë atë (pikat 1 dhe 2). Ndërkohë, neni 203 i KPP-së përcakton se kur kërkohet një send i caktuar, organi procedues mund të kërkojë dorëzimin e tij dhe në qoftë se sendi dorëzohet, kontrolli nuk bëhet, me përjashtim të rasteve kur pas dorëzimit të sendit ka arsye të bazuara për të besuar se nga kontrolli mund të zbulohen gjurmë apo sende të tjera që lidhen me veprën penale (pika 1). Më tej, neni 205 i KPP-së rregullon mënyrën e kontrollit të vendeve, ndërsa neni 207 i tij rregullon sekuestrimin gjatë kontrollit. Kjo dispozitë përcakton se sendet e gjetura gjatë kontrollit sekuestrohen, me kusht që të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit, ndërsa ato që nuk përfshihen në vendimin përkatës, por që lidhen me të njëjtën vepër penale, mund të sekuestrohen duke zbatuar kriteret e nenit 301 të kodit.

6. Në kuadër të procedimit penal nr. 287/2020, me vendimin e datës 28.4.2023, prokurorët e çështjes, mbështetur në nenet 208 e vijuese të KPP-së, kanë urdhëruar sekuestrimin pranë zyrës së shtetases A.P. *"të të gjitha dokumenteve që kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k., si dhe të kompjuterit në të cilin mbahen të dhënat e kësaj të fundit, si dhe çdo gjë tjetër që vlerësohet me rëndësi për hetimin dhe që ofron të dhëna mbi faktin objekt hetimi",* duke ngarkuar për kryerjen e sekuestrimit tre OPGJ*,* hetues financiarë të BKH-së. Në datën 28.4.2023, ora 15:30, OPGJ-të janë paraqitur në zyrën ku kërkuesja ushtron veprimtarinë e saj për zbatimin

[2] Duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298, pika 1, të KPP-së kur kanë arsye të bazuara të mendojnë se mbi personin gjenden të fshehura sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin.

[3] Duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298, pika 2, të KPP-së.

e vendimit të sekuestrimit. Nuk ka asnjë kundërshtim nga palët në lidhje me faktin se vendimi i është komunikuar shtetases A.P. (ortake e vetme dhe administratore e kërkueses) dhe se ajo ka qenë e pranishme gjatë kryerjes së veprimeve nga OPGJ-të, duke nënshkruar në përfundim edhe procesverbalin e sekuestrimit të dokumenteve të mbajtur për këtë qëllim. Në këtë të fundit janë përshkruar *"sendet/dokumentet e gjetura (apo të dorëzuara) nga shtetasja A.P.*". Po sipas këtij procesverbali, ai është nënshkruar rregullisht dhe pa vërejtje nga OPGJ-të dhe shtetasja A.P. (administratore e kërkueses) dhe një kopje e tij i është dhënë kësaj të fundit.

7. Nga ana tjetër, nuk vihet në diskutim as ajo çka ka parashtruar subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, se në rastin konkret prokurorët e posaçëm kanë pasur bazë për të vlerësuar se kërkuesja duhet të kishte në dispozicion prova materiale apo sende që lidheshin me veprën penale dhe që ofronin të dhëna me rëndësi për hetimin dhe kanë nxjerrë vendimin e sekuestrimit duke u mbështetur në parashikimet e nenit 208, pika 1, të KPP-së.

8. Në analizë të përmbajtjes së vendimit të sekuestrimit vërehet se prokurorët kanë përcaktuar qartë: i. llojet e provave apo sendeve për të cilat kërkohej sekuestrimi (dokumente dhe sende/kompjuter); ii. kriterin identifikues të tyre (faktin që këto dokumente ose sende duhej të kishin lidhje dhe përmbanin të dhëna për shoqërinë "H." sh.p.k.). Po në analizë të përmbajtjes së vendimit të sekuestrimit vërehet se në vendim është përcaktuar si objekt sekuestrimi edhe "*çdo gjë tjetër që ka rëndësi për hetimin dhe ofron të dhëna mbi faktin objekt të tij"*. Nga ana tjetër, në analizë edhe të dinamikës së veprimeve të OPGJ-ve në zbatim të vendimit të sekuestrimit (referuar procesverbalit përkatës), rezulton të jenë sekuestruar "*sendet/dokumentet e gjetura (apo të dorëzuara) nga shtetasja A.P.*" dhe konkretisht: katër pajisje kompjuterike (dy laptopë dhe dy njësi qendrore); 407 dokumente shkresore (fatura tatimore, kontrata, aktmarrëveshje etj.) që lidheshin me shoqërinë "H." sh.p.k.; katër dokumente shkresore të tjera (pasqyra financiare) që u përkisnin subjekteve juridike të ndryshme nga kjo shoqëri.

9. Për sa më sipër, jemi të mendimit se, duke mbajtur në konsideratë veçoritë e këtyre dy mjeteve të kërkimit të provës (sekuestrimit dhe kontrollit), llojin e të drejtave kushtetuese mbi të cilat ato ndërhyjnë[4], si dhe shkallën e ndërhyrjes që ato passjellin mbi të drejtat kushtetuese të individëve të cilëve u drejtohen, sekuestrimi, si mjet i kërkimit të provës, duhet të bazohet në një vendim i cili përcakton në mënyrë të qartë dhe nominalisht çdo send që kërkohet të sekuestrohet. Në të kundërt, hartimi i një vendimi në mënyrë të përgjithshme çon, nga njëra anë, në pamundësinë e zbatimit të tij dhe, nga ana tjetër, krijon mundësitë për arbitraritet në zbatimin e tij nga ana e OPGJ-ve, duke lënë në diskrecionin e tyre identifikimin dhe përcaktimin e atyre provave materiale dhe sendeve që lidhen me veprën penale. Ne jemi të qëndrimit se pikërisht kjo e fundit ka ndodhur edhe në rastin konkret, ku OPGJ-të janë paraqitur në ambientet e kërkueses, i kanë vënë në dispozicion përfaqësueses së saj A.P. vendimin e sekuestrimit dhe më tej kanë hyrë në zyrën e kërkueses dhe kanë sekuestruar disa kompjuterë (katër të tillë) dhe një numër të konsiderueshëm dokumentesh, të cilat dukshëm nuk kanë lidhje me shoqërinë "H." sh.p.k. dhe për to as nuk tregohet se ofrojnë ndonjë të dhënë me rëndësi për hetimin.

10. Ne arrijmë në përfundimin e mësipërm referuar, së pari, mënyrës sesi është hartuar vendimi i sekuestrimit, i cili, dukshëm është nisur nga prezumimi i pasjes në dispozicion të kërkueses të dokumenteve, sendeve të tjera, që mund të ishin me rëndësi për hetimin dhe që mund të ofronin të dhëna për faktin objekt të tij, por pa qenë ato të përcaktuara apo të përcaktueshme në atë moment, duke nënkuptuar dhe pranuar mundësinë e hyrjes në zyrën e kërkueses dhe të kontrollit të saj, si e vetmja mënyrë që i lejonte OPGJ-të të përmbushnin detyrat e lëna nga prokurorët e posaçëm për gjetjen dhe sekuestrimin e këtyre sendeve/dokumenteve, pra për të ekzekutuar vendimin. Edhe në analizë të fakteve të ndodhura në datën

[4] Ndërsa kontrollet tipikisht shkaktojnë ndërhyrje në të drejtën për paprekshmëri të banesës, sekuestrimet tipikisht shkaktojnë ndërhyrje në lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës dhe të drejtën për jetë private.

28.4.2023, siç janë përshkruar në vendimin e Gjykatës, kur OPGJ-të janë paraqitur në zyrën e kërkueses, është arritur në mënyrë të paekuivoke në përfundimin se në rastin konkret ka pasur *de facto* një kontroll dhe jo një ekzekutim të një vendimi sekuestrimi, i cili realizohet vetëm përmes dorëzimit vullnetar të sendeve/dokumenteve të identifikuara në mënyrë të qartë dhe të saktë në vendimin që kërkohet të ekzekutohet nga personi të cilit i komunikohet ai. Për më tepër kur, siç është arsyetuar edhe në vendimin e Gjykatës, fakti se përfaqësuesja A.P. e kërkueses i ka lejuar OPGJ-të të futen në zyrë apo se ajo ka bashkëpunuar me ta, duke iu ofruar edhe një post pune dhe kompjuter për përpilimin e procesverbalit të sekuestrimit, nuk mund të interpretohet si dhënie pëlqimi edhe për lejimin e tyre për të kërkuar, për sa kohë që heqja dorë nga një e drejtë themelore duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë, duke u bërë me njohuri të plotë të fakteve, pra në bazë të pëlqimit të informuar, të qartë dhe të dhënë pa asnjë detyrim/shtrëngim (*shih paragrafët 60 dhe 62 të vendimit*).

11. Edhe pse nuk vihet në diskutim qëllimi që kanë në kuadër të procedimit penal të tilla masa, ato nuk mund të justifikojnë çdo ndërhyrje apo t'u japin autoriteteve kompetente një liri të pakufizuar në ushtrimin e kompetencave të tyre. Në këto kushte, mënyra sesi është hartuar në rastin konkret vendimi i sekuestrimit, duke konsideruar edhe faktin se administratorja e kërkueses (shtetasja A.P.) nuk ka hequr dorë nga e drejta kushtetuese për paprekshmërinë e zyrës, si ambient i njësuar me banesën, pra nuk ka pranuar në mënyrë të shprehur ushtrimin e një kontrolli pa një vendim gjykate, kjo edhe në mungesë të njoftimit të saj mbi të gjitha të drejtat që i garantohen nga legjislacioni procedural penal dhe pasojat e heqjes dorë prej tyre, vendimi i sekuestrimit ka përbërë në thelb një vendim kontrolli, që, për efekte të zbatimit të nenit 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, mund dhe duhej të ishte miratuar vetëm nga gjykata dhe jo nga prokurori, si në rastin konkret.

12. Nga ana tjetër, ne nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën edhe në drejtim të përfundimit të saj se për sa i përket ekzistencës së rrezikut të afërt për humbjen ose zhdukjen e sendeve dhe dokumenteve që përmbanin të dhëna me rëndësi për hetimin, që do të legjitimonte kontrollin pa vendim gjykate, ajo nuk shprehet për sa kohë gjykatat e zakonshme nuk e kanë vënë në diskutim interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural për këtë aspekt (*shih paragrafin 75 të vendimit*). Në vlerësimin tonë shumica duket se ka dashur të shmangë vlerësimin e aspektit të kufizimit me ligj, duke e trajtuar atë nën aspektin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, për sa kohë që është nisur të bëjë një vlerësim *in abstracto* të parashikimeve ligjore, duke nxjerr në pah kështu, formalisht, një bazë ligjore që lejon ndërhyrje në banesë edhe pa vendim gjyqësor, ndërkohë që jo vetëm asnjë nga palët në gjykimin kushtetues nuk i ka bazuar qëndrimet mbi një hipotezë të tillë, por as ajo vetë (shumica) në përfundim nuk e ka bazuar qëndrimin e saj në një analizë të tillë të ndërhyrjes. Nga ana tjetër, edhe pse Gjykata në vlerësimin e ankimeve kushtetuese individuale niset edhe nga vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, një mungesë arsyetimi nga këto të fundit nuk e shmang vetë Gjykatën nga përgjegjësia dhe kompetenca për të verifikuar nëse veprimet e autoriteteve publike janë kryer në përputhje me ligjin dhe nëse ato kanë sjellë kufizim antikushtetues të të drejtave themelore të individit.

13. Thelbi i kësaj çështjeje, për rrjedhojë edhe argumentet e palëve, ka qenë nëse është kryer *de facto* kontroll ose jo në ambientet e kërkueses dhe jo nëse kontrolli i pranuar i kryer ka pasur si justifikim urgjencën për të vepruar të autoriteteve publike. Edhe vetë subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, pavarësisht se i kaloi barra e provës në këtë gjykim, për sa kohë nuk ka pretenduar se OPGJ-të ishin ndodhur në kushtet e kontrollit me iniciativë, për shkak të urgjencës së rastit, përkundrazi e ka kundërshtuar këtë pretendim të kërkueses, ai nuk ka sjellë prova se veprimet e OPGJ-ve janë bazuar në dispozitat procedurale që lejojnë përjashtimisht kontrollin pa vendim gjykate. Si gjatë procesit gjyqësor, ashtu edhe në atë kushtetues, ky subjekt ka pretenduar se nuk ka pasur kontroll, por vetëm ekzekutim të një vendimi sekuestrimi, miratimi i të cilit është në kompetencë të prokurorit, procedurë në të cilën, sipas këtij subjekti, përfaqësuesja e kërkueses ka qenë e pranishme dhe ka pranuar veprimet, duke bashkëpunuar me organin procedues. Në këto kushte, në vlerësimin tonë, ishte e panevojshme që Gjykata të ndalej në një vlerësim të tillë.

14. Për sa më sipër, ne jemi të qëndrimit se çdo veprim i kryer pas hartimit dhe miratimit të vendimit të sekuestrimit të prokurorëve të posaçëm përbën ndërhyrje në zyrën e kërkueses pa vendim gjyqësor, pra pa ligj në kuptim të përmbajtjes së neneve 17 dhe 37 të Kushtetutës, çka bie ndesh me garancitë e ofruara nga këto norma kushtetuese.

15. Në këto kushte ne jemi të qëndrimit se mosrespektimi i këtij kriteri e bënte të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera të ndërhyrjes në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe kërkesa duhej të ishte pranuar vetëm për këtë shkak.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Genti Ibrahimi, Sonila Bejtja

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me vendimin nr. 425 (2405), datë 10.7.2025, vendosi heqjen e plotë të zotësisë për të vepruar të shtetases Vera Brahimataj, e lindur më 10.8.1972 në Mes, Shkodër dhe banuese në Njësinë Administrative Postribë, Bashkia Shkodër, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e kërkuesit, nipit të saj Bekim Hasani.

KËRKESË

Shtetasja Veziko Çela kërkon, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, shpalljen të zhdukur të shtetasit Bert Resuli, me atësi Pelivan dhe amësi Manushaqe, i datëlindjes 10.12.1974, lindur e banues në Koshtan, Tepelenë, Njësia Administrative Qesarat, Bashkia Memaliaj.

KËRKUESE
Veziko Çela

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/09/30 15:49:18 +02'00'
cce91164203f40d381de5005e799af1e202509301
5491051031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)